

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА



FAKULTETI JURIDIK
FACULTY OF LAW
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË
DREJTIMI PENAL

TEZA:

CYBER-BULLYING (NGACMIMI KIBERNETIK) SI KRIMINALITET
BASHKËKOHOR

Kandidat:
Edisona Rexhepi

Mentor:
Doc. Dr. Veditje Ratkoceri

Qershor, 2022

DEKLARATA E AUTORËSISË

Vërtetoj se unë jam autori origjinal i kësaj teze të magjistraturës “Cyber-bullying (ngacmimi kibernetik) si kriminalitet bashkëkohor”. Universitetit i barten të drejtat autoriale të punimit, për përdorim për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.”

Edisona Rexhepi

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	5
ABSTRACT	6
HYRJE	7
1. Objekti dhe qëllimi i studimit	7
2. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit	9
3. Metodologjia e hulumtimit	9

KAPITULLI I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME RRETH CYBER-BULLYING

1.1. Kuptimi i Cyber-bullying (Ngacmimit kibernetik)	11
1.1.1. Kuptimi i Cyber	13
1.1.2. Kuptimi i Bullying (bullizimit)	13
1.2. Historiku i Cyber-bullying	14
1.2.1. Paraqitja e Cyber-bullying	15
1.2.2. Dokumentimi i rasteve të para	15
1.3. Format e manifestimit të Cyber-bullying	17

KAPITULLI II

IDENTIFIKIMI, SUBJEKTET DHE PARANDALIMI I CYBER-BULLYING

2.1. Subjektet e Cyber-bullying	20
2.1.1. Kryerësit e Cyber-bullying	20
2.1.2. Viktimat e Cyber-bullying	22
2.1.2.1. Cilat janë shenjat e Cyber-bullying te viktimat?	22
2.1.2.2. Efektet dhe pasojat e Cyber-bullying	23
2.2. Karakteristikat e Cyber-bullying	24
2.3. Identifikimi i Cyber-bullying	25
2.4. Cyber-bullying sipas gjinisë	27
2.5. Parandalimi i Cyber-bullying	28

KAPITULLI III

VËSHTRIME KRAHASIMORE

3.1. Vështrime të përgjithshme rreth Cyber-bullying në aspektin krahasimor	36
3.2. Cyber-bullying në disa shtete në botë	36
3.2.1. Cyber-bullying në SHBA	38
3.2.2. Cyber-bullying në disa shtete të Evropës	47
3.2.2.1. Cyber-bullying në Gjermani	49

3.2.2.2.	Cyber-bullying në Holandë	50
3.2.2.3.	Cyber-bullying në Angli	50
3.2.2.4.	Cyber-bullying në Itali	51
3.3.	Cyber-bullying në vendet e rajonit	52
3.3.1.	Cyber-bullying në Shqipëri	52
3.3.2.	Cyber-bullying në Kosovë	56
3.3.3.	Cyber-bullying në Sërbë	61

KAPITULLI IV

CYBER-BULLYING NË RMV

4.1.	Vështrime të përgjithshme rreth Cyber-bullying në RMV	64
4.2.	Kodi penal dhe legjislacioni në përgjithësi në RMV	70
4.3.	Departamenti për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale në RMV	73
4.4.	Të dhëna empirike nga anketa e realizuar online rreth cyber-bullying në RMV.	73

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	86
--	----

BIBLIOGRAFIA	89
---------------------------	----

ABSTRAKT

Në botën e sotme e cila është bërë e vogël nga teknologjia, kanë lindur problemet e epokës së re. Padyshim që teknologjia ka shumë benefite, por megjithatë ajo vjen edhe me një anë negative. Teknologjia ka bërë të mundur lindjen e cyber-bullying. Me pak fjalë, cyber-bullying ka të bëjë me keqpërdorimin e teknologjisë së informacionit me qëllim për të ngacmuar të tjerët.

Cyber-bullying (Ngacmimi kibernetik), krim bashkëkohorë, nga i cili krim pësojnë shumë njerëz duke përfshirë moshën të ndryshme, pa përjashtime, të cilët pësojnë në mënyra të ndryshme dhe viktimizohen çdo ditë në të gjithë botën dhe kjo padyshim që ndikon negativisht në tërë shoqërinë, e sidomos në ato vende duke përfshirë edhe vendin tonë, ku nuk është e rregulluar me ligj kjo veprë penale dhe nuk parashihet sanksioni adekuat, dihet që aty rrezikshmëria e paraqitjes dhe e kryerjes së këtij krimi është më e madhe dhe nuk ofrohet siguri dhe mbështetje ligjore tek qytetarët.

Kjo formë e kriminalitetit konsiderohet formë e re e bullizmit, e cila ka marrë përmasa ndërkombëtare dhe vazhdimisht është në rritje në vende të ndryshme të botës dhe arsya qëndron tek zhvillimi i teknologjisë, pra internetit, ku tani kanë qasje në të, të gjitha moshat duke filluar nga fëmijët, adoleshentët e deri tek moshat madhore.

Në këtë hulumtim janë analizuar në mënyrë të veçantë gjendja e cyber-bullying në RMV, si qëndrojmë me ligjin, çfarë masash janë marrë në këtë drejtim, poashtu është analizuar cyber-bullying edhe në vendet tjera si SHBA dhe në disa vende të Evropës, duke i analizuar veprimet dhe masat që i kanë ndërmarrë në parandalimin e kësaj dukurie negative, për të cilën është duke u punuar vazhdimisht në ngritjen e vetëdijësisë dhe ndërgjegjësisë dhe mbrojtjen e viktimave.

Fjalë kyçe: ngacmimi kibernetik, veprë penale, sanksioni, ligji, interneti, teknologjia

ABSTRACT

In today's world which has become small by technology, the problems of the new era have arisen. Undoubtedly technology has many benefits, but nevertheless it also comes with a downside. Technology has made cyber-bullying possible. In short, cyber-bullying refers to the misuse of information technology in order to harass others.

Cyber-bullying, a contemporary crime, from which many people suffer including different ages, without exception, who suffer in different ways and are victimized every day all over the world and this obviously has a negative impact on the whole society, especially on those countries, including our country, where this criminal offense is not regulated by law and does not provide adequate sanctions, it is known that there the danger of presenting and committing of this crime is greater and does not provide security and legal support to citizens.

This form of crime is considered a new form of bullying, which has reached international proportions and is constantly growing in different parts of the world and the reason lies in the development of technology, the Internet, which is now accessible to all ages starting from children, adolescents up to adults.

This research has specifically analyzed the situation of cyber-bullying in North Macedonia, how we stand by the law, what measures have been taken in this regard, cyber-bullying has also been analyzed in other countries such as the USA and some European countries, analyzing the actions and measures they have taken to prevent this negative phenomenon, for which is constantly working on raising awareness and protecting victims.

Keywords: *cyber-bullying, crime, sanction, law, internet, technology*

HYRJE

1. Objekti dhe qëllimi i studimit

Duke u nisur nga fakti se tani në kohën në të cilën jetojmë smartphone-ët, ipad-ët, laptop-ët dhe paisjet tjera elektronike dhe mjetet tjera teknologjike një pjesë të madhe të kohës brenda ditës janë në duart tona dhe thajse gati të gjitha proceset jetësore kryejmë përmes internetit, pra jeta e secilit prej nesh është e rrethuar me teknologjinë, e cila çdo ditë e më shumë po avancohet në të gjithë botën, poashtu edhe kriminaliteti i cili kryhet përmes këtyre mjeteve teknologjike, internetit, platformave të ndryshme apo rrjeteve sociale është në rritje e sipër, me të cilin kriminaliteti shoqëria bashkëkohore po përballet çdo ditë në botë.

Ky zhvillim i teknologjisë padyshim që në njërin anë ka sjellur shumë dobi dhe një numër të madh lehtësimesh për njerëzimin, mirëpo në anën tjetër ka krijuar një numër të madh problemesh dhe rreziqesh, si për individë dhe grupe, ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Pra, përkundër të mirave, ky zhvillim teknologjik ka anën e tij negative, i cili i ka hapur dyert sjelljeve anti shoqërore dhe kriminale që më parë kanë qenë të pamundura të kryhen. Me kompjuterë, sot e pamundura është bërë e mundur.

Mund të themi se, janë të paktë ata individë të cilët nuk kanë fare rrjete sociale, secili individ sëpaku ka një rrjet social si: Facebook, Instagram, Snapchat, Twitter, TikTok etj., të hapur në emrin e tij personal, me të dhëna personale dhe me fotografi, prandaj kjo ka bërë që me lehtësi të kryhen krime përmes internetit, duke i keqpërdorur këto të dhëna, dhe kështu është përhapur cyber-bullying si formë e kriminalitetit kompjuterik, i cili kriminalitet mund të manifestohet në mënyra dhe forma të ndryshme, duke viktimizuar mosha të ndryshme.

Duke pasur parasysh këto që u përmendën më lartë, në temën *“Cyber-bullying (Ngacmimi kibernetik) si kriminalitet bashkëkohor”*, si lëndë (objekt) hulumtimi do të jetë cyber-bullying si një formë e re e kriminalitetit që është në rritje e sipër në shumë vende të botës, poashtu edhe në RMV, ku në disa vende ndoshta janë marrë masa për parandalimin e këtij krimi, janë hartuar ligje dhe dispozita të veçanta që e parashikojnë si vepër penale dhe për të njejtën parashohin edhe sanksionin adekuat, mirëpo në shumë vende ka mungesë të ligjeve që e tregojnë si vepër penale dhe të dënueshme këtë krim, për të cilin jo të gjitha vendet dhe jo e gjithë bota ka njohuri se çfarë është cyber-bullying, si manifestohet apo si kryhet, cilat janë

format, mënyrat e kryerjes, kush janë viktimat, si mund të viktimizohen, si ta parandalojmë atë etj.

Përveç që do të shohim se sa vendet tjera po përballen me këtë formë të kriminalitetit dhe se a parashihet si vepër penale me ligj, ne do të fokusohemi më shumë në rajonin e RMV-së, të shohim se a jemi përballur ne si shtet me këtë formë të kriminalitetit, çfarë masash janë marrë, a kanë njohuri qytetarët tanë për këtë lloj të kriminalitetit dhe nëse po, atëhere a kanë qenë ndonjëherë të viktimizuar, a i kanë raportuar rastet e tyre në institucionet përkatëse etj.

Qëllimi i hulumtimit të kësaj teze të masterit është që të analizohen format me të cilat manifestohet ky lloj i krimit, mënyra e parandalimit dhe luftimit të këtij krimi, duke pasur parasysh se kemi munges të legjislacionit në RMV. Pra, në RMV nuk ekziston një ligj i posaçëm për cyber-bullying, as nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë në Kodin Penal që i referohet cyber-bullying si vepër penale dhe e sanksionueshme, ka vetëm disa nene për krimin kibernetik. Dhe për këtë arsye, do të shpjegohet se si mos rregullimi i veprës penale me ligj dhe mos sanksionimi i veprës penale ndikon në rritjen dhe përhapjen e këtij krimi.

Gjithashtu, duke i analizuar shtetet e tjera nëpër botë që janë duke u ballafaquar me këtë krim, që sistemin e drejtësisë e kanë shumë më të zhvilluar se ne dhe kanë ndërmarrë edhe hapa për parandalimin dhe luftimin e këtij krimi, duhet të marrim shembull dhe të vijmë në përfundim se cilat hapa duhet t'i ndërmarrim ne si shtet për zbulimin e këtij krimi, si të gjenden autorët e krimit, si të mbrojmë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, të ruajmë identitetin e tyre dhe mbi të gjitha t'ju garantojmë siguri dhe mbështetje ligjore.

Si qëllime tjera të hulumtimit mund të cekim edhe atë se sa mund të ndikojë në paraqitjen e individëve potencial për kryerjen e këtij krimi, fakti që nuk ekzistojnë institucione kompetente që në mënyrë sistematike merren me ndjekjen e këtij lloj krimi; Sa mos implementimi i duhur i dispozitave ligjore e rrit numrin e rasteve të pa zbuluara, numrit të errët të kriminalitetit dhe rrjedhimisht e vështirëson zbulimin e kryerësve, formën, mënyrën se si është kryer vepra penale; Mos sanksionimi i këtij lloj krimi shpie edhe në përhapjen e krimeve dhe dukurive tjera delikvente, negative, sepse me cyber-bullying viktimat pësojnë dhunë psikike, që i shpie që edhe ata të ndërmarrin veprime joligjore dhe negative, sidomos kur e dinë që nuk kanë se ku të drejtohen që të marrin ndihmën e nevojshme që kanë pësuar nga vepra

penale, dhe kështu numri i errët i kriminalitetit bëhet edhe më i madh sepse rastet nuk paraqiten në institucionet përkatëse kompetente për arsye të ndryshme.

2. Hipotezat dhe pyetjet kërkimore të studimit

Hipotezat lidhur me hulumtimin e Cyber-bullying (Ngacmimi kibernetik) si kriminalitet bashkëkohor qëndrojnë si në vijim:

H1: Cyber-bullying është vepër që sot tangon të gjitha shtetet bashkëkohore

H2: Mungesa e dispozitave ligjore rrit numrin e rasteve të pazbuluara dhe e vështirëson zbulimin e tyre

H3: Në RMV duhet të ketë ligj të veçantë me të cilin rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me krimin kibernetik, përfshirë edhe Cyber-bullying

H4: Cyber-bullying duhet të inkriminohet si vepër e veçantë penale në KPRMV

H5: Pasojat e Cyber-bullying te viktimat, veçanërisht te ato të moshave të reja janë shumë të rënda dhe afatgjate

H6: Mungesa e edukimit të përgjithshëm rreth Cyber-bullying, veçanërisht te të rinjët, është faktor që ndikon në rritjen gjithnjë e më të madhe të këtyre rasteve

3. Metodologjia e hulumtimit

Për të trajtuar këtë hulumtim, përkatësisht për ta hulumtuar cyber-bullying (ngacmimin kibernetik) si kriminalitet bashkëkohor, janë përdorur metoda të ndryshme. Këto metoda janë:

- ❖ Metoda historike është përdorur për të pasur njohuri se kur për herë të parë ka filluar të përhapet kjo formë e kriminalitetit, si ka filluar, ku ka filluar, si është manifestuar në të kaluarën dhe sa është avansuar apo ka ndryshuar sot etj;
- ❖ Metoda komperative është përdorur për të krahasuar shtrirjen e cyber-bullying në vende të ndryshme të botës, pra në cilat vende është më i përhapur, në cilat vende

është më pak i përhapur, si manifestohet në vende të ndryshme a ka dallime me vendet tjera;

- ❖ Metoda normative është përdorur për krahasimin e ligjeve, pra si vendet e ndryshme e kanë të rregulluar këtë vepër penale në legjislacionet e tyre, çfarë masa ndërmerren në zbulimin dhe parandalimin e këtij fenomeni dhe çfarë efektesh kanë ato, pra do të shqyrtohet legjislacioni i RMV-së dhe i vendeve tjera, se si rregullohet cyber-bullying;
- ❖ Metoda statistikore është përdorur për të pasqyruar të dhëna për krimet e kryera, për të paraqitur numrin e rasteve të zbuluara dhe sanksionuara tek ne, për të paraqitur të dhëna se si qëndron përhapja e këtij krimi në vendet e ndryshme të botës si dhe tek ne në RMV;
- ❖ Metoda e anketës nëpërmjet së cilës janë anketuar një numër i caktuar personash për të ardhur deri në konkluzat të ndryshme dhe përmbledhje më të qarta rreth cyber-bullying;

Gjithashtu do të shfrytëzoj literaturë adekuate duke përfshirë libra, punime apo artikuj shkencore, revista shkencore, burime të ndryshme nga interneti, shënimet zyrtare nga evidencat e institucioneve etj.

KAPITULLI I

VËSHTRIME TË PËRGJITHSHME RRETH CYBER-BULLYING

1.1. Kuptimi i Cyber-bullying (Ngacmimit kibernetik)

Ashtu siç ka evoluar vetë përdorimi i teknologjisë, po ashtu ka evoluar edhe aftësia për të ngacmuar (bullizuar). Bullizimi i cili një kohë ishte i kufizuar dhe ndodhte vetëm në shkollë ose në lagje, tani është zhvendosur në botën online. Ngacmimi (bullizimi) përmes përdorimit të teknologjisë quhet “Cyber-bullying - Ngacmim kibernetik”.

Cyber-bullying paraqet formë moderne të bullizimit apo ngacmimit. Fakti se të rinjtë sot kanë qasje të drejtpërdrejtë në internet qoftë nga kompjuterët personal apo celularët, kudo që ato ndodhen, në shtëpi, shkollë apo në vende publike, tregon shumë rreth kësaj problematike.

Në një studim shkencor, Tokunaga këtë krim e definon si “Çdo sjellje e kryer përmes mediave elektronike ose dixhitale, nga individë ose grupe që adresojnë në kontinuitet mesazhe armiqësore ose agresive, të cilat synojnë të shkaktojnë dëm për të tjerët”¹

Cyber-bullying definohet si përdorim i mjeteve elektronike apo teknologjisë për të ngacmuar, kërcënuar, lënduar, turpëruar, poshtëruar ose frikësuar në mënyrë të përsëritur dhe të qëllimshme një person apo më shumë persona.²

Cyber-bullying shfaqet përmes pajisjeve dixhitale si në: telefona celularë apo smartfonë, tabletë, kompjuterë. Mund të ndodhë:

- Në mediat sociale, siç janë Facebook-u, Instagrami, Snapchati, Twitter, Tik-tok etj.
- Në SMS
- Në mesazhet-tekstet e çastit, direkte ose bisedat online (Viber, Whatapp, Messenger, Skype, etj.)
- E-mail
- Në lojëra online (Fortnite, PUBG, Roblox, Call of duty) ose aplikacione tjera, ku njerëzit mund të shikojnë, të marrin pjesë ose ndajnë ndonjë përmbajtje (Youtube).

¹ Tokunaga, Robert S. "A critical review and synthesis of research on cyberbullying victimization." -Computers in human behavior- 2010, fq. 277-287.

² Ngacmimi kibernetik, 2018, <https://busulla.com/articles/88>

Pra, përfshin dërgimin, postimin ose shpërndarjen e përmbajtjeve negative, të dëmshme, të rreme dhe të liga për dikë tjetër. Mund të përfshijë shpërndarjen e informacionit personal ose privat mbi dikë tjetër që shkakton turpërim ose poshtërim, dhe duhet cekur që ka edhe cyber-bullying që e kalon vijën e sjelljeve të paligjshme apo vijën kriminale.³ Kërcënimi ose komentet e këqija që çenojnë religjionin, gjininë, orientimin seksual, racën, përkatësinë etnike, dallimet fizike të një personi konsiderohen si diskriminim gjë që është kundër ligjit, kjo d.t.th se policia mund të përfshihet dhe ngacmuesit mund të përballen me dënime serioze.⁴

Një person mund të jetë i përfshirë në cyber-bullying në disa mënyra, siç janë: personi mund të jetë i ngacmuar, personi mund të ngacmojë persona të tjerë, apo edhe personi të jetë dëshmitar i ndonjë ngacmimi.⁵

Ky lloj bullizimi (ngacmimi) dallon nga ai tradicional nga fakti se këtu viktimat dhe kryerësi nuk janë ballë për ballë njëri-tjetrit. Në këto raste ngacmuesi nuk dihet është anonim, ai kryen këtë akt nëpërmjet internetit pa ju njohur identiteti nga ndonjë adresë e rreme të cilën e ka krijuar dhe vështirë gjurmohet, por jo çdoherë ngacmuesi është një person i huaj, mund të jetë edhe dikush që viktimat e njeh. Cyber-bullying ka rezultate shumë më negative sepse ai qëndron në internet dhe mund të shihet në çdo kohë, e të përhapet me shpejtësi marramendëse.⁶

Tani, duke e menduar të kaluarën, kohën e një brezi të mëparshëm apo të gjeneratave të mëparshme, fëmijët dhe adoleshentët kërkonin nga prindërit e tyre që t'u plotësonin dëshirat duke u blerë atyre telefona në dhomat e tyre me linja ose telefona celularë që të kishin kontakte me shoqërinë dhe rrethin më lehtësisht dhe disi më privatësisht, mirëpo, sot dëshira e një fëmije dhe adoleshenti për t'u lidhur apo kontaktuar me miqtë nuk ka ndryshuar, por mundësitë për ta bërë këtë janë rritur jashtëzakonisht. Fëmijët jo vetëm që kërkojnë tabletët e tyre, pajisje për lojëra dhe telefona celularë në moshë të re, ata gjithashtu duan akses në faqet e njohura të rrjeteve sociale.

³ Stopbullying, Cyberbullying, 2021, <https://www.stopbullying.gov/cyberbullying/what-is-it>

⁴ JOSEPH, Elena Pearl Ben, Cyberbullying, 2018, <https://kidshealth.org/en/teens/cyberbullying.html>

⁵ ALITI, Gëzim, Burimet e hetimit të krimit kompjuterik dhe parandalimi i tij në faza të hershme, Tetovë, 2019, fq. 22,23, https://repository.seeu.edu.mk/sites/thesis/ThesisSharedDocs/MA_118542.pdf

⁶ DARDHISHTA, Kaltrina, Krimi kibernetik në RMV – aspekte krahasimore me vendet e UE-së, Tetovë, 2020, fq.21,22. https://repository.seeu.edu.mk/sites/thesis/ThesisSharedDocs/MA_124635.pdf

Dikur të rinjtë kalonin kohë me miqtë e tyre duke luajtur në lagje jashtë rrethit të të rriturve, tani ata po angazhohen me njëri-tjetrin në cyberworld (botën kibernetike), “duke folur” me njëri-tjetrin dhe “duke folur” për njëri-tjetrin, pa monitorimin dhe mbikqyrjen e prindërve dhe kjo shpie edhe deri tek cyber-bullying, sepse ata shpërndajnë mes vete ide, fotografi, video të ndryshme që mund të shpiejnë edhe deri te keqpërdorimi.⁷

1.1.1. Kuptimi i Cyber

Fjala kibernetikë rrjedhë nga shprehja greke “kybernetes” që në përkthim të lirë do të thotë “timonier i anijes” dhe ka kuptimin e “aftësisë së udhëheqjes”.⁸

Kibernetik/ë,-a - shkenca që studion ligjet dhe metodat për të lehtësuar punën e njeriut nëpërmjet përdorimit të mjeteve të ndryshme dhe të aparateve të ndërlukuara automatike.⁹

Kuptimi i Cyber (kibernetikë) u paraprin disa termave që lidhen me botën e internetit, kompjuterit.^{10 11}

“Kibernetika” (cyber) definohet si: “çdo gjë që ka të bëjë me, apo që përfshin, kompjuterët apo rrjetet kompjuterike (si Interneti)”

Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), “cyber” është “mjedis kompleks që lind nga ndërveprimi i njerëzve, i programeve dhe i shërbimeve në Internet, me anë të pajisjeve e rrjeteve teknologjike që lidhen në të, që nuk ekziston në formë fizike”.¹²

1.1.2. Kuptimi i Bullying (bullizimit)

Bullizimi si dukuri negative ka kohë që është paraqitur dhe tani si fenomen është

⁷ Pacer’s National bullying prevention center, Cyberbullying definition, <https://www.pacer.org/bullying/info/cyberbullying/>

⁸ Studentët.mk, Kibernetika dhe teoria e shenjave, 2017, <https://www.studentet.mk/kibernetika-dhe-teoria-e-shenjave/>

⁹ Fjalor i gjuhës shqipe, <https://fjalorthi.com/kibernetik%C3%AB>

¹⁰ Kuptimi i Cyber, 2022, <https://sq.nsp-ie.org/ciber-3904>

¹¹ Cyber definitions, What does cyber mean, https://www.cyberdefinitions.com/definition_of_cyber.html

¹² Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2016 – 2019, fq. 7, 2015, https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Shteterore_per_Sigurine_Kibernetike_dhe_Plani_i_Veprimit_2016-2019_per_publicim_1202.pdf

përhapur masivisht në të gjitha vendet e botës, pra mund të ndodhë kudo dhe kurdo.¹³ Kjo dukuri negative përfshin dy persona, një ngacmues ose kërcënues dhe një viktimë.¹⁴

Bullizëm janë sjelljet e përsëritura, të dëmshme e agresive, kur një fëmijë ose grup fëmijësh, duke përfituar nga forca/fuqia, pushteti që ata mund të kenë, përbuzin, fyejnë, refuzojnë, përjashtojnë, kërcënojnë, godasin një fëmijë apo një grup tjetër fëmijësh “më të dobët” se ata në mënyrë të përsëritur, duke ju shkakuar dëmtime fizike si dhe lëndime serioze të mirëqenies psiko/emocionale.

Disa nga mënyrat e shfaqjes së këtij fenomeni janë: thirrja e dikujt me emra fyes, tallës, shkrimi i mesazheve lëndues, lënia jashtë aktiviteteve, kërcënimi, të bërtiturit, frikësimi, vjedhja ose dëmtimi i sendeve/gjërave të tyre personale, goditja, shkelmimi, pickimi i tyre, ose detyrimi për të bërë gjëra apo për t’u përfshirë në sjellje që ata nuk duan të përfshihen.¹⁵

“Bullizmi është një dëshirë për të dëmtuar tjetrin + një veprim që lëndon + një disbalancë në forcë midis personave + një përsëritje (në mënyrë tipike) + një përdorim i padrejtë i forcës + një kënaqësi e dukshme e agresorit si edhe një ndjenjë e përgjithshme e të qenit mbizotërues ndaj viktimës”. (Rigby, 2002)

1.2. Historiku i Cyber-bullying

Gjatë dy dekadave të fundit me rritjen e mediave sociale edhe cyber-bullying është bërë një çështje gjithnjë e më e rëndësishme. Origjina e cyber-bullying pra është nga rrjetet sociale moderne. Si fenomen thuajse është normalizuar për arsye të qasjes në internet të të gjithë grupmoshave, sepse si dukuri nuk kufizohet vetëm tek fëmijët, por përfshin edhe adoleshentët dhe të rriturit.

¹³ Bullizmi si pjesë e shoqërisë, pasojat dhe lufta kundër tij, 2022, <https://pikepamja.net/bullizmi-si-pjesë%CC%88-e-shoqe%CC%88rise%CC%88-pasojat-dhe-lufta-kunde%CC%88-tij/>

¹⁴ DONEGAN, Richard, Bullying and Cyberbullying: History, Statistics, Law, Prevention and Analysis, pg. 33,34 <https://www.elon.edu/u/academics/communications/journal/wp-content/uploads/sites/153/2017/06/04DoneganEJSpring12.pdf>

¹⁵ Guri, Besmir, Portali shkollor, 2020 <https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/cdo-lloj-dhune-nuk-eshte-bullizem-por-cdo-lloj-bullizmi-eshte-dhune>

1.2.1. Paraqitja e Cyber-bullying

Ngacmimi kibernetik filloi të paraqitet si dukuri negative në vitet 1990 pasi kompjuterët personalë të lidhur me internet u bënë gjerësisht të disponueshëm në tregun e konsumit, ndërsa pësoi revolucion pasi mesazhet me tekst dhe me fotografi dhe interneti në celular u bënë të zakonshëm për të gjithë njerëzit.

1.2.2. Dokumentimi i rasteve të para

Edhe pse filloi të përhapej si fenomen në vitet e 90-ta, deri në mesin e vitit 2000 nuk tërhoqi vëmendjen e studiuesve. Mirëpo, pas rasteve të para të dokumentuara të cilat kanë përfunduar me vetëvrasje si rezultat i ngacmimit apo bullizmit në internet kjo ka tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe avokatëve.¹⁶

Rasti i parë i dokumentuar në historinë e cyber-bullying është ai i 13-vjeçares Megan Meier në vitin 2007, e cila vdiq tragjikisht duke bërë vetëvrasje, duke e varur veten me një rryp në dollapin e saj, pasi u ngacmua (bullizua) deri në atë pikë që e çoi atë të vriste veten. Megan mendoi se po fliste me një djalë 16 vjeçarë të quajtur Josh në platformën MySpace. Ata ishin në një njohje gjashtë javore për të cilën kishin njohuri edhe prindërit e Meganit. Mirëpo, më pas Megan mori një mesazh në MySpace nga Josh i cili i thoshte: “Nuk e di nëse dua të jam më mik me ty sepse kam dëgjuar që nuk je aq e sjellshme me shoqërinë tënde”. Ditën tjetër të gjithë studentët ishin duke e bullizuar Meganin dhe ajo merr edhe një mesazh nga Josh i cili i thotë: “Të gjithë në O’Fallon e dinë se kush je ti. Ti je një person i keq dhe të gjithë të urrejnë ty. Jeto një jetë të keqe. Bota do të ishte një vend më i mirë pa ty”. Dhe atë ditë prindërit e Megan e gjetën atë të vetëvrasurë në dhomën e saj. Më pas, pas hetimeve të rastit del se në emër të Josh ishte Lori Drew nëna e një prej ish-shoqeve të Meganit, e cila kishte krijuar profil të rremë në MySpace bashkë me vajzën e saj. Drew u dënua për tre akuza, për mashtrim dhe falsifikim të profilit në MySpace, për bullizim dhe nxitje në vetëvrasje. Rasti i Meier-it e nxiti shtetin e saj të Misurit të miratonte një ligj kundër ngacmimit që përfshin krimet e ngacmimit kibernetik.¹⁷ Pas

¹⁶ The Origin of Cyberbullying + 5 Ways to Identify and Prevent It, <https://dataoverhauleders.com/origin-of-cyberbullying/>

¹⁷ AUNE, Nicole M., Cyberbullying, The Graduate School University of Wisconsin-Stout December, 2009, pg. 3,4;

vdekjes së Megan Meier, nëna e e saj Tina Meier, themeloi organizatën jofitimprurëse që e emëroi 'Fondacioni Megan Meier', për nder të vajzës së saj. Përveç Fondacionit Megan Meier, Tina gjithashtu punoi ngushtë për të ndihmuar legjislaturën e Misurit të kalojë Projektligjin 818 të Senatit, i njohur jozyrtarisht si "Ligji i Meganit" në gusht 2008. Në prill 2009, përfaqësuesja e SHBA Linda Sánchez e Kalifornisë prezantoi "Ligji i parandalimit të ngacmimit kibernetik të Megan Meier", i cili synonte t'i jepte fund seriozisht ngacmimit kibernetik - por për fat të keq nuk ishte miratuar.¹⁸

Një nga viktimat e para të njohura të cyber-bullying nëpërmjet telefonave celularë është ai i 18-vjeçares Jessica Logan e cila kreu vetëvrasje pasi fotot e saj nudo u shpërndanë nga i dashuri i saj në të paktën shtatë shkolla të ndryshme të Ohajos. Logan më pas u sulmua pamëshirshëm në internet përmes Myspace dhe mesazheve me tekst.

Një vit më vonë, në një rast pothuajse identik, një 13-vjeçare e quajtur Hope Sitwell vrau veten pasi i dashuri i saj u dërgoi një foto nudo nxënësve të gjashtë shkollave të mesme në Florida. Të dyja vdekjet rezultuan në padi kundër shkollave, të cilën padi e ngritën prindërit e viktimave, si dhe ligje të reja shtetërore për ngacmimin kibernetik.

Fatkeqësisht, raste të tilla të grave të reja që ngacmohen seksualisht përmes shpërndarjes së imazheve të ndjeshme është një trend që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Përderisa cyber-bullying ndodh në platforma dhe aplikacione të panumërta të rrjeteve apo mediave sociale, një postim 10 sekondash p.sh. në Snapchat mund të shpërndahet pastaj në platforma tjera dhe të bëhet viral në Facebook, Instagram, Twitter, TikTok etj., brenda disa orëve. Çdokush në botë mund të shikojë dhe komentojë videot publike të postuara në YouTube apo edhe platforma tjera.

Në vitin 2010, një student i Universitetit Rutgers i quajtur Tyler Clementi u hodh nga ura e George Washington-it pasi shoku i tij i dhomës transmetoi drejtpërdrejt një video të Clementit duke puthur një burrë tjetër në Twitter.

Po atë vit, një adoleshente kanadeze e quajtur Amanda Todd vrau veten një muaj pasi postoi një video të titulluar, "Historia ime: Përpjekje, ngacmim, vetëvrasje, vetëlëndim" në

<https://www2.uwstout.edu/content/lib/thesis/2009/2009aunen.pdf>

¹⁸ The truth behind 6 disturbing cyberbullying cases that turned into suicide stories,

<https://www.wtsp.com/cms/lib8/NJ01912980/Centricity/Domain/745/The%20truth%20behind%206%20disturbing%20cyberbullying%20cases%20that%20turned%20into%20suicide.pdf>

YouTube. Videoja e Todd, e parë më shumë se 17 milionë herë, shpjegoi se si një i panjohur e bindi atë të tregonte gjoksin e saj në kamera dhe më pas e shantazhoi me këto foto. I panjohuri e postoi foton në rrjetet sociale dhe e përdori atë si fotografi të profilit për llogaritë e rreme që përdori për t'u miqësuar me Todd. Një javë pas vdekjes së saj, Kanadaja filloi hartimin e legjislacionit kombëtar kundër bullizmit.¹⁹ Gjithashtu, nëna e Amandës, Carol Todd, përmes dhimbjes së humbjes së vajzës së saj, ka marrë një qëndrim dhe ka ndarë historinë e Amandës jo vetëm me komunitetin e saj, por edhe me botën. Ajo si një avokate globale që ndan zërin e vajzës së saj themeloi një organizatë jofitimprurëse që quhet 'Amanda Todd Legacy Society', qëllimi i së cilës është rritja e ndërgjegjësimit për bullizmin, ngacmimin kibernetik, sigurinë në internet, shëndetin mendor dhe shfrytëzimin me bazë gjinore.²⁰

1.3. Format e manifestimit të Cyber-bullying

Disa nga format më të shpeshta të Cyber-bullying (Ngacmimit kibernetik) janë:

- ❖ Postimi apo dërgimi i thashethemeve ose komenteve online për dikë, me përmbajtje vulgare, lënduese, turpëruese etj.;
- ❖ Dërgimi i emailave, mesazheve kërcënuese;
- ❖ Vënia e nofkave apo pseudonimeve me qëllim të fyerjeve përmes mesazheve, postimit në rrjetet sociale etj.;
- ❖ Postimi i sekreteve të dikujt në rrjetet sociale;
- ❖ Postimi apo dërgimi i fotografive personale pa lejen e personit ose video (zakonisht fotografitë, videot janë intime apo turpëruese).
- ❖ Pretendimi se jeni dikush tjetër në internet për të kërkuar ose postuar informacione personale ose të rreme për dikë tjetër; etj.²¹

Mungesa e mbikëqyrjes së rrjeteve sociale nga prindërit, mësuesit apo autoritetet

¹⁹ The Bark team, The history of Cyberbullying, 2017 <https://www.bark.us/blog/the-history-of-cyberbullying/>

²⁰ Amanda Todd Legacy Society, <https://www.amandatoddlegacy.org/>

²¹ Kaspersky, Cyber-bullying Facts – Top 10 Forms of Cyber Bullying, 2016, <https://www.youtube.com/watch?v=0Xo8N9qJtk>

shtetërore, ju mundëson ngacmuesve t'i kontaktojnë viktimat e tyre më lehtë dhe më shpesh.²²

Format e tjera të Cyber-bullying janë:

1. **Përrjashtimi** (Exclusion) - është akti i lënies së dikujt jashtë qëllimisht. Përrjashtimi përdoret në internet për të synuar dhe ngacmuar një viktimë, dhe mund të ndodhë në shumë mënyra. Për shembull, fëmija juaj mund të përrjashtohet/të mos ftohet në grupe ose festa ndërkohë që sheh miq të tjerë që përrfshihen, ose të lihen jashtë temave të mesazheve ose bisedave që përrfshijnë miq të përrbashkët, të lihen jashtë aktiviteteve online. Fëmijët të cilët nuk posedojnë teknologjitë e fundit, si smartfonë e përrjetojnë më shumë.
2. **Ngacmimi** (Harassment) - është një formë e vazhdueshme dhe e qëllimshme e ngacmimit që përrfshin mesazhe abuzive ose kërcënuese që i dërrgohen fëmijës tuaj ose një grupi. Kjo është një formë shumë e rrezikshme e ngacmimit kibernetik. Mund të ketë pasoja serioze për mirëqenien e fëmijës suaj.
3. **Dalja** (Outing/Doxing) - është një veprim i qëllimshëm i cili ka të bëjë me postimit në internet të informacionit të ndjeshëm ose personal për dikë pa pëllqimin e tij me qëllim të turpërrimit ose poshtërrimit të tij publikisht. Pra, kur ngacmuesit në internet gjejnë informacion personal për viktimat e tyre dhe i publikojnë ato publikisht. Kjo mund të bëhet duke përrhapur fotografi personale ose mesazheve personale, madje edhe leximi i mesazheve i fëmijës suaj nga telefoni i tyre me zë të lartë mund të konsiderohet si një formë e outing.
4. **Mashtrimi** (Trickery) – është akti i fitimit të besimit, ku ngacmuesi do të 'miqësohet' me objektivin e tyre duke e bërë atë të krijojë një ndjenjë sigurie, dhe pasi të ketë fituar besimin e objektivit të tyre, ata abuzojnë me atë besim dhe ndajnë sekretet dhe informacionin privat të viktimës me një palë të tretë ose duke e ndarë publikisht në internet. Anëtarët e komunitetit LGBTQ+ janë përrkur ndjeshëm nga ky lloj bullizmi.
5. **Ndjekja kibernetike** (Cyberstalking) – Kjo është një formë veçanërrisht alarmante e ngacmimit kibernetik. Ndonjëherë mund të çojë në përrndjekjen e një personi në botën

²² Ngacmimi kibernetik, 2018, <https://busulla.com/articles/88>

reale. Megjithatë, ngacmuesit kibernetikë do të ndjekin aktivitetet e viktimave të tyre në internet dhe do ta përdorin atë njohuri për t'i kërcënuar ose shantazhuar ato. Mund t'i referohet gjithashtu të rriturve që përdorin internetin për të kontaktuar dhe njoftuar njerëz të rinj për qëllime seksuale apo abuzive.

6. **Fraping** – është kur dikush hyn në llogarinë e rrjeteve sociale të fëmijës suaj dhe imiton atë duke postuar përmbajtje të papërshtatshme në emër të tij. Fraping është një shkelje shumë e rëndë, për të cilën shumë njerëz besojnë se është qesharake dhe argëtuese, por nuk është ashtu. Imitimi i dikujt në internet dhe prishja e reputacionit të tyre mund të ketë pasoja të rënda. Mos harroni se çdo gjë që postohet në internet nuk do të zhduket kurrë plotësisht, edhe nëse fshihet.
7. **Shpërndarja (Dissing)** - është akti i dërgimit ose postimit të informacionit mizor për fëmijën tuaj në internet, për të dëmtuar reputacionin e tij ose miqësinë me të tjerët. Mund të përfshijë gjithashtu postimin e materialeve në internet si foto, pamje nga ekrani ose video. Në këto situata, dhunuesi priret të ketë një marrëdhënie personale me viktimën, qoftë si një i njohur apo si mik.²³
8. **Trolling** – është kur një ngacmues do të kërkojë të shqetësojë qëllimisht të tjerët duke postuar komente nxitëse në internet. Qëllimi i tyre kryesor është t'i zemërojnë të tjerët aq sa ata të veprojnë në të njëjtën mënyrë. Zakonisht ata kërkojnë ta bëjnë veten të ndihen mirë duke i bërë të tjerët të ndihen keq. Kjo ndodh shpesh në seksionet e komenteve në mediat sociale si YouTube ose Facebook.
9. **Catfishing** – ka të bëjë me vjedhjen e identiteteve online dhe ri-krijimin e profileve sociale për qëllime mashtruese. Këta persona e shikojnë profilin tuaj dhe marrin të dhënat e juaja, vjedhin identitetin tënd, e më pas e krijojnë një profil të ri me ato të dhëna kështu krijohet një personazh i rremë.²⁴

²³ The 10 Types of Cyberbullying, 2018, <https://blog.securly.com/2018/10/04/the-10-types-of-cyberbullying/>

²⁴ 10 Forms of Cyberbullying, <https://kids.kaspersky.com/10-forms-of-cyberbullying/>

KAPITULLI II

IDENTIFIKIMI, SUBJEKTET DHE PARANDALIMI I CYBER-BULLYING

2.1. Subjektet e Cyber-bullying

Subjektet e cyber-bullying janë kryerësi (ngacmuesi) dhe viktima. Siç u tha edhe më lartë se, ngacmimi kibernetik mund të ndodh kudo, kujtëdo dhe në çdo kohë.

2.1.1. Kryerësit e Cyber-bullying

Kryerës i cyber-bullying mund të jetë kushdo, pa marrë parasysh moshën.

Cyber-bullying mund të ndodhë për shumë arsye të njëjta që ndodh edhe bullizmi i zakonshëm, por ngacmimi kibernetik është edhe më tërheqës sepse mund të bëhet në mënyrë anonime.

Pse dikush do që të bëhet ngacmues? Ndoshta ka po aq arsye sa ka edhe ngacmues.

Ndonjëherë ajo që duket si ngacmim në internet mund të jetë aksidentale. Natyra e mesazheve me tekst, postimeve dhe mënyra tjera të komunikimit në internet, përderisa nuk janë të drejtpërdrejta, është e vështirë ta kuptosh a është shaka apo jo. Por, vazhdueshmëria e ngacmimeve nga një person i njejtë, i cili fyerjet dhe kërcënimet i bën në mënyrë të përsëritur, kuptohet se ajo nuk është një shaka, por kalon kufijtë dhe tregon ngacmim kibernetik.²⁵

Personat që mendohet se shfaqen më tepër si bullizues (ngacmues) janë ata persona që janë të njohur, të popullarizuar dhe ata që janë më të distancuar, më pak social. Fëmijët ose adoleshentët që janë më të njohur mund bullizojnë për arsye se: Ata e shohin këtë si mënyrë për të qëndruar të popullarizuar dhe lëndimi i personave tjerë i bën ata të ndihen më të fortë. Ndërsa fëmijët ose adoleshentët që janë më pak social munden me sukses të kryejnë bullizim sepse: Kjo i bën ata të përballen me vetëvlersimin e tyre të ulët, ata mendojnë se kjo do t'i ndihmojë atyre të përshtaten me bashkëmoshatarët e tyre, ata e kanë të vështirë të empatizojnë ata që lëndojnë.

Në përgjithësi, sjellja e ngacmuesve (bullizuesve) zakonisht vjen si pasojë e problemeve të

²⁵ JOSEPH, Elena Pearl Ben, Cyberbullying, 2018, <https://kidshealth.org/en/teens/cyberbullying.html>

tyre. Këto probleme të tyre mund të jenë nga shkaqe të ndryshme, si p.sh.: familje të çrregulluara me probleme ose të mangëta, pra me përkujdesje prindërore më të ulët, persona që nuk e dëshirojnë shkollimin, që janë në depresion ose në ankth etj. Ata shpesh kanë vështirësi për t'i kontrolluar emocionet dhe sjelljet e tyre impulsive dhe e kanë të vështirë t'i ndjekin rregullat.

Ngacmuesit kibernetik janë gjithashtu viktime - ata gjithashtu kanë nevojë për ndihmë.²⁶

Arsyet apo motivet që dikush të kryejë cyber-bullying janë të ndryshme, këtu ndikojnë faktorët e jashtëm dhe faktorët e brendshëm, si p.sh.:

- Kanë probleme me shëndetin mendorë, janë agresiv, impulsiv, hiperaktiv, marrin substanca narkotike, ose vuajnë nga çrregullime tjera si narcisizmi, psikopatia etj., dhe mendohet që këta njerëz kanë një nivel ndjeshmërie më të ulët për njerëzit e tjerë dhe mund të ngacmojnë të tjerët si një mënyrë për të rritur ndjenjën e tyre të fuqisë apo vlerës.
- Rezultat i konflikteve ose ndarjeve – ngacmimi mund të ndodh midis dy personave që më parë kanë qenë miq ose në një lidhje, dhe marrëdhënia e tyre ka përfunduar keq dhe cyber-bullying mund të bëhet për hakmarrje ose nga xhelozia.
- Nga mërzia ose dëshira për të njohur një person të ri në internet, ky lloj ngacmimi zakonisht është anonim.
- Nga vetmia dhe izolimi – njerëzit që luftojnë me ndjenjën e vetmisë dhe izolimit nga shoqëria, ose që ndjehen të injoruar nga të tjerët, ata mund të sulmojnë si një mënyrë për t'u ndjerë më mirë ose për të shfryrë zemërimin e tyre.²⁷
- Mendojnë që nuk do të zbulohen, sepse anonimiteti u jep atyre siguri për të kryer ngacmime kibernetike.
- Janë mërzitur apo bezdisur nga përditshmëria – këta persona që janë mërzitur kryejnë ngacmime kibernetike për argëtim, për të shtuar pak emocion dhe dramë në jetën e tyre, për të tërhequr vëmendje, etj.²⁸

²⁶ Delete cyberbullying, Why do people cyberbully, <https://www.endcyberbullying.net/why-do-people-cyberbully>

²⁷ CUNCIC, Arlin, The psychology of cyberbullying, 2022, <https://www.verywellmind.com/the-psychology-of-cyberbullying-5086615>

²⁸ GORDON, Sherri, 8 motives behind why kids cyberbully, 2020, <https://www.verywellfamily.com/reasons-why-kids-cyberbully-others-460553>

2.1.2. Viktimat e Cyber-bullying

Poashtu, edhe viktimë e cyber-bullying mund të jetë kushdo, kështu:

- fëmijët dhe të rinjët (adoleshentët) janë më të rrezikuarit;
- në rastet kur përhapen thashetheme të rreme dhe kur shpërndahen imazhe eksplicite, në këto raste vajzat kanë më shumë gjasa të jenë viktimat, por viktimat mund të jenë edhe djemt poashtu;²⁹
- komuniteti LGTB – njerëzit që janë homoseksualë, lezbike, biseksualë ose transgjinjorë mund të jenë viktimat më shpesh;
- personat që janë të turpshëm, që ndihen në siklet, nuk përshtaten lehtë, nuk janë shumë social, më lehtë mund të bëhen viktimat;
- njerëzit nga familjet me të ardhura më të ulta apo shtresa e ulët kanë më shumë gjasa të jenë viktimat;
- njerëzit që e përdorin internetin vazhdimisht kanë më shumë gjasa të bëhen viktimat, sidomos ata njerëz që kanë ndjekës të shumtë në mediat sociale janë më shpesh objektiva të ngacmuesve kibernetik (si blogerët, njerëzit e famshëm).

Pra, kushdo mund të jetë viktimë e cyber-bullying, edhe personat që konsiderohen figura publike dhe janë të njohur.³⁰

2.1.2.1. Cilat janë shenjat e Cyber-bullying te viktimat?

Shumë fëmijë, adoleshent, por edhe njerëz të tjerë që janë ngacmuar online, janë bërë viktimat të cyber-bullying, nuk duan që këtë ta ndajnë apo t'i tregojnë mësuesit, prindërvë ose dikujt që i besojnë, shpesh sepse ata ndihen të turpëruar ose kanë frikë se pajisjet e tyre do t'ju merren në shtëpi.

Shenjat e cyber-bullying tek viktimat ndryshojnë, por mund të përfshijnë:

- mërzitje emocionale gjatë ose edhe pas përdorimit të internetit ose telefonit, gjë që është e dukshme;

²⁹ 11 facts about cyberbullying, <https://www.dosomething.org/us/facts/11-facts-about-cyber-bullying>

³⁰ CUNCIC, Arlin, The psychology of cyberbullying, 2022, <https://www.verywellmind.com/the-psychology-of-cyberbullying-5086615>

- kalimi i kohës më shumë se zakonisht në dhomën e tyre;
- tërheqje ose mungesa e interesit për anëtarët e familjes dhe miqtë;
- shpreh ngurrim ose refuzon të marrë pjesë në aktivitetet e pëlqyera më parë;
- refuzon të shkojë në shkollë ose shpreh zemërim, pakënaqësi për një klasë apo për shkollën e caktuar në përgjithësi;³¹
- shmangia e mbledhjeve në shkollë ose grup;
- rënia e suksesit në shkollë;
- ndryshime të gjendjes emocionale, në humor, në sjellje, në oreks, ç'rregullim i gjumit, dhembje e kokës, humbje e pashpjegueshme e peshës ose shtim në peshë, stres etj.;
- papritmas dëshira për të ndaluar përdorimin e kompjuterit ose paisjeve tjera si telefon, tabletë etj.;
- shfaqje e nervozizmit ose shqetësim kur vjen ndonjë mesazh, tekst ose email në telefon;
- të qenurit shumë i fshehtë dhe mbrojtës i jetës sociale;
- shfaqja e shenjave të depresionit dhe trishtimit;³²
- bërja e deklaratave për vetëvrasje për shkak të gjendjes jo të mirë ose tentativë për vetëvrasje, ose lëndim i vetvetës (prerja, goditja e vetës, goditja e kokës); etj.³³

2.1.2.2. Efektet dhe pasojat e Cyber-bullying

Kur ngacmimi është duke ndodhur online, njeriu ndjehet sikur është duke u sulmuar kudo, madje edhe brenda shtëpisë së tij, ndjehet sikur nuk ka shpëtim. Pasojat e ngacmimit kibernetik padyshim që janë afatgjata, që çojnë në probleme serioze, duke e prekur një person në shumë mënyra, si:

- Psiqikisht – ndihet i mërzhitur, i turpëruar, torollak, madje edhe i frikësuar apo i zemëruar;
- Emocionalisht – ndihet i turpëruar dhe i humbur, duke i humbur edhe interesi për gjërat që më herët i ka bërë me dëshirë dhe vullnet;

³¹ Cyberbullying warning signs, <https://www.adl.org/resources/tools-and-strategies/cyberbullying-warning-signs>

³² DOVI, Allison T., Cyberbullying, 2020, <https://kidshealth.org/en/parents/cyberbullying.html>

³³ HARTUNG, Emily, The 10 warning signs of cyberbullying, 2018, <https://www.netnanny.com/blog/the-10-warning-signs-of-cyberbullying/>

- Fizikisht – i lodhur (çrregullim i gjumit) ose përjetim i simptomave si dhembje barku, koke etj.³⁴

Kjo ndjenjë që gjatë ngacmimit e përjeton viktimja, e sjell atë në gjendje që nuk mund të flasë, e pengon përpjekjen e tij për ta zgjidhur problemin. Viktimja ndjehet e poshtëruar dhe fillon të ndjejë stres të fortë, ankthe, depresion, humbje të vetëbesimit, pasiguri etj.³⁵

Në rastet ekstreme, cyber-bullying mund të çojë edhe në vetëvrasje.

Pra, cyber-bullying dëmton imazhin e një personi, duke e penguar reputacionin e tyre me thashethemet e rreme që përhapen. Prandaj pasojat janë më afatgjate në krahasim me bullizmin tradicional, sepse në rastin e ngacmimit online, gjithçka që publikohet mund të shihet nga shumë njerëz dhe përhapet me shpejtësi shumë të madhe. Kështu, një thashethem i rremë shkatërron jetën e shumë njerëzve, sepse me cyber-bullying nuk pëson vetëm viktimja, por edhe të tjerët.³⁶

Viktimave u krijohet një ndjenjë paranoje, ku ata do të jetojnë gjithmonë me mendime dhe dyshime për vetën e tyre dhe do të fillojnë të dështojnë në të gjitha aspektet e jetës së tyre, si në punë, ashtu edhe në jetën akademike, e veçanërisht në aspektin shoqëror.³⁷

2.2. Karakteristikat e Cyber-bullying

Karakteristikë e cyber-bullying është se ai mund të jetë: i vazhdueshëm, i përhershëm dhe shumë pak i dukshëm, kështu:

- I vazhdueshëm – shumica e studentëve, por edhe njerëzve në përgjithësi tani kanë akses në internet në çdo kohë 24/7, që do të thotë se cyber-bullying mund të ndodhë në çdo kohë – në mëngjes, pasdite dhe në mbrëmje, jo vetëm kur fëmijët janë në shkollë, por edhe kur janë në shtëpi ose në komunitet.

³⁴ UNICEF, Cyberbullying: What is it and how to stop it, 2022, <https://www.unicef.org/end-violence/how-to-stop-cyberbullying>

³⁵ KidsofKosova, Ngacmimi kibernetik, kambanat e alarmit që prindërit e mësuesit nuk duhet të neglizhojnë, 2021, <https://kidsofkosova.net/ngacmimi-kibernetik-kambanat-e-alarmit-qe-prinderit-e-mesuesit-nuk-duhet-te-neglizhojne/>

³⁶ Toppr, Cyber Bullying Essay for Students and Children, <https://www.toppr.com/guides/essays/cyber-bullying-essay/>

³⁷ Tecno analista, Ngacmimi kibernetik, <https://eltecnoanalista.com/sq/acoso-cibernetico/>

- Pak i dukshëm ose vështirë për t’u zbuluar – përderisa disa ngacmime ndodhin shumë hapur, janë të dukshme, cyber-bullying ndodh përmes telefonave, kompjuterëve ose tabletëve dhe kjo gjë e bën shumë më të vështirë zbulimin e kësaj dukurie negative.
- I përhershëm – pasi diçka shpërndahet në internet, shpesh është e disponueshme për të gjithë, kudo. Është shumë e vështirë ta fshish plotësisht nga internet diçka që më është publikuar, ajo mund të mbese aty për gjithë jetën.
- Anonim – mund të bëhet në mënyrë anonime. Ata që ngacmohen mund të mos e dinë fare se kush është duke i ngacmuar, dhe kjo gjë e bën më të lehtë që një person ta lëndojë tjetrin, sepse nuk dihet identiteti i ngacmuesit, mbetet i pa zbuluar dhe nuk mban asnjë përgjegjësi.
- Shpërndahet potencialisht në një audiencë më të madhe – çdo sjellje ngacmuese që postohet online shpërndahet lehtësisht dhe shpejt bëhet virale, gjë që e bën të vështirë ndalimin e mesazheve negative pasi ato të publikohen.
- Më lehtë të lëndohesh – shpesh është më lehtë të ngacmohesh dikë duke e përdorur teknologjinë për shkak të distancës më të madhe fizike. Ngacmuesi kur ngacmon nuk e sheh menjëherë reagimin, përgjigjen e personit që e ka ngacmuar, që e ka synim ta lëndojë. Prandaj kjo e bën që ngacmuesi të mos e dijë dëmin serioz që e ka shkaktuar me veprimet e tij, sepse teknologjia i largon ata nga dhimbja dhe përjetimet e jetës reale.

Avantazhi i vetëm i “përhershshmërisë” është së ngacmimi në internet lë prova të qarta. Ndryshe nga ngacmimi fizik ose emocional, ngacmimi në internet lë një gjurmë digjitale: fjalët, imazhet ose videot e postuara mund të dokumentohen përmes pamjeve të ekranit (screenshots) ose ruajtjes së URL-ve dhe teksteve, të cilat mund të jenë të dobishme.³⁸

2.3. Identifikimi i Cyber-bullying

Në rastet kur zbulohet se dikush është duke përjetuar cyber-bullying, është e nevojshme që të bisedohet me viktimën dhe familjen e viktimës, duke e bërë atë të shohë se ai/ajo po

³⁸ Pacer’s National bullying prevention center, Cyberbullying definition, <https://www.pacer.org/bullying/info/cyberbullying/>

jeton një situatë të pamertuar për të cilën nuk ka faj, dhe duhet ndihmuar në raportimin e rastit dhe t'i jepet mbështetje e nevojshme edhe në vazhdim, duke i mbledhur provat e nevojshme që dëshmojnë se është kryer ngacmim kibernetik.³⁹

Identifikimi padyshim që bëhet në bazë të provave që ka lënë ngacmuesi, sepse cyber-bullying përderisa bëhet online, dëshmitë janë aty edhe nëse heq dorë ngacmuesi, p.sh. e bën fshirjen e postimit që ka bërë, ai post mund të jetë shpërndarë tani më dhe është e vështirë që të hiqet plotësisht nga internet, prandaj dëshmitë zakonisht gjenden aty ose ruhen nga viktimat varësisht se në çfarë forme dhe mënyre është bërë ngacmimi kibernetik.

Dëshmitë që duhen ruajtur janë: platforma ku është shpërndarë përmbajtja e dëmshme apo ku është kryer cyber-bullying, adresa (webfaqe) apo linku (URL) ku është bërë cyber-bullying, emrat e përdoruesve të llogarive (username, profiles) dhe URL-të e këtyre profileve që i kanë përdorur për cyber-bullying, ora dhe data kur është dërguar ose shpërndarë cyber-bullying dhe çdo informacion tjetër që mund të provojë se është kryer cyber-bullying, padyshim që screenshots (pamjet e ekranit) janë më të rëndësishmet.⁴⁰

Dëshmitë e mbledhura duhet të paraqiten në organet kompetente, të raportohet rasti që të ndërmerren hapa të menjëhershëm për parandalim.

Varësisht se kush dhe kur është duke përjetuar cyber-bullying, së pari duhet të bisedohet çështja me prindërit, t'u tregohet atyre, pastaj të paraqitet në shkollë, nëse cyber-bullying është duke ndodhur në shkollë, që të merren masa adekuate dhe pastaj shkolla vendos se si ta trajtojë rastin varësisht rregullave, por nëse bëhet fjalë për cyber-bullying që i tejkalon kufijtë, ka kaluar në vepër penale atëherë patjetër të raportohet në polici dhe institucione tjera kompetente për cyber-bullying, varësisht shtetit dhe si e kanë të rregulluar me ligj, që ata t'i marrin masat adekuate për parandalim, përpara se të eskalojë situata dhe të shkojë në ekstrem, sepse viktimat pëson shumë, prandaj duhet të merren masa të menjëhershme për të ndihmuar viktimën t'a tejkalojë situatën dhe të zbulohet se kush gjendet pas cyber-bullying.

Dikush mund të kryejë cyber-bullying drejtpërsëdrejti, duke u shfaqur me profilin e tij personal në rrjetet sociale, por këto janë raste më të rralla, sepse zakonisht kur dikush kryen

³⁹Bullying në internet: analizimi i karakteristikave të ngacmimit virtual, <https://sg.warbletoncouncil.org/ciberbullying-acoso-virtual-3828>

⁴⁰eSafetyCommissioner, How to collect evidence, <https://www.esafety.gov.au/report/how-to-collect-evidence>

cyber-bullying krijon profile të rreme dhe mundohet që të mos lë asnjë gjurmë në profilin e tij që të zbulohet se kush është.

Për këtë arsye është e vështirë që të bëhet zbulimi i ngacmuesit, por nuk është e pamundur, sepse tani ka hakerë dhe persona kompetent që merren me zbulimin e ngacmuesve online dhe duke përdorur metoda të ndryshme e zbulojnë edhe identitetin e ngacmuesit, p.sh.: në bazë të ndonjë të dhëne që ka lënë ngacmuesi në profilin e tij si emër mbiemër, adresa, kontakt telefoni, e-mail apo diçka tjetër, lokacionit prej ku është dërguar apo shpërndarë ngacmimi kibernetik, shkrimit të tij etj., mjafton edhe ndonjë detaj i vogël për t'a zbuluar ngacmuesin.

2.4. Cyber-bullying sipas gjinisë

Sipas të dhënave statistikore mendohet se, vajzat kanë më shumë gjasa se djemt të jenë edhe ngacmuese edhe viktimizuese të ngacmimit kibernetik.⁴¹

Studimet e mëparshme kanë treguar se femrat më shumë se meshkujt kanë gjasa të postojnë thashetheme në internet për të lënduar njerëzit e tjerë që mund t'i njohin, qofshin ato të vërteta apo të rreme.

Femrat preferojnë të fshihen pas ekranave të kompjuterit dhe të bëjnë ngacmime kibernetike për dikë që mund të mos e pëlqejnë. Pse? Sepse femrat preferojnë të marrin pjesë në sjellje që nuk janë fizikisht konfrontuese dhe duke u fshehur pas mbrojtjes së një kompjuteri apo telefoni, ato mund të shfaqin sjelljen e tyre si të dëshirojnë.

Ndryshe nga femrat që postojnë informacione me qëllimin për të lënduar të tjerët, meshkujt nga ana tjetër sulmojnë të tjerët me kërcënime dhe fyerje.

Është e vështirë të thuhet se sa shpesh ndodh ngacmimi kibernetik brenda popullatës mashkullore. Sepse, kur merren në pyetje meshkujt, ndonjëherë përdorin deklaratatë të cilat i japin në mënyrë që të mos lëndojnë krenarinë ose egon e tyre. Meshkujt shpesh u përgjigjen pyetjeve në një mënyrë që të mos duken si viktima.⁴²

⁴¹ TODOROV, Georgi, Crucial cyberbullying statistics, trends, and facts 2022,

<https://thrivemyway.com/cyberbullying-stats/#:~:text=Girls%20are%20more%20likely%20than,the%20average%20rate%20of%2020%25.>

⁴² Cyberbullying, Male and female differences, <https://thecyberbullyexplained.weebly.com/male-and-female->

2.5. Parandalimi i Cyber-bullying

Ngacmimi kibernetik mund të konsiderohet krim, vepër penale për shkak të kërcënimeve, poshtëtimeve, gënjeshtreve dhe shtrëngimive që i bëhen viktimës. Kushdo që e përjeton atë duhet që ta raportojë në polici, gjykatë ose prokurori, organe kompetente që merren me zbulimin dhe parandalimin e cyber-bullying, organizata joqeveritare kompetente, ose edhe online nëpër webfaqe të ndryshme që kontrollohen nga shteti që janë krijuar veçanërisht për të raportuar raste të cyber-bullying. Raportimi bëhet edhe duke bërë ankesë apo duke ngritur padi në bazë të provave që dëshmojnë se viktima ka pësuar ngacmim kibernetik.⁴³

Tani thuajse të gjitha shtetet në botë po përballen me këtë dukuri negative, gjë për të cilën duhet të merren masa për parandalim.

Janë disa hapa që mund të ndërmerren për të parandaluar cyber-bullying, si:

- 1) Edukoni veten tuaj. Për të parandaluar një dukuri negative si cyber-bullying, së pari duhesh të dish saktësisht se ç'farë është, me ç'farë ka të bëjë, si dhe ku ndodh etj;
- 2) Mos i tregoni askujt, përveç prindërve, fjalëkalimet tuaja;
- 3) Mos i bëni publike llogaritë e rrjeteve sociale ose mos jepni të dhëna personale si adresën ku jetoni, numrin e telefonit dhe e-mail adresën;
- 4) Mos i dërgoni askujt ose mos postoni fotografi intime/personale;
- 5) Mos iu përgjigj ngacmuesëve, mund t'i bllokoni ata ose t'i injoroni;
- 6) Mos i lexoni mesazhet dhe mos komunikoni me këta ngacmues;
- 7) Ruani dëshmitë lidhur më ngacmimin kibernetik;
- 8) Tregoni prindërve tuaj nëse bëheni viktimë e ngacmimit kibernetik;⁴⁴
- 9) Mos klikoni në linke të dyshimta, misterioze, sepse mund të jenë mashtrime dhe mund t'ju merren gjitha të dhënat personale prej telefonit; etj.

[differences.html](#)

⁴³ Ngacmimi në internet: çfarë është dhe si ta ndaloni atë, <https://madreshoy.com/sg/ciberacoso-que-es-y-como-detenerlo/>

⁴⁴ Ngacmimi kibernetik, 2018, <https://busulla.com/articles/88>

Si mund të ndihmojnë prindërit?

Familja bën pjesë në faktorët e jashtëm – mikrogruporë e cila luan rolin më të rëndësishëm në formimin dhe edukimin e një individi. Gjeneza e një njeriu fillon e zhvillohet nga familja, prandaj si bashkësi jetësore familja e ka rolin më të rëndësishëm për pasardhësit e saj, sepse nga ajo formohet personaliteti bazë dhe identiteti personal.

Prindërit e kanë peshën më të madhe për rritjen dhe edukimin e fëmijës së tyre, ata ndikojnë në sjelljen e fëmijës, prandaj çysh në moshën e hershme duhet të merren masa duke i mësuar fëmijës se ç'farë është e keqe apo e gabuar dhe ç'farë është mirë apo e drejtë, sepse edukimi bëhet çysh në moshë të re.

Prindërit përpos angazhimeve me punët e tyre, primare duhet të kenë jetën e fëmijëve të tyre, prandaj duhet të hapërojnë me kohën, sepse në kohën që po jetojmë gati se çdo ditë ka risi të reja dhe prindërit duhet t'i kushtojnë rëndësi gjërave, t'a marrin edhe ata edukimin dhe informimin e nevojshëm për çdo gjë, që më pas t'ua përcjellin fëmijëve të tyre në mënyrën më të përsosur.

Tani që kohërat kanë ndryshuar, fëmijët e kohës së sotit nuk janë më si përpara, sepse vetë jeta ua imponon që ata të jenë më ndryshe, më të përparuar në të gjitha aspektet, kjo për arsye se shkollimi ka ndryshuar, njerëzit kanë ecur me kohën dhe jeta ka marrë një kahje tjetër, bota tani sillet rreth teknologjisë, rrjetet sociale kanë bërë për vete të gjithë njerëzimin.

Disa veprime që duhet t'i ndër marrin prindërit janë:

- T'i ofrojnë mbështetje fëmijës së tyre, duke i'a treguar ndonjë eksperiencë bullizimi në jetën e tyre që e kanë kaluar, kjo do t'i ndihmojë fëmijës të ndihet më pak vetëm.⁴⁵
- T'i tregojnë fëmijës që nuk është faji i tij, për atë që ka ndodhur. T'a lavdërojnë atë duke i thënë që ka bërë gjënë e duhur që u ka treguar prindërve, dhe t'u japin atyre siguri që kjo do të zgjidhet sëbashku, se nuk do t'i lënë vetëm.
- Ta njoftojnë shkollën, duke e paraqitur rastin tek drejtori, stafit administrativ apo mësimdhënësi për situatën që ndodhet fëmija i tyre. Shumë shkolla, kanë rregulla për t'iu përgjigjur ngacmimit kibernetik, këto rregulla ndryshojnë sipas shtetit, varësisht si e kanë të rregulluar.

⁴⁵ HINDUJA, Sameer, PATCHIN, Justin W., Cyberbullying: Identification, Prevention, and Response, 2021, <https://cyberbullying.org/Cyberbullying-Identification-Prevention-Response-2021.pdf>

- Duhet ta mësojnë fëmijën që të mos përgjigjet ndaj ngacmimit në internet, sepse, të bësh këtë thjesht e përkeqëson situatën.
- Përveç kësaj gjithashtu prindërit duhet t'u tregojnë fëmijëve që të mbajnë shënime, dëshmi për ta dokumentuar rastin. Të mbajnë pamjet e ekranit të mesazheve (screenshots), fotografive dhe teksteve kërcënuese. Pastaj këto mund të përdoren si provë kundër ngacmuesit, të paraqiten në shkollë dhe në polici kur rasti është më i ndërlikuar.
- Përveç këtyre, prindërit duhet që në këto raste të bllokojnë ngacmuesin, apo të bllokojnë mesazhe, tekste, e-maila nga njerëz të caktuar.
- T'ua kufizojnë aksesin apo kohën e qëndrimit në rrjete sociale fëmijëve të tyre, në orë të caktuara sa e kanë të nevojshme disa orë mbrenda ditës, gjithashtu ka aplikacione që përfshijnë opsione të kontrollit prindëror që u japin prindërve akses në mesazhet e fëmijëve të tyre dhe jetën në internet. Gjithashtu tani teknologjia u lejon prindërve edhe monitorimin e rrjeteve sociale të fëmijëve të tyre, gjë që lajmrohen për kohën e qëndrimit në internet, paralajmërohen për ndonjë foto apo gjuhë të papërshtatshme etj.⁴⁶

Si përfundim, ndërgjegjësimi është çelësi për të parandaluar ngacmimet në internet. Fëmijët duhet t'i ndërgjegjësojmë qysh në moshë të re, në mënyrë që ata të jenë gjithmonë të kujdesshëm edhe ndaj ngacmimeve kibernetike që ata mund t'i marrin, po edhe vetë të mos bëhen ngacmues (bullizues) ndaj të tjerëve. Pra, mësojuni fëmijëve që duhet t'i trajtojnë të tjerët njejt sikurse dëshirojnë ata që të trajtohen "treat other as you want to be treated".⁴⁷

Për më tepër, prindërit duhet të monitorojnë aktivitetet e fëmijëve të tyre në internet dhe të kufizojnë përdorimin e tyre. Më e rëndësishmja, ngacmimi kibernetik duhet të raportohet menjëherë pa vonesë. Kjo mund të parandalojë që të ndodhin ngacmime të mëtejshme.⁴⁸

⁴⁶ DOVI, Allison T., Cyberbullying, 2020, <https://kidshealth.org/en/parents/cyberbullying.html> ; <https://busulla.com/articles/88>

⁴⁷ LENCH, Brooke De, 10 Tips for Teens to Prevent Cyberbullying, <https://www.momsteam.com/health-safety/10-tips-teens-prevent-cyberbullying>

⁴⁸ Toppr, Cyber Bullying Essay for Students and Children, <https://www.toppr.com/guides/essays/cyber-bullying-essay/>

Si mund të ndihmojë shkolla?

Pas familjes, shkolla zë vendin më të rëndësishëm për edukimin e gjeneratave të reja.

Përderisa statistikat tregojnë se bullizmi tradicional, por edhe ngacmimi kibernetik ndodh më së shpeshti nëpër shkolla, kontributi i shkollave në këtë çështje është me peshë të madhe, ku duhet të merren masa për parandalim dhe edukim të fëmijëve dhe adoleshentëve.

Edhe roli i shkollës është thujtë i njëjt. Shkolla duhet të jetë në bashkëpunim me prindërit dhe me institucionet tjera kompetente për të parandaluar edhe për të zgjidhur çështjet kur përballen me këtë dukuri negative. Shkolla duhet të ketë një rregullore që tregon dhe ndëshkon cyber-bullying, e cila rregullore duhet të jetë në përputhje me ligjin e shtetit, por nëse s'ka ligj atëherë duhet të merren për bazë dokumente, rregulla që i kanë sjellur institucionet kompetente për të zgjidhur raste të cyber-bullying.

Shkolla duhet t'i edukojë fëmijët rreth cyber-bullying, se ç'farë është dhe gjithçka lidhur me të, poashtu edhe t'i përgadisë si të veprojnë nëse ata përballen ndonjëherë në jetën e tyre me cyber-bullying, sepse fëmijët i përjetojnë më rëndë situatat e cyber-bullying, në krahasim me të rriturit.⁴⁹

Rrjetet sociale dhe cyber-bullying

Një prej shqetësimeve më të mëdhe të platformave të mediave sociale është bërë cyber-bullying dhe padyshim që po kontribuojnë në parandalimin e kësaj dukurie.

Instagram dhe **Facebook** po përpiqen të gjejnë një zgjidhje efektive të këtij problemi duke lançuar mjete të reja për të mbrojtur përdoruesit nga të qenurit viktima.

Instagram ka një opsion që quhet "*Hide offensive words and phrases – Fshih fjalët dhe shprehjet fyese*" ose "*Hide comments*", i cili është i përcaktuar për të gjithë njerëzit dhe shërben për të fshehur fjalët, komentet, fraza ose emoji që përmbajnë sulme ndaj pamjes ose karakterit të një personi, si dhe kërcënime për mirëqenien ose shëndetin e një personi. Në këtë opsion do të filtrohen automatikisht nga inteligjenca artificiale e instagramit (AI) të gjitha komentet që kjo inteligjencë artificiale i shënon si potencialisht fyese ose që synojnë të ngacmojnë njerëzit. Tek "*Hide comments*" është një opsion "*Menage list*" që të ofron mundësinë që të bëni ju vetë një

⁴⁹ How to Prevent and Stop Cyberbullying in Schools: 6 Effective Ways, <https://www.positiveaction.net/cyberbullying-prevention>

listë me fjalë, komente, fraza, emoji që nuk dëshironi t'i shihni në komente në profilin tuaj⁵⁰.

Opsion tjetër kundër ngacmimit është edhe paralajmrimi për përdoruesit kur ata dëshirojnë që të postojnë ndonjë foto ose video në profilet e tyre, dhe në to duan të lënë ndonjë shënim, ose bëjnë ndonjë koment, dhe nëse në këtë shënim ose në koment janë përdodur shprehje “potencialisht fyese” intelgjencia artificiale (AI) do t'a filtrojë çdo fjalë që gjykon se është ofenduese dhe përdoruesi do të marrë një njoftim që e paralajmron se shprehjet e tij janë fyese dhe përcjellin ngacmim kibernetik, prandaj u jepet mundësia për të modifikuar postimin apo komentin që ata e kanë bërë më parë.

Ju gjithmonë mund të bllokoni (*block*) ose hijezoni (*mute*) një llogari që ju ngacmon dhe kjo llogari (*profile*) nuk do të njoftohet. Nëse nuk ndiheni rehat duke ndërmarrë këto veprime, *Restrict* (kufizimi) është një opsion i krijuar të mbron në mënyrë diskrete llogarinë tuaj, ndërkohë që vazhdoni të mbani në vëzhgim një ngacmues, sepse kur i bëni restrict, ngacmuesi nuk do të njoftohet për këtë, mirëpo komentet që do t'i bëjë në të ardhmen në profilin tënd do t'i shohë vetëm ngacmuesi dhe ju, gjithashtu ngacmuesi nuk do të mund t'ju shohë kur jeni aktiv ose kur i keni lexuar mesazhet e tyre direkte.⁵¹

Një tjetër shqetësim është procesi i bllokimit të një llogarie, profili. Normalisht nuk pranoni mesazhe apo komunikimi prej tyre pasi ti keni bllokuar, por kjo nuk e ndalon atë t'ju komunikojë nga një llogari tjetër. Me opsionin e ri shtuar së fundi, përdoruesit kur zgjedhin të bllokojnë dikë, mund të zgjedhin të bllokojnë çdo llogari të re krijuar nga ai person.⁵²

Përdoruesit e mediave sociale tani do të jenë në gjendje të fshijnë komentet me shumicë dhe të bllokojnë ose kufizojnë shumë llogari në të njëjtën kohë. Më parë, përdoruesit mund të fshinin dhe bllokonin vetëm një llogari në të njëjtën kohë. Tani, njerëzit mund të fshijnë deri në 25 komente në të njëjtën kohë dhe mund të bllokojnë shumë llogari në të njëjtën kohë.

Tik tok gjithashtu ofron opsione për siguri, si:

⁵⁰ Instagram help center, <https://help.instagram.com/700284123459336>

⁵¹ UNICEF, Cyberbullying: What is it and how to stop it, 2022, <https://www.unicef.org/end-violence/how-to-stop-cyberbullying>

⁵² Instagram lançon mjete për parandalimin e ngacmimit në platform, 2021, <https://pcworld.al/instagram-lancon-mjete-per-parandalimin-e-ngacmimit-ne-platforme/>

- Mund të kufizosh se kush komenton në videot e tua për askënd (*no one*), vetëm për miqtë (*just friends*) ose për të gjithë (*everyone*) - (për ata nën 16 vjeç, ne kemi hequr cilësimin everyone).
- Ju mund të filtroni të gjitha komentet ose ato me fjalë kyçe specifike (*keywords*) që ju zgjidhni si komente të padëshiruara dhe ofenduese, dhe nuk doni t'i shihni.
- Ju mund të fshini ose raportoni komente të shumta në të njëjtën kohë, si dhe mund të bllokoni llogaritë që postojnë komente ngacmimi ose negative, deri në 100 në të njëjtën kohë, dhe shumë opsione tjera të ngjajshme siç i cekëm edhe më lartë.

Gjithashtu edhe në **Twitter**, nëse njerëzit bëhen të bezdisshëm ose negativ, mundet që t'i përdorni opsionet si: *Heshtja* – heqja e Tweets e një llogarie nga kronologjia juaj pa hequr ndjekjen ose bllokuar atë llogari, *bllokoni* – kufizoni llogaritë specifike që të mos ju kontaktojnë, të shohin Tweets tuaj dhe t'ju ndjekin, *raporti* – paraqitja e një raporti në lidhje me sjelljen abuzive.⁵³

Disa këshilla që duhet t'i kemi parasysh gjatë përdorimit të mediave sociale (safety tips):

- ✓ Asnjëherë mos u jepni njerëzve të tjerë informacione për fjalëkalimin tuaj;
- ✓ Asnjëherë mos jepni të dhëna personale si adresë, numër telefoni, lokacion;
- ✓ Aplikoni masat më të forta të sigurisë së llogarisë, në mënyrë që vetëm miqt dhe familja t'i shohin postimet;
- ✓ Kini kujdes kur klikoni në linqe dhe mos klikoni linqe nga njerëz të panjohur;
- ✓ Asnjëherë mos shtoni apo pranoni si miq në rrjetet sociale njerëz që nuk i njihni;
- ✓ Përdorni fjalëkalime të forta dhe ndryshoni ato rregullisht;
- ✓ Mos i'u përgjigj asnjë mesazhi apo email kërcënues apo fytes;
- ✓ Respektoni udhëzimin për kriterin e moshës që vendosin rrjetet sociale;⁵⁴
- ✓ Ruaj çdo detaj të mesazheve ose email-eve që merr;
- ✓ Blloko dhe raportto adresat (profilet) nga vijnë mesazhet dhe tekstet kërcënuese;
- ✓ Mos lejoni që programet të gjurmojnë vendndodhjen tuaj.⁵⁵

⁵³ MUÇA, Megi Asllani, Për shkak të pandemisë, bullizmi kibernetik është i zhvilluar tek fëmijët, 2021, <https://civilalb.info/2021/04/26/per-shkak-te-pandemise-bullizmi-kibernetik-eshte-i-zhvilluar-tek-femijet/>

⁵⁴ Mediat Sociale dhe Fëmijët, <https://www.isigurt.al/fakte-dhe-te-dhena/mediat-sociale-dhe-femijet>

Liria në Internet dhe vlerat njerëzore duhen mbrojtur në të njëjtën mënyrë si jashtë Internetit. Ende nuk ka asnjë ligj apo traktat ndërkombëtar që drejtpërdrejt e rregullon të drejtën e aksesit në internet, mirëpo në këtë drejtim është duke u punuar, ku organizata të ndryshme ndërkombëtare në botë, njerëz të fushave të ndryshme, përveç të drejtave themelore të njeriut që u janë garantuar me dokumente ndërkombëtare, ata janë duke bërë përpjekje që të sjellin një dokument ndërkombëtarë i cili do të garantonte të drejtat e njeriut në internet. Deri tani është sjellur një kartë e titulluar *“Karta e të Drejtave të Njeriut dhe Parimet për Internetin - The charter of human rights and principles for the internet”*, qëllimi i së cilës është rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen dhe gëzimin e të drejtave të njeriut në internet (online) dhe jashtë linje (offline) në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.⁵⁶

Të drejtat në internet ose dixhitale janë të drejta të individëve në lidhje me aksesin në kompjuter dhe aftësinë për të përdorur, krijuar dhe publikuar media dixhitale. Të drejtat dixhitale janë zgjerime të të drejtave të njeriut si liria e shprehjes dhe e drejta për privatësi.⁵⁷

Disa nga të drejtat dixhitale janë:

- Qasje universale dhe e barabartë në internet
- Liria e shprehjes, informimit dhe komunikimit
- Privatësia dhe mbrojtja e të dhënave
- E drejta e anonimitetit
- E drejta për t'u harruar
- Sigurimi i provave elektronike
- Mbrojtja e të miturve
- Pronësia intelektuale.⁵⁸

⁵⁵ ASO Staff Writers, Cyberbullying in School: Prevention and Support, 2021,

<https://www.accreditedschoolsonline.org/resources/cyberbullying-prevention-and-support/>

⁵⁶ IGF, UN, The charter of human rights and principles for the internet,

<https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Opinion/Communications/InternetPrinciplesAndRightsCoalition.pdf>



⁵⁷ TechTarget Contributor, Digital rights, 2017, <https://www.techtarget.com/whatis/definition/digital-rights>

⁵⁸ STEVANOVIC Ana, RISTESKI Oliver, WEASA, Cyber bullying, stalking, online harassment in North Macedonia and Serbia, 2022, <https://www.weasa.org/wp-content/uploads/2022/02/Research-on-Cyberbullying-in-North-Macedonia-and-Serbia.pdf>

Stop Cyberbullying Day është një ngjarje vjetore që bashkon miliona njerëz nga e gjithë bota për të festuar dhe promovuar një internet vërtet të larmishëm dhe gjithëpërfshirës.

E themeluar në vitin 2012 dhe e koordinuar çdo vit nga The Cybersmile Foundation, Stop Cyberbullying Day është një ditë globale ndërgjegjësimi dhe aktivitesh online dhe offline. Çdo të premte të tretë në qershor, Stop Cyberbullying Day inkurajon dhe fuqizon miliona njerëz në mbarë botën për të treguar angazhimin e tyre ndaj një interneti vërtet gjithëpërfshirës dhe të larmishëm.

Stop Cyberbullying Day bashkon përdoruesit e internetit, lojtarët, markat, akademikët, edukatorët, organet e medias, organizatat jofitimprurëse, qeveritë dhe figurat publike nga e gjithë bota. Ngjarja vjetore ofron një platformë të përsosur për të demonstruar ose rinovuar angazhimin ndaj një interneti më të sjellshëm dhe më gjithëpërfshirës. Përdoruesit e mediave sociale inkurajohen të përfshijnë #STOPCYBERBULLYINGDAY nëpër platformat sociale për të shprehur mbështetjen e tyre për ngjarjen.⁵⁹



⁵⁹ Stop Cyberbullying Day, <https://stopcyberbullyingday.org/>

KAPITULLI III

VËSHTRIME KRAHASIMORE

3.1. Vështrime të përgjithshme rreth Cyber-bullying në aspektin krahasimor

Për shkak të përhapjes së madhe dhe shtrirjes së kësaj vepre penale në të gjithë botën, e cila po përcillet me shumë dukuri negative dhe po lë pasoja të shumta në të gjithë shoqërinë, kërkohet që në këtë drejtim të merren masa që kjo problematikë të rregullohet me dispozita të caktuara ligjore. Andaj, shumë shtete të zhvilluara në botë kanë bërë ndryshime në legjislacionet e tyre pozitive, duke u mbështetur në rregulla ndërkombëtare, ku kanë inkorporuar rregulla të reja në ligjet e tyre, kanë bërë ndryshime ose kanë sjellur ligj të ri të veçantë për cyber-bullying, duke u përcaktuar kështu edhe baza juridike e cila e inkriminon cyber-bullying si vepër penale.

Në këtë kapitull do të hulumtojmë përpjekjet e disa shteteve në botë për pengimin apo parandalimin e cyber-bullying, si janë përballur me këtë dukuri negative dhe ç'farë veprimesh janë ndërmarrë. Sepse ligjet kundër bullizmit, veçanërisht kundër ngacmimit kibernetik, janë relativisht të reja dhe ende nuk ekzistojnë kudo. Dhe kjo është arsyeja pse shumë vende mbështeten në ligje të tjera përkatëse, të tilla si ato kundër ngacmimit, për t'i ndëshkuar ngacmuesit kibernetik.⁶⁰

3.2. Cyber-bullying në disa shtete në botë

Top tri vendet kryesore ku ngacmimi kibernetik është më i përhapuri dhe me shkallën më të lartë të rasteve të raportuara janë **India, Brazili dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës**. Holanda është një nga vendet me shkallën më të ulët të ngacmimit kibernetik. Dy vende të tjera me shkallën më të ulët të ngacmimit kibernetik janë Islanda dhe Spanja.⁶¹

Ndërgjegjësimi global për ngacmimin kibernetik është në 75%. Suedia dhe Italia

⁶⁰ UNICEF, Cyberbullying: What is it and how to stop it, 2022,

<https://www.unicef.org/northmacedonia/cyberbullying-what-it-and-how-stop-it>

⁶¹ DJURASKOVIC Ogi, Cyberbullying Statistics, Facts, and Trends (2022) with Charts, 2022,

<https://firstsiteguide.com/cyberbullying-stats/>

kryesojnë tabelën me 91% ndërgjegjësime, poashtu edhe Kili me 89% dhe Afrika e Jugut me 88%. Shtetet e Bashkuara kanë një nivel të lartë ndërgjegjësime prej 85%, por statistikat në lidhje me ngacmimin kibernetik tregojnë se numri po rritet vetëm ngadalë.⁶² Arabia Saudite, e cila mban vendin e fundit me 37% ndërgjegjësime dhe Franca ka nivel ndërgjegjësime vetëm 50%.⁶³

Për shkak se ngacmimi kibernetik është bërë një çështje kaq e dëmshme dhe vdekjeprurëse, ligjvënësit kanë krijuar ligje për ngacmimin kibernetik për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimat nga ngacmuesit në internet dhe për t'i sjellë këta ngacmues para drejtësisë.

Ka disa shtete, vende dhe territore anembanë globit që kanë zbatuar ligje të forta dhe efektive për ngacmimin kibernetik, si:

- **Kanada** - Sipas Ligjit të Arsimit, ngacmuesit kibernetik mund të pezullohen ose përjashtohen nga shkolla. Ngacmuesit recivist gjithashtu mund të përballen me dëbim dhe burgim të mundshëm.
- **Suedi** - njihet si një nga vendet e para që miratoi ligje kundër bullizmit. Ata kërkojnë që shkollat të kenë politika për të luftuar të gjitha format e bullizmit. Shkollat që nuk respektojnë mund të dërgohen në gjykatë.⁶⁴
- **Filipinet** - Sipas Ligjit të Republikës 10627, u takon shkollave të zbatojnë politika për të trajtuar ngacmimin kibernetik. Nëse drejtuesit e shkollave nuk zbatojnë ligjin e Republikës, ata përballen me sanksione nga qeveria.
- **Kina** - ka ligje të rrepta kundër bullizmit dhe është veçanërisht agresive në përpjekjet e saj për të trajtuar ngacmimin kibernetik. Kina miratoi së fundmi një ligj që u kërkon njerëzve të regjistrojnë apo të identifikohen me emrat e tyre të vërtetë në internet. Kjo i lejon qeverisë të gjurmojë më lehtë individët, duke detyruar kështu llogaridhënien për ato që njerëzit postojnë në internet.⁶⁵
- **Australi** - Sipas Natyrës Federale të Ligjit, krimet e ngacmimit në internet ndryshojnë nga territori në territor dhe ndonjëherë mund të përballen me pasoja ligjore. Këto

⁶² VOJINOVIC, Ivana, Heart-breaking Cyberbullying statistics for 2022, <https://dataprot.net/statistics/cyberbullying-statistics/>

⁶³ 47 statistika alarmuese nga bullizimi kibernetik te vitit 2020, <https://familjajone.com/47-statistika-alarmuese-nga-bullizimi-kibernetik-te-vitit-2020/>

⁶⁴ The Origin of Cyberbullying + 5 Ways to Identify and Prevent It, <https://dataoverhaulers.com/origin-of-cyberbullying/>

⁶⁵ A Guide to Worldwide Bullying Laws, <https://www.hcalawyers.com.au/blog/bullying-laws-around-the-world/>

pasoja në përgjithësi vijnë nga tre mjete ndjekjeje: ndërhyrja e shtetit, padi nga viktimat apo “Artikuli i kodeve të industrisë”.

- **Afrika e Jugut** - ka zbatuar ligje për të luftuar ngacmimin kibernetik duke kërkuar që ISP-të të dorëzojnë detajet e kontaktit të çdo individi që zbulohet se po ngacmon një tjetër. Fëmijët nën moshën 18 vjeçare gjithashtu mund t'i drejtohen gjykatave pa dijeninë e prindërve të tyre.
- Në vitin 2013 **Japonia** prezantoi një ligj që kërkon që shkollat të trajtojnë bullizmin, përfshirë ngacmimin kibernetik. Shkollave iu kërkuar të vepronin për të parandaluar rastet e ngacmimit dhe gjithashtu të raportonin incidentet kur ato lindnin.

3.2.1. Cyber-bullying në SHBA


Siç u cek edhe më lartë se, SHBA-të bëjnë pjesë në top tre vendet ku ngacmimi kibernetik është më i përhapuri dhe me shkallën më të lartë të viktimave. Në SHBA janë paraqitur edhe rastet e para të cyber-bullying, të cilat kanë përfunduar me vetëvrasje të viktimave dhe këto raste kanë ngritur vëmendje ndërkombëtare për të marrë masa të nevojshme për parandalim.

Në SHBA më shumë paraqiten si viktimat adoleshentët, të cilët pësojnë më së shumti në shkollë, sepse shkollat amerikane janë të njohura për bullizim, ku studentët viktimizohen çdo ditë, tani po bullizohen edhe përmes internetit. Kështu, në disa shtete amerikane shkollat kanë marrë masa në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave, duke zbatuar politika shkollore rreth ngacmimit kibernetik, duke i edukuar studentët rreth ngacmimit kibernetik dhe si të jenë të sigurt në internet, duke u ndihmuar viktimave të tejkalojnë gjendjen në të cilën janë me personat kompetent si pedagog, psikolog etj., duke pasur bashkëpunim të ndërsjelltë me prindërit e viktimave, poashtu duke pasur bashkëpunim edhe me institucione shtetërore dhe organizata tjera.

Në SHBA për t’ju ndihmuar viktimave të tejkalojnë gjendjen në të cilën gjenden pas viktimizimit nga vepra penale, pa marrë parasysh se për çfarë viktimizimi bëhet fjalë, pra në këtë rast përfshirë edhe viktimizimin nga cyber-bullying, krijojnë grupe mbështetëse të cilat quhen ‘Teen group support’ të cilat i organizojnë në shkolla ose edhe jasht shkollës dhe

pjesmarrjen në grupe të tilla mbështetëse ua rekomandojnë viktimave. Në këto grupe viktimat marrin pjesë dhe ndajnë historitë e tyre, kështu ata inkurajohen që të vazhdojnë më tutje. Qëllimi është që viktima të tejkalojë më me lehtësi pasojat, gjendjen emocionale dhe traumat që përjeton nga vepra penale, të cilët grupe kanë treguar rezultat të mirë në këtë drejtim.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë një republikë federale, ku të gjitha shtetet anëtare kanë ligje të ndryshme penale që mund të zbatohen për sjelljet ngacmuese, varësisht natyrës së veprimit kundërligjorë. Pra, secili shtet ka të drejtë vetë të vendosë se si dhe çfarë ligji do të zbatohet për të dënuar ngacmimet dhe si do të jenë sanksionet. Prej 50 shteteve anëtare, 48 prej tyre e kanë inkriminuar cyber-bullying si vepër penale në ligjet e tyre për ngacmim (bullizimin), 44 prej tyre kanë paraparë edhe sanksione për cyber-bullying, 45 shtete kanë paraparë edhe sanksione shkollore.⁶⁶



Disa nga shtetet anëtare të SHBA-së që e ndëshkojnë ngacmimin kibernetik dhe sanksionet:

- Shtetet e mëposhtme kanë zbatuar ligje për ngacmimin kibernetik që e dënojnë ngacmuesin kibernetik me pezullim ose dëbim: **Kalifornia, Connecticut, Kolorado dhe Illinois.**
- Në **Nju Xhersi** (SHBA), dënimi për ngacmimin kibernetik varion nga ndalimi deri te dëbimi.
- Në **Vermont** (SHBA), dënimi për ngacmimin kibernetik është dëbimi.

⁶⁶ State bullying laws across the U.S., https://cyberbullying.org/pdfs/2021_Bullying-and-Cyberbullying-Laws.pdf

- **Idaho** (SHBA) - Sipas "Ligjit të Jaredit", një student që kryen ngacmim kibernetik shpallet fajtor për kundërvajtje.
- **Hawaii** (SHBA) - Sipas ligjit SB2094, një student që përfshihet në ngacmim kibernetik gjobitet me 100 dollarë për shkelje.
- **Luiziana** (SHBA) - Sipas H.B.1259, Ligji 989, një student që përfshihet në ngacmim kibernetik gjobitet me 500 dollarë ose me burgim deri në gjashtë muaj.
- **Maryland** (SHBA) - Sipas "Ligjit të Grace", ngacmuesit kibernetikë akuzohen për kundërvajtje, dënim me burg prej një viti ose gjobë prej 500 dollarësh.
- **Karolina e Veriut** (SHBA) - Nën 14-458.1, të pandehurit që janë mbi 18 vjeç dhe përfshihen në ngacmime në internet akuzohen për kundërvajtje të klasës së parë. Nëse i pandehuri është nën moshën 18 vjeç, ai akuzohet për kundërvajtje të klasës së dytë.
- **Tennessee** (SHBA) - Sipas S.B.113, një student i përfshirë në ngacmim kibernetik dhe kërcënime në internet dënohet me kundërvajtje, deri në një vit burg. Ngacmuesi kibernetik gjithashtu përballlet me gjobë prej 2500 dollarësh.
- **Wisconsin** (SHBA) - Sipas 947.0125, nëse një student përdor kompjuterë në mënyrë të paligjshme, ata akuzohen për kundërvajtje të klasës B dhe një gjobë prej 1,000 dollarë. Ata gjithashtu mund të përballen me dënim me burg prej tre muajsh.
- Shtetet e mëposhtme kanë politika të vendosura, por nuk ka ligje konkrete për të mbrojtur viktimat e ngacmimit kibernetik: **Georgia, Kansas, Kentucky dhe Massachusetts**. Në këto shtete, i takon shkollave të vendosin një dënim të përshtatshëm.
- Në **Montana** (SHBA), nuk ka ligje për të mbrojtur viktimat e ngacmimit kibernetik, por disa shkolla kanë politika të përshkruara në manualët e tyre të studentëve.⁶⁷

Aktualisht, nuk ka ligje federale që zbatohen drejtpërdrejt për cyber-bullying, mirëpo në disa raste ngacmimi kibernetik përputhet me ngacmimin diskriminues kur ai bazohet në racën, ngjyrën, fenë, kombin, moshën ose paaftësinë.⁶⁸ Dhe në këtë drejtim, ka disa ligje që shkollat (duke përfshirë edhe kolegjet dhe universitetet) që janë të financuara nga federatat janë të

⁶⁷ Woda Steven, Cyberbullying Laws Around the Globe: Where is Legislation Strongest?, 2014, <https://resources.uknowkids.com/blog/cyberbullying-laws-around-the-globe-where-is-legislation-strongest>

⁶⁸ Federal Laws, <https://www.stopbullying.gov/resources/laws/federal>

detyruara që të zgjidhin ngacmimin kibernetik në bazë të këtyre ligjeve, që në mënyrë të ngjashme e trajtojnë ngacmimin kibernetik me bullizmin tradicional:

- **Civil Rights Act of 1963** (Ligji i të drejtave civile i vitit 1963): i cili ndalon diskriminimin në bazë të racës, ngjyrës, fesë, seksit ose origjinës kombëtare, mbron komunitetin LGBTQ dhe të gjithë ata individë që pësojnë ngacmime në forma të ndryshme.⁶⁹
- **Individuals with Disabilities Education Act** (Ligji për Arsimin e Individëve me Aftësi të Kufizuara): i cili mbron nga çdo gjë që do të parandalonte një fëmijë me aftësi të kufizuara nga marrja e një edukimi, arsimimi – duke përfshirë edhe mbrojtjen nga ngacmimin (bullizimi).⁷⁰ Ky ligj ofron shkollim publik falas për fëmijët me aftësi të kufizuar, duke i mbuluar shpenzimet e tyre që nga lindja deri në diplomimin e shkollës së mesme ose moshën 21 vjeçare.⁷¹
- **Title IX of the Education Amendments of 1972** (Titulli IX i ndryshimeve të Arsimit të 1972): ndalon diskriminimin e seksit (përfshirë shtatzëninë, orientimin seksual dhe identitetin gjinor) në çdo program arsimor ose aktivitet që merr ndihmë financiare federale.⁷²

⁶⁹ Legal Highlight: The Civil Rights Act of 1964 <https://www.dol.gov/agencies/oasam/civil-rights-center/statutes/civil-rights-act-of-1964#:~:text=The%20Civil%20Rights%20Act%20of%201964%20prohibits%20discrimination%20on%20the,hiring%2C%20promoting%2C%20and%20firing.>


⁷⁰ Individuals with Disabilities Education Act (IDEA) <https://sites.ed.gov/idea/about-idea/>

⁷¹ Andrew M.I. Lee, JD, What is the Individuals with Disabilities Education Act (IDEA)? <https://www.understood.org/en/articles/individuals-with-disabilities-education-act-idea-what-you-need-to-know>


⁷² Title IX of the Education Amendments of 1972 <https://www.justice.gov/crt/title-ix-education-amendments-1972>

Statistika dhe fakte për Cyber-bullying në SHBA

- Lloji më i zakonshëm i ngacmimeve në internet janë komentet (22.5%), sipas studentëve amerikanë. Përveç postimit të komenteve të këqija në internet (22.5%), përhapjes së thashethemeve (20.1%) dhe postimit të komenteve seksuale (12.1%), ngacmuesit kibernetikë në mesin e studentëve amerikanë zakonisht përdorin fjalë agresive dhe poshtëruese, kërcënime, hakerim të profilit dhe ndarjen e fotografive pa pëlqim.




- Adoleshentët (61%) që raportojnë se janë ngacmuar thonë se kjo ishte për shkak të pamjes së tyre. Pamja personale (61%) duket të jetë arsyeja më e zakonshme për ngacmimin kibernetik, e ndjekur nga inteligjenca (25%). Racizmi (17%) dhe diskriminimi seksual (15%) janë gjithashtu mjete të shpeshta për diskriminim, si dhe tallje me dikë për shkak të vështirësive të tij financiare (15%) dhe fesë (11%).



- Ngacmuesit shpesh synojnë viktimat me aftësi të kufizuara dhe sëmundje mendore. Është më e lehtë të ngacmoh dikë më të dobët, apo jo? Dikush që nuk mund të luftojë.

Kjo është arsyeja pse ngacmuesit shpesh ngacmojnë dikë që ka të bëjë me një sëmundje mendore ose ka një paaftësi.

- 41% e të rriturve në SHBA që përdorin internetin kanë përjetuar personalisht ngacmime në internet. Gati gjysma e të rriturve në SHBA (41%) që përdorin internetin janë marrë me ngacmimin kibernetik, me 27% që kanë raportuar ngacmime të rënda në internet, duke përfshirë kërcënime fizike (18%), ngacmime seksuale (12%), përndjekje (13%) dhe ngacmimi i vazhdueshëm (12%).




- 77% e viktimave të ngacmimeve në internet raportuan se ishin ngacmuar në Facebook. Kjo definitivisht nuk është befasi, duke pasur parasysh se Facebook është platforma dominuese e mediave sociale, duke numëruar afro 2.85 miliardë përdorues aktivë mujorë, 1.8 miliardë prej të cilëve janë përdorues amerikanë.


- Vajzat kanë më shumë gjasa se djemtë të jenë viktima dhe kryerës të ngacmimit kibernetik. Vetëm 6% e djemve raportuan se ishin ngacmuar në internet, krahasuar me 15% të vajzave, veçanërisht vajzat më të mëdha të moshës 12-17 vjeç. 41% e vajzave më të mëdha raportuan se kishin përjetuar një formë të ngacmimit në internet.




- 7 në 10 të rinj përjetojnë ngacmim kibernetik përpara se të mbushin moshën 18 vjeç. Kjo është 45% e adoleshentëve të rinj dhe të moshuar (veçanërisht vajzat dhe anëtarët e komunitetit LGBTQ) që kanë qenë viktimë të ngacmimit kibernetik. Është një përqindje alarmante që duket se vetëm po rritet.
- Rreth 37% e fëmijëve midis moshës 12 dhe 17 vjeç kanë përjetuar ngacmim kibernetik të paktën një herë. Megjithëse një numër i madh i të rinjve (60%) kishin parë bashkëmoshatarët e tyre të moshës 12-17 vjeç (37%) duke u ngacmuar, por ata nuk u munduan të përpiqeshin ta ndalonin ngacmimin. Shumica e njerëzve nuk duan të ndërhyjnë për të mos u bërë vetë viktimë.
- Më shumë se 1 në 10 studentë (12%) pranuan se kishin ngacmuar në internet dikë tjetër të paktën një herë. I njëjti studim i Universitetit Atlantik të Floridës zbuloi se 12% e të anketuarve rrëfyn se kishin ngacmuar dikë në internet në një moment të jetës së tyre. Kryerësit ishin kryesisht djem.
- Mbi 12% e të rinjve LGBT kanë përjetuar ngacmim kibernetik. Statistikat e ngacmimit kibernetik LGBT tregojnë se adoleshentët LGBT kanë më shumë gjasa të ngacmohen sesa adoleshentët heteroseksualë. Më shumë se 12% e adoleshentëve LGBT kanë raportuar se janë ngacmuar në internet, me 58% që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes dhe 35% kanë marrë kërcënime në internet.




- Më shumë të rinj kanë përjetuar ngacmime kibernetike në Instagram (42%) se në çdo platformë tjetër. Një sondazh i kohëve të fundit tregon se Facebook (37%) dhe Snapchat (31%) nuk mbeten shumë prapa Instagramit (42%), ndërsa ka më pak raste të ngacmimeve kibernetike në WhatsApp (12%), YouTube (10%) dhe Twitter. (9%).



- Ngacmimi kibernetik mund të ketë ndikime serioze në vetëvlerësimin dhe shëndetin mendor të njerëzve që e përjetojnë atë. Këto statistika alarmante të ngacmimit kibernetik tregojnë se sa i madh është ndikimi negativ i ngacmimit dhe sa e rëndësishme është të merren masa të forta për ta ndaluar përfundimisht atë. Shëndeti i përgjithshëm i njerëzve të synuar varet nga kjo. 41% e njerëzve që u ngacmuan në internet përjetuan ankth social dhe 37% e tyre përjetuan depression, ndërsa 26% kishin edhe mendime vetëvrasëse.



- Të dhëna mbi ndikimin psikologjik të grave që përjetojnë abuzim ose ngacmim në internet në mbarë botën. Sipas një sondazhi të vitit 2017 nga Statista, një numër i konsiderueshëm i viktimave femra të ngacmimit kibernetik përfundojnë duke u përballur me një sërë efektesh negative në shëndetin e tyre mendor dhe mirëqenien e përgjithshme. 66% e grave të ngacmuara në internet ndiheshin të pafuqishme në aftësinë e tyre për t'iu përgjigjur abuzimit, ndërsa 63% e tyre nuk mund të flinin mirë. Një tjetër efekt i rëndësishëm negativ për shkak të ngacmimit kibernetik është humbja e vetëbesimit, e cila është gjetur në 61% të grave.



- Frekuenca e të folurit për internetin dhe sjelljet online midis prindërve dhe fëmijëve. Sipas një sondazhi të mediave sociale nga Telenor Group, shumë prindër (46%) flasin me fëmijët e tyre shpesh për sjelljet dhe kërcënimet në internet. Megjithatë, disa prindër (39%) e bëjnë këtë vetëm ndonjëherë, ndërsa të tjerët

(12%) nuk e bëjnë kurrë.



- 4 nga 5 studentë thonë se do të kishin më shumë gjasa të ndërhyjnë në rastet e ngacmimit kibernetik nëse mund ta bënin atë në mënyrë anonime. Shumica e dëshmitarëve të ngacmimit në internet nuk ndërhyjnë kurrë, pasi nuk do të donin që autorët të ktheheshin kundër tyre. Megjithatë, nëse do të kishte një mënyrë anonime për ta bërë këtë, 81% e studentëve thonë se ndoshta do të ndihmonin viktimat.
- 68% e të anketuarve në SHBA konfirmojnë se po ndajnë më pak informacion personal në internet se më parë. Fëmijët janë gjithashtu gjithnjë e më të vetëdijshëm për rreziqet e ngacmimit në internet. Reduktimi i informacionit personal të shpërndarë në internet është padyshim një nga mënyrat për të parandaluar disa forma të ngacmimit kibernetik, siç është shantazhi. Sa më pak ngacmues të dinë për dikë, aq më pak ka gjasa që ata ta ngacmojnë atë si në internet ashtu edhe jashtë linje.
- Mbi 70% e adoleshentëve thonë se bllokimi i llogarisë së kryerësit ishte metoda më efektive për sigurinë në internet. Përpara se të flasin me prindërit e tyre ose të kërkojnë ndonjë ndihmë, shumica e adoleshentëve amerikanë bllokojnë llogaritë e mediave sociale të ngacmuesve të tyre. Ata besojnë se kjo është mënyra më e mirë për të parandaluar ngacmimin kibernetik.

73

3.2.2. Cyber-bullying në disa shtete të Evropës

Nuk ka një ligj të veçantë për ngacmimin kibernetik në Evropë, por ka një sërë ligjesh ekzistuese që mund të zbatohen në rastet e ngacmimit kibernetik. E drejta ndërkombëtare mbulon disa nga fushat problematike: Konventa për krimin kibernetik dhe legjislacioni evropian për mbrojtjen e të dhënave tani po zbatohet për çështjet e ngacmimit kibernetik, ngacmimit në internet dhe vjedhjes së identitetit.

Komisioni Evropian ka krijuar gjithashtu marrëveshje me 17 nga rrjetet kryesore sociale në botë, duke përfshirë Facebook dhe MySpace, për të ndaluar abuzimin në internet dhe për të mbrojtur më mirë të rinjtë në internet.⁷⁴

⁷³ DJURASKOVIC, Ogi, Cyberbullying Statistics, Facts, and Trends (2022) with Charts, 2022, <https://firstsiteguide.com/cyberbullying-stats/>

Disa nga dokumentet ndërkombëtare që janë miratuar nga UE-ja me një sërë dispozitash ligjore që lidhen me ngacmimin kibernetik janë:

- Neni 19 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës;
- Rezoluta për mbrojtjen e fëmijëve nga ngacmimi e vitit 2014 e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së;
- Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore e Këshillit Evropian;
- Konventa mbi krimin kibernetik dhe protokolli shtesë i saj;
- Konventa për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale;
- Konventa për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual;
- Këshilli i Evropës ka miratuar strategji të ndryshme për të drejtat e fëmijëve si: Strategjia për të drejtat e fëmijës 2016-2021; etj.⁷⁵

Për të mbrojtur fëmijët dhe adoleshentët dhe për t'i aftësuar ata që të përdorin internetin në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme, UE-ja ka miratuar një strategji "Internet më i mirë për fëmijët - Better internet for Kids" dhe bashkëfinancon Qendrat e Internetit më të Sigurt – Safer internet centres në të gjitha vendet e UE-së. Çdo qendër kombëtare operon një linjë ndihme - helplines, duke ofruar këshilla dhe ndihmë për fëmijët dhe adoleshentët që përballen me përmbajtje ose sjellje të dëmshme në internet (ngacmimi kibernetik është arsyeja kryesore për të kontaktuar linjat e ndihmës).^{76 77}

Janë miratuar programe të ndryshme arsimore brenda shkollës në Estoni, Gjermani, Greqi, Itali, Holandë, Rumani, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar. Këto programe synojnë të parandalojnë bullizmin dhe ngacmimin kibernetik duke informuar fëmijët për rreziqet e internetit, duke inkurajuar viktimat të raportojnë ngacmimin kibernetik dhe duke ndihmuar

⁷⁴ A sampling of cyberbullying laws around the world, <https://socialna-akademija.si/joiningforces/4-4-1-a-sampling-of-cyber-bullying-laws-around-the-world/>

⁷⁵ Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, Cyberbullying among young people, 2016, pg. 37,38,39,40, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU\(2016\)571367_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU(2016)571367_EN.pdf)

⁷⁶ Members of European Parliament Research Service, 2018, <https://epthinktank.eu/2018/10/28/victims-of-cyberbullying-what-europe-does-for-you/>

⁷⁷ Better Internet for Kids, <https://www.betterinternetforkids.eu/policy/insafe-inhope>

ngacmuesit për të kuptuar efektet e sjelljeve të tyre.⁷⁸

3.2.2.1. Cyber-bullying në Gjermani

Ngacmimi kibernetik nuk është i definuar me ligj në Gjermani. I njohur si "cyber-mobbing - mobingu kibernetik", ai i referohet fyerjes, turpërimit ose ngacmimit të qëllimshëm të njerëzve përmes mediave të komunikimit si rrjetet sociale, faqet e internetit ose dhomat e bisedave". Termi "cyber-mobbing" përdoret për ngacmimin kibernetik si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit.

Ngacmimi kibernetik nuk është specifikuar si një vepër penale në Gjermani. Por, mund të dënohet sipas veprave të parashikuara në Kodin Penal Gjerman si: nxitja publike për krim (neni 111); përhapja e përshkrimeve të dhunës (neni 131); fyerjet (neni 185); shpifja (neni 186); shpifje e qëllimshme (neni 187); shkelja e privatësisë së fjalës së folur (seksioni 201); shkelja e privatësisë intime duke bërë fotografi (seksioni 201a); përndjekja (seksioni 238); duke përdorur kërcënime ose forcë për të bërë që një person të bëjë, të pësojë një akt (neni 240); kërcënimi për kryerjen e një veprë penale (neni 241), hyrje e paligjshme (neni 202a), përgjim i paligjshëm (neni 202b), mashtrim kompjuterik (neni 263).⁷⁹ Seksioni 22 së bashku me seksionin 33 të ligjeve gjermane të pronësisë intelektuale për mbrojtjen e imazhit personal mund të zbatohen edhe për ngacmimin kibernetik.

Në vitin 2013, Ministri i Drejtësisë i North Rhine Westphalia bëri thirrje për futjen e një dispozite të veçantë në Kodin Penal. Megjithatë, asnjë dispozitë penale nuk u prezantua as në nivel nacional dhe as në nivel kombëtar.

Në kongresin e dytë ndërkombëtar për ngacmimin kibernetik, Ministria Federale e Drejtësisë theksoi se ngacmimi kibernetik nuk mund të luftohet vetëm përmes ligjit penal dhe se po aq të rëndësishme janë masat parandaluese, përpjekjet e shoqërisë civile për të tërhequr vëmendjen e shoqërisë ndaj problemit dhe për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për pasojat të rënda të ngacmimit kibernetik për viktimat. Ngacmimi kibernetik nuk trajtohet në

⁷⁸ Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, Cyberbullying among young people, 2016, pg. 74, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU\(2016\)571367_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU(2016)571367_EN.pdf)

⁷⁹ German Criminal Code (Strafgesetzbuch – StGB), https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/englisch_stgb.html#

mënyrë specifike nga Ligji Civil. Megjithatë, ai mbulohet nga rregulla të përgjithshme mbi përgjegjësinë civile siç parashikohet nga Kodi Civil Gjerman, në veçanti për "përgjegjësinë për dëmet" (neni 823).⁸⁰

3.2.2.2. Cyber-bullying në Holandë

Në Holandë, ngacmimi kibernetik përkufizohet si "një formë e ngacmimit tradicional" që kërkon përdorimin e mjeteve elektronike.

Ngacmimi kibernetik nuk është inkorporuar si vepër penale në Holandë, por mund të sanksionohet sipas veprave të ndryshme penale të përcaktuara nga Kode Penale siç është vjedhja virtuale (neni 310); hakimi i një llogarie (neni 138 ab); ekspozimi i pahijshëm (neni 239); shkatërrimi i të dhënave kompjuterike (neni 350a); fyerjet (neni 261); kërcënimet (neni 285) dhe përndjekja (neni 285b), qasje të paligjshme (neni 138), përgjim i paligjshëm (neni 139), mashtrimi kompjuterik (neni 326), pornografia e fëmijëve (240b). Fëmijët nën 18 vjeç nuk dënohen penalisht. Ngacmimi kibernetik nuk dënohet si rrethanë e rënduar.⁸¹

Qendra Kombëtare e Sigurisë Kibernetike (NCSC) është përgjegjëse për mbikëqyrjen e sigurisë dixhitale në Holandë. Një nga detyrat e saj kryesore është ta bëjë Holandën më rezistente ndaj krimit në internet.⁸²

Statistikat tregojnë se Holanda është një nga vendet me shkallën më të ulët të bullizmit kibernetik.

3.2.2.3. Cyber-bullying në Angli

Nuk ka asnjë përkufizim ligjor të ngacmimit kibernetik në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, ka një sërë ligjesh ekzistuese që mund të zbatohen për rastet e ngacmimeve kibernetike:

⁸⁰ Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, Cyberbullying among young people, 2016, pg. 101,103, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU\(2016\)571367_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU(2016)571367_EN.pdf)

⁸¹ Po aty, pg. 125, 127.

⁸² Fighting cybercrime in the Netherlands, <https://www.government.nl/topics/cybercrime/fighting-cybercrime-in-the-netherlands>

- Ligji për Mbrojtjen nga Ngacmimi 1997;
- Ligji për Drejtësinë Penale dhe Rendin Publik 1994;
- Ligji i Komunikimeve Dashakeqe 1988;
- Ligji i Komunikimeve 2003;
- Shkelja e paqes (Skoci);
- Ligji për shpifjen 2013, hyri në fuqi më 1 janar 2014;⁸³
- Ligji i Keqpërdorimit të Kompjuterit 1990.

Sipas Ligjit të Komunikimeve Dashakeqe, në varësi të ashpërsisë së shkeljes, ngacmimi kibernetik mund të çojë në gjashtë muaj burg dhe/ose denim me gjobë.⁸⁴

3.2.2.4. Cyber-bullying në Itali

Parlamenti italian ka miratuar një ligj të ri për mbrojtjen e të miturve nga bullizmi kibernetik. Dhoma e Deputetëve votoi miratimin e ligjit të ri me 432 vota pro dhe vetëm një abstenim.

Ligji i ri kundër ngacimit kibernetik, i cili ka marrë tre vjet për t'u miratuar vjen pas një sërë vetëvrasjesh tragjike që përfshinin të rinj, duke përfshirë vdekjen e 14-vjeçares Carolina Picchio, e cila u hodh nga dritarja prej katit të tretë pas një videoje eksplicite të filmuar nga një tjetër person në një festë, ku u postua në internet duke shkaktuar një rrëke abuzimi dhe ngacmimi nga ish i dashuri i saj dhe bashkëmoshatarët e tij. Ligji e bën të paligjshme postimin e mesazheve ofenduese ose shpifëse ndaj një të mituri në internet, shantazhimin e tyre në internet ose vjedhjen e identitetit të tyre. Viktimat e ngacimit kibernetik tani kanë të drejtë të kërkojnë që faqet e internetit që përmbajnë përmbajtje abuzive ta heqin atë brenda 48 orëve.

Legjislacioni, i cili ofron një përkufizim ligjor specifik të ngacimit kibernetik për herë të parë në Itali, kërkon gjithashtu që të gjitha shkollat të edukojnë nxënësit që të përdorin internetin me përgjegjësi dhe të kenë një staf me anëtarë përgjegjës të përkushtuar për

⁸³ The cybersmile foundation, Legal perspective, <https://www.cybersmile.org/advice-help/category/cyberbullying-and-the-law>

⁸⁴ The Law on Cyberbullying, <https://www.localsolicitors.com/criminal-guides/the-law-on-cyberbullying>

trajtimin e ngacmimit në internet dhe abuzimit në internet.⁸⁵

Ngacmimi kibernetik gjithashtu mund të dënohet sipas veprave të parashikuara në Kodin Penal Italian si: shpifja (neni 368); nxitje ose ndihmë për vetëvrasje (neni 580); shpifja (neni 595), që agravohet nëse shpifja kryhet në publik ose nëpërmjet përdorimit të mediave sociale; prodhimi, ndalimi dhe shitja e materialeve pornografike që kanë të bëjnë me fëmijët (nenet 600-bis); dhuna në sferën private (neni 610), e rënduar nëse kryhet nga më shumë persona; kërcënimi (neni 612), rëndohet nëse kryhet nga më shumë persona; përndjekja (neni 612-bis); mashtrim kompjuterik (neni 640-ter), i rënduar nëse ka ndodhur nëpërmjet vjedhjes së identitetit dixhital; ngacmimi (neni 660); etj. Ngacmimi kibernetik gjithashtu mund të përfshihet në Ligjin për krimin kibernetik dhe Ligjin për nxitjen e diskriminimit.⁸⁶

3.3. Cyber-bullying në vendet e rajonit

3.3.1. Cyber-bullying në Shqipëri

Tiranë, 21 Qershor 2019 – Dita Ndërkombëtare e ngacmimit kibernetik paraqet për Shqipërinë statistika ende shqetësuese për situatën e fëmijëve dhe të rinjve. Numri i fëmijëve dhe të rinjve që kërcënohen nga ngacmimi kibernetik, vjedhja e identitetit, ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale po rritet nga viti në vit. Ky fenomen është i ri për shoqërinë shqiptare dhe ka vetëm disa studime empirike për ngacmimin kibernetik.⁸⁷

Mungesa e dispozitave dhe rregullave ligjore në Kodin Penal e bën shumë të vështirë mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve online.⁸⁸

Në Shqipëri ngacmimi kibernetik filloi të përhapej më shumë në vitin 2020 kur botën e goditi pandemia Covid-19, e cila solli pasoja të rënda për të gjithë. Statistikat në Shqipëri tregojnë se, pikënisja ishte prej ditës kur i gjithë vendi u detyrua të hyjë në karantinë dhe u vendos që të gjitha punët, poashtu edhe shkollat të funksionojnë online. Dhe për këtë arsye,

⁸⁵ The cybersmile foundation, Italian Parliament Passes New Law To Protect Minors From Cyberbullying,

<https://www.cybersmile.org/news/italian-parliament-passes-new-law-to-protect-minors-from-cyberbullying>

⁸⁶ Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, Cyberbullying among young people, 2016, pp. 117,118, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU\(2016\)571367_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU(2016)571367_EN.pdf)

⁸⁷ The phenomenon of cyber bullying in Albanian context: An explorative study of students' perceptions, 2014, <http://www.epess.net/tr/download/article-file/333025>

⁸⁸ 60% of children and youth in Albania are victims of online bullying, <https://www.crca.al/en/news/60-children-and-youth-albania-are-victims-online-bullying>

për shkak të rritjes së numrit të përdoruesve në internet, patjetër duheshin të merreshin masa për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjëve nga internet i pasigurt.

Interneti i pasigurt nga ana tjetër krijoi përveç shumëfishimit të faqeve pornografike apo me përmbajtje ku abuzohen fëmijët, edhe problematika të tjera të rënda për fëmijët, si rritje të bullizmit online, kërcënimeve, përndjekjeve, shantazhimit, shfrytëzimin seksual të fëmijëve në distancë, si dhe vjedhjen e profileve, fotove të fëmijëve dhe keqpërdorimi i tyre.

Prandaj Shqipëria krijoi Platformën Kombëtare për Internet të Sigurtë, në faqen e internetit www.isigurt.al e cila u hap zyrtarisht më Tetor 2015. Platforma që klasifikohet si një hotline (linjë për raportuar dhe kërkuar ndihmë) është një hapësirë e dedikuar, e cila shërben si një burim unik informacioni, manualesh, udhëzuesish në lidhje me internetin e sigurt për fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe shfrytëzimi online. Qëllimi i Platformës është për të identifikuar dhe për të mbrojtur fëmijët viktimë, për të identifikuar materialet e paligjshme dhe ato me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët në internet, për të informuar prindërit dhe mësuesit, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstucional. Misioni kryesor i platformës është raportimi i faqeve me përmbajtje të paligjshme dhe të dëmshme për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri.

Rubrika RAPORTO mbron fëmijët nga abuzimi online, duke marrë, analizuar dhe referuar ankesa nga fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët apo çdo person tjetër i interesuar për të raportuar abuzimet online dhe duke i referuar të gjitha ankesat pranë agjensive përkatëse të zbatimit të ligjit dhe institucionet e tjera që ofrojnë shërbime për çështjet e abuzimit online.⁸⁹

Shqipëria është ndër vendet e para të Këshillit të Evropës që ratifikoi Konventën e Budapestit për Krimin Kibernetik në vitin 2002, e cila u ratifikua nga Kuvendi i R. së Shqipërisë dhe më vonë në vitin 2004 u ratifikua edhe protokollin shtesë i saj.⁹⁰

Shqipëria gjithashtu për të parandaluar dhe luftuar krimin kibernetik ka përfshirë në Kodin Penal disa vepra penale kibernetike në harmonizim me Konventën për Krimin Kibernetik. Disa nga këto vepra penale janë:

⁸⁹ Platforma Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, <https://www.isigurt.al/rreth-nesh/historiku>

⁹⁰ Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Ligi nr. 8888, datë 25.4.2002 për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_per_krimin_ne_fushen_e_kibernetikes_786.pdf

- Neni 84/a, Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik - *Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, që i bëhet një personi, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, për shkak përkatësie etnike, kombësie, race apo feje, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet."*
- Neni 119/a, Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik - *Ofrimi në publik ose shpërndarja e qëllimshme publikut, nëpërmjet sistemeve kompjuterike, e materialeve me përmbajtje raciste ose ksenofobie përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.*
- Neni 119/b, Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik - *Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë. Po kjo veprë, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.*
- Neni 143/b, Mashtrimi kompjuterik - *Futja, ndryshimi, fshirja ose heqja e të dhënave kompjuterike apo ndërhyrja në funksionimin e një sistemi kompjuterik, me qëllim për t'i siguruar vetes apo të tretëve, me mashtrim, një përfitim ekonomik të padrejtë apo për t'i shkaktuar një të treti pakësimin e pasurisë, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet. Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim, në dëm të disa personave, më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*
- Neni 186/a, Falsifikimi kompjuterik - *Futja, ndryshimi, fshirja apo heqja e të dhënave kompjuterike, pa të drejtë, për krijimin e të dhënave të rreme, me qëllim paraqitjen dhe përdorimin e tyre si autentike, pavarësisht nëse të dhënat e krijuara janë drejtpërdrejt të lexueshme apo të kuptueshme, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet. Kur kjo veprë kryhet nga personi, që ka për detyrë ruajtjen dhe administrimin e të dhënave kompjuterike, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda për interesin publik, dënohet me burgim tre deri në dhjetë vjet."*
- Neni 192/b, Hyrja e paautorizuar kompjuterike - *Hyrja e paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cenimit*

të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kur kjo veprë kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet."⁹¹

- Neni 121/a, Përndjekja - Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t'i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo veprë kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo veprë kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t'u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë.⁹²

Në përgjithësi, Shqipëria ka përmbushur detyrimin e saj ndërkombëtar për të përafuar disi legjislacionin e saj për mbrojtjen e fëmijëve në internet me traktatet dhe konventat ndërkombëtare në të cilat ka aderuar. P.sh. Shqipëria ka përafuar legjislacionin e saj me ligjin nr. 8624 "Për Ratifikimin e Konventës së Hagës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Bashkëpunimin për Birësimet jashtë vendit". Shqipëria ka ratifikuar gjithashtu Konventën Fakultative të OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve. Ajo gjithashtu ka nënshkruar (në 2008) dhe ratifikoi (në 2009) Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual. Në nivel kombëtar, Kushtetuta shqiptare i kushton shumë rëndësi mbrojtjes së të miturve duke kërkuar që "fëmijët të kenë të drejtën e mbrojtjes së veçantë nga shteti".⁹³

⁹¹ Legjislacioni për krimin kibernetik, pjesë nga Kodi Penal, Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/LEGJISLACIONIMBIKRIMINKIBERNETIK.pdf>

⁹² Kodi penal i Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf

⁹³ A Study on Child Online Safety in Albania, pg. 41,42, <https://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf>

Organet kompetente për të trajtuar krimin kibernetik dhe të gjitha veprat penale që lidhen me këtë krim (përfshirë edhe ngacmimin kibernetik) janë: Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH), Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inteligjencës së mbrojtjes dhe sigurisë (AISM) etj.⁹⁴

3.3.2. Cyber-bullying në Kosovë

Përderisa kjo dukuri ka zënë vend në botën digjitale, automatikisht kuptohet që edhe në Kosovë dukuri të tilla janë të pranishme, pasi që kjo dukuri përcillet në të gjitha vendet ku kanë qasje në internet. Në shkollat në Kosovë fëmijët ngacmojnë njëri tjetrin, madje edhe përmes rrjeteve sociale. Kështu që duhet t'i kushtojnë rendësi të veçantë fëmijëve, dhe se çfarë shikojnë në internet.⁹⁵

Në Kosovë të pyetur për problemet të cilat i hasin gjatë përdorimit të internetit, nxënësit janë deklaruar se shqetësim për ta paraqesin fyerjet dhe etiketimet me ndonjë emër të papëlqyeshëm, postimi i përmbajtjeve të pakëndshme, vjedhja e fjalëkalimeve si dhe keqpërdorimi i të dhënave personale. Drejtorët e shkollave tregojnë se ka rritje të numrit të ankesave për këtë formë ngacmimi dhe tregojnë vështirësitë e shkollës në kontrollimin dhe zgjidhjen e këtij problem, pasi përveç që ka mungesë ligjore, nuk ka as kuadër të specializuar që duhet t'i trajtojnë këto çështje në shkolla.

Në vitin 2013 në mediat kosovare kishte bërë bujë lajmi për një video që ishte përhapur me të madhe në rrjetet sociale e që protagoniste i kishte dy të mitura. Videoja shfaqte një nxënëse që godiste dhe shante një nxënëse tjetër. Përleshjes fizike i kishte paraprirë një fjalosje e mëhershme në objektin shkollor. Si hakmarrje, nxënësjka që kishte filluar përleshjen e kishte

⁹⁴ SHKËMBI Aldo, Krimi Kibernetik Harmonizimi i Legjislacionit shqiptar me atë europian, Tiranë, 2015, https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Aldo_Shkemb.pdf

⁹⁵ PALUSHI, Arbricë, Ngacmimet kibernetike. Ndikimi i tyre te fëmijët dhe adoleshentët 2018, <https://telegrafi.com/ngacmimet-kibernetike-ndikimi-tyre-tek-femijet-dhe-adoleshentet/>

porositur dikë ta incizojë teksa e godet dhe shan moshataren. Videoja u publikua së pari në rrjetin social Facebook e më pas u shpërnda me të madhe edhe në rrjetet e tjera sociale. Ajo po ashtu u shpërnda në disa media të cilat madje e bënë të ditur identitetin e vajzave. Pas reagimeve dhe debateve të shumta që pasuan në media, videoja u largua nga çdo platformë interneti, por historia e saj nuk ka përfunduar ende. Edhe sot ekzistojnë fotografi dhe faqe në rrjete sociale të cilat ishin krijuar për ta denigruar nxënësen që kishte filluar përlëshjen.⁹⁶

Republika e Kosovës ka ndërmarrë hapa konkret në krijimin e infrastrukturës ligjore për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të krimit kibernetik, por ende mbesin shumë sfida, sidomos në kuptimin teknik të përballjes së suksesshme me këtë formë të krimit, që në Kosovë është fenomen relativisht i ri.⁹⁷

Në Kosovë nuk ka ligj të veçantë për cyber-bullying, as nuk është inkorporuar si vepër e veçantë në Kodin Penal, mirëpo Kosova ka sjellur *Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike*, dhe në kuadër të këtij ligji mund të trajtohen rastet e ngacmimeve në internet dhe disa nga veprat penale të cilat ndërlidhen me krimet kibernetike rregullohen me Kodin Penal të Kosovës.

Ligjin Nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetikë e ka aprovuar Kuvendi i Republikës së Kosovës më 10 Qershor 2010. Ky ligj ka për qëllim parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë me masa konkrete, parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike, duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky ligj është i bazuar në Konventën e Budapestit, si i tillë është paraqitur nevoja të plotësohet, pasi që teknologjia informacionit ka evoluar shumë brenda këtyre viteve dhe shumica e veprave të reja penale nuk kanë qenë të parapara në atë kohë kur është hartuar. Për arsye të evoluimit të lloj-llojshmërisë së krimeve kibernetike, në BE me datën 12 Gusht 2013 (tri vite pasi që ligji i sipër përmendur ka hyrë në fuqi ligji) është aprovuar: “Direktiva e BE-së

⁹⁶ KRASNIQI, Meritë, I paraportuar dhe i injoruar, bullizmi përndjek nxënësit e Kosovës, 2019, <https://kosovotwopointzero.com/i-paraportuar-dhe-i-injoruar-bullizmi-perndjek-nxenesit-e-kosoves/>

⁹⁷ Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – socta, 2014-2015, Prishtinë, 2016, fq. 49,50, https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2019/10/VLER%C3%8BSIMI_I_K%C3%8BRC%C3%8BNIMIT_NGA_KRIMET_E_R%C3%8BNDNA_DHE_KRIMI_I_ORGANIZUAR_%E2%80%93_SOCTA_2014-2015.pdf

2013/40 për mbrojtjen e sistemeve të informacionit”. Po ashtu në vitin 2012 Komiteti i Konventës së Budapestit për Krimet Kibernetike aprovon “Shënimet Udhëzuese” që përshkruajnë në mënyrë më të qartë format kryesore të krimit kibernetikë dhe njëkohësisht në kuadër të konventës është nxjerrë protokollin shtesë i Konventës për Krimet Kibernetike që trajton penalizimin e veprimeve raciste dhe ksenofobike të kryera përmes sistemeve kompjuterike.⁹⁸

Veprat penale sipas Kodit Penal të Kosovës: Ngacmimi (Neni 182), Ngacmimi seksual (183), Cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe i bazave të të dhënave kompjuterike (Neni 199), Përgjimi i paautorizuar (Neni 201), Fotografimi dhe incizimet tjera të paautorizuara (Neni 202), Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi (Neni 232), Hyrja në sistemet kompjuterike (Neni 327), Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes (Neni 336).⁹⁹

Veprat penale sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimeve Kibernetike: Kanosja me motive racizimi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik (Neni 16), Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobike nëpërmjet sistemit kompjuterik (Neni 17), Hyrja e paautorizuar kompjuterike (Neni 18), Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike (Neni 19), Mashtrimi kompjuterik (Neni 23).¹⁰⁰

Problemi kryesor i ligjit aktual është se nuk ka gjetur zbatim andaj është sugjeruar të bëhet draftimi i ligjit, duke i ndryshuar disa vepra penale që vetëm se janë paraparë në ligj dhe duke i inkorporuar edhe disa vepra penale, si:

- Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi përmes sistemeve kompjuterike, të bëhet harmonizimi më i përshtatshëm;
- Shtytja e fëmijës për të kryer marrëdhënie seksuale, përmes mjeteve elektronike;
- Komunikimi me fëmijën për qëllime seksuale (sexting), nuk është e rregulluar, vlerësohet se duhet të përfshihet si vepër penale;

⁹⁸ Epoka e re, Gashi: Ligji për siguri kibernetike do të parandalojë krimin kibernetik,

<https://www.epokaere.com/gashi-ligji-per-siguri-kibernetike-do-te-parandaloje-krimin-kibernetik/>

⁹⁹ KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë,

https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/07/KODI_NR.06_L-074_KODI_PENAL_I_REPUBLIKE%CC%88S_SE%CC%88_KOSOVE%CC%88S.pdf

¹⁰⁰ Projektligji për sigurinë kibernetike, https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/09-07-34-21072020/Projektligji-per-Sigurine-Kibernetike_tre-gjuhet.doc

- Vjedhja e të dhënave personale, nuk është e rregulluar, vlerësohet se duhet të përfshihet si vepër penale;
- Urrejtja dhe diskriminimi në internet, në mënyrë të përgjithësuar nxitja e urrejtjes është e rregulluar me nenin 147 në Kodin Penal por nuk është e rregulluar “përmes internetit”, vlerësohet se duhet të përfshihet si vepër penale; dhe ndryshime tjera që janë rekomanduar nga organet kompetente shtetërore.¹⁰¹

Në Kosovë ka dy qendra, Qendra për Arsim në Kosovë (KEC) dhe Qendra për studime të avancuara (FIT) të cilët kanë publikuar një udhëzues për fëmijë, të cilin e kanë përpiluar në bashkëpunim me ekspert të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtarë. Nëpërmjet këtij udhëzuesi ofrohen këshilla dhe udhëzime lidhur me përdorimin e sigurt të internetit për fëmijët. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti është që t’iu ofrojmë fëmijëve informata për rreziqet që mund të paraqiten gjatë përdorimit të internetit dhe të kontribuoj në rriten e vetëdijesimit për sigurinë në internet.¹⁰²

Në Kosovë është themeluar edhe Njësia e forenzikës IT në Drejtorinë e Hetimeve Forenzike të Policisë së Kosovës e cila është e re. Roli kryesor i njesisë është ruajtja, identifikimi, vlerësimi, grumbullimi, shqyrtimi, analizimi dhe paraqitja e provave digjitale në gjykatë. Hetuesit forenzikë nuk i ndjekin fizikisht kriminelët. Forenzika e IT-së është pjesë e rëndësishme e procesit hetimor. Ekspertët e forenzikës kompjuterike i ndjekin kriminelët në fushën digjitale apo në “tregun kibernetik”.¹⁰³

Qeveria e Republikës së Kosovës ka përfshirë në Programin e Qeverisë 2015-2018 hartimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Kibernetike si dhe Planin e Veprimit. Ministria e Punëve të Brendshme është ngarkuar me detyrën që të nxjerr këto dokumente dhe të implementoj ato. Për hartimin e strategjisë janë përfshirë një numër i konsiderueshëm i institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare. Me këtë strategji parashihet të merren masa

¹⁰¹ Koncept dokument për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, 2017, <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/11-49-51-22122017/1.%20Draft-Koncept%20dokument%20p%C3%ABr%20parandalimin%20dhe%20luftimin%20e%20krimit%20kibernetik....doc>

¹⁰² ZYMERI, Teuta, MUSMURATI, Besianë, Siguria e fëmijëve në internet, Udhëzues për fëmijë, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/11/siguria-e-femijeve-ne-internet.pdf>

¹⁰³ EULEX, Forenzika përmes teknologjisë informative – Zbulimi i krimeve në autostradën digjitale të shekullit XXI, 2017, <https://eulex-kosovo.eu/?page=1,26,670>

konkrete për krijimin e një hapësire kibernetike të sigurt. Strategjia Kombëtare për Siguri Kibernetike dhe Plani i Veprimit janë në punim e sipër. Vlerësojmë se me nxjerrjen e këtij dokumenti dhe fillimin e zbatimit të tij niveli i sigurisë kibernetike apo mbrojtja nga sulmet kibernetike do të rritet shumë.

Vizioni i Republikës së Kosovës është të sigurojë një mjedis të sigurt të hapësirës kibernetike, duke minimizuar dhe parandaluar kërcënimet kibernetike në bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në fushën e sigurisë kibernetike, Republika e Kosovës ka në zbatim një bazë të gjerë ligjore, e cila përfshin:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Ligji nr.03/L –166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik;¹⁰⁴
- Ligji nr.03/L – 172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji nr. 04/L-065 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
- Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës;
- Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale;
- Kodi nr.03/L-193 i Drejtësisë për të Mitur;
- Ligji nr. 04/L-145 për Organet Qeveritare të Shoqërisë së Informacionit; etj.¹⁰⁵

Organet kompetente për të trajtuar krimin kibernetik dhe të gjitha veprat penale që lidhen me këtë krim (përfshirë edhe ngacmimin kibernetik) janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokuroritë dhe Gjykatat, Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Ministria për Forcën e

¹⁰⁴LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT KIBERNETIKË, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti V / nr. 74 / 20 Korrik 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2682>

¹⁰⁵ Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2016 – 2019, fq. 6, 17, 18, dhjetor 2015, https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Shteterore_per_Sigurine_Kibernetike_dhe_Plani_i_Veprimit_2016-2019_per_publicim_1202.pdf

Sigurisë së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

3.3.3. Cyber-bullying në Sërbi

Në Sërbi në rrjetin social telegram u krijua një grup "Ex YU balkanska soba" ("Ex YU ballkan room"), pas rastit të ngjajshëm "Dhoma publike" që u ballafaqua RMV, në të cilin kanë marrë pjesë më shumë se 36,000 burra nga Ballkani të cilë kanë shpërndarë fotografi eksplicite, private të ish femrave të tyre dhe vajzave e grave nga rajoni. Pjesa më e madhe e përmbajtjes së këtij grupi është "pornografi hakmarrëse".

Menjëherë pasi grupi u ekspozua në internet, emri i tij u ndryshua dhe e gjithë përmbajtja e tij u fshi. Biseda në grup dhe anëtarët e saj mbeten nën hetim. Ka qenë efikasiteti i rrjeteve sociale që ka mundësuar ekspozimin e këtij aktiviteti kriminal. Faqja në Instagram, "Kritički" ("Kritike"), ishte ndër të parat që paralajmëroi rastin që ishte duke ndodhur në Telegram me një postim dhe pronarja e faqes ndau emailin që ajo vetë i kishte shkruar ministrive të ndryshme të brendshme në rajonin e Ballkanit.

Organizatrat e grave në Sërbi paralajmërojnë se pornografia hakmarrëse është dhunë dixhitale dhe se viktimat janë kryesisht gra dhe vajza. Por zinxhiri nuk shkon vetëm nga viktimat te autori, këtu hyjnë edhe të gjithë personat që shpërndajnë, komentojnë dhe vazhdojnë të shpërndajnë fotot e publikuara dhe regjistrimet për të cilat nuk kanë leje t'i publikojnë.¹⁰⁶

Kjo nuk është e vetmja bisedë e njohur grupore e krijuar për të përhapur pornografi hakmarrëse, e zbuluar përmes mediave sociale serbe. Deri më tani, policia ka arrestuar dy burra, duke përfshirë përdoruesin e Telegramit Nemanja Stojiljković (25 vjeç) nga Nishi, administrator i grupit "Nishlijki" i dyshuar për krijimin dhe administrimin e një bisede në grup në Telegram të quajtur "Nišlijke". Biseda në grup priti rreth 24 000 anëtarë (burra) dhe u krijua për të ndarë foto dhe video eksplicite të grave dhe vajzave. Numrat e telefonit dhe adresat e disa grave dhe vajzave u ndanë gjithashtu midis anëtarëve të bisedës në grup.

Stojiljkovic akuzohet për shfaqje, marrjen dhe posedimin e materialeve pornografike

¹⁰⁶ DAMCESKA Marina, Telegram "Balkan Room" Revealed - Over 36.000 men from the region share explicit photos of women, <https://www.slobodenpecat.mk/en/otkriena-balkanska-soba-na-telegram-nad-36-000-mazhi-od-regionot-spodeluvale-eksplicitni-fotografii-od-zheni/#:~:text=While%20the%20Public%20Prosecutor's%20Office,36.000%20men%20from%20the%20Balkans>

dhe shfrytëzimin e të miturve për pornografi, tha Ministria e Brendshme e Serbisë. Për këtë veper, në varësi të mënyrës së ekzekutimit dhe pasojave, dënimi i mundshëm varion nga gjobë dhe gjashtë muaj burg deri në tetë vjet burg.¹⁰⁷

Pas seancës, prokuroria i paraqiti një propozim gjyqtarit të procedurës paraprake për Gjykatën e Lartë në Beograd që t'i ndalohej Stojiljkoviçit të afrohet, të takohet ose të komunikojë me disa persona të caktuar, si dhe të vizitojë vende të caktuara që kanë të bëjnë me krimin që ai akuzohet.

Stojiljković u tha gazetarëve, se ai e krijoi këtë grup 'për argëtim' dhe, pavarësisht arrestimit të tij, këmbëngul se nuk e konsideron veten si një palë fajtore pasi pretendon se nuk ka postuar personalisht ndonjë përmbajtje.

Personi i dytë që u arrestua është identifikuar si 'M.C.' (27 vjeç) dhe dyshohet se ka publikuar përmbajtje eksplicite si dhe adresën e një ish të dashure në grupin Telegram. Mësohet se ai ka kërkuar të rikontaktojë me ish të dashurin e tij. Kur ajo refuzoi, ai kërcënoi se do të publikonte foto intime që ajo i kishte dërguar më parë në moshë të mitur.¹⁰⁸

Këto grupe nuk mund të gjenden më në Telegram, por në rrjetet sociale ka ende regjistrime dhe pamje nga ekrani (screenshots) që qarkullojnë.

Rrjeti i komunikimit Telegram është bllokuar nga disa vende si Azerbajxhani, Bahreini, Bjellorusia, Gjermania, Brazili, Kina, Kuba, Hong Kong, India, Indonezia, Irani, Pakistani, Rusia dhe Tajlanda.¹⁰⁹

Në Sërbi lufta kundër ngacmimit kibernetik është ende në fillimet e saj. Sërbia nuk ka miratuar një legjislacion specifik që synon ngacmimin kibernetik. Por, ngacmimi kibernetik mund të dënohet sipas disa veprave të parashikuara në Kodin Penal të Serbisë si:

Neni 144, Fotografim i paautorizuar – (1) *Kushdo që bën një fotografi, film, video ose regjistrim tjetër të paautorizuar të një personi dhe në këtë mënyrë ndërhyr ndjeshëm në jetën e*

¹⁰⁷ DONEV Mihailo, Telegram "Balkan Room" administrator found, threatened with 8 years in prison, <https://www.slobodenpecat.mk/en/pronajden-administratorot-na-balkanska-soba-na-telegram-mu-se-zakanuvaat-8-godini-zatvor/>

¹⁰⁸ MILETIĆ Miljana, The scroll, Telegram revenge porn scandal: police investigate as more than 50 000 men share explicit content of women and underaged girls, 2021, <https://the-scroll.co.uk/2021/03/17/telegram-revenge-porn-scandal-police-investigate-as-more-than-50-000-men-share-explicit-content-of-women-and-underaged-girls/>

¹⁰⁹ Government censorship of Telegram Messenger, https://en.wikipedia.org/wiki/Government_censorship_of_Telegram_Messenger

tij personale, ose kushdo që ia dorëzon ose tregon një regjistrim të tillë një personi të tretë ose në ndonjë mënyrë tjetër i mundëson njohjen me të, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit. (2) Nëse veprën nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, dënohet me burgim deri në tre vjet.

Neni 145, Publikimi dhe shfaqja e paautorizuar e shkrimeve, portreteve dhe regjistrimeve të të tjerëve - *(1) Kushdo që publikon ose shfaq një dosje, portret, fotografi, film ose fonogram të një karakteri personal pa pëlqimin e personit që ka bërë dosjen ose të cilit i referohet dosja, ose pa pëlqimin e personit të paraqitur në portret, fotografia ose filmi ose zëri i të cilit është regjistruar në fonogram ose pa pëlqimin e një personi tjetër, pëlqimi i të cilit kërkohet me ligj dhe në këtë mënyrë ndërhyt ndjeshëm në jetën personale të atij personi, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet. vjet. (2) Nëse veprën nga paragrafi 1 i këtij neni e kryen personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, dënohet me burgim deri në tre vjet.*¹¹⁰

Neni 146, Mbledhja e paautorizuar e të dhënave personale - *(1) Kushdo që pa autorizim merr, komunikon dhe përdor të dhënat personale në bazë të ligjit pa autorizim ose i përdor ato për qëllim për të cilin nuk janë të destinuara, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. (2) Dënimi nga paragrafi (1) i këtij neni do t'i shqiptohet edhe atij që në kundërshtim me ligjin mbledh të dhënat personale të qytetarëve ose i shfrytëzon të dhënat e grumbulluara. (3) Nëse veprën nga paragrafi (1) i këtij neni e kryen personi zyrtar gjatë kryerjes së shërbimit. dënohet me burgim deri në tre vjet.*¹¹¹

¹¹⁰ STEVANOVIC Ana, RISTESKI Oliver, WEASA, Cyber bullying, stalking, online harassment in North Macedonia and Serbia, 2022, <https://www.weasa.org/wp-content/uploads/2022/02/Research-on-Cyberbullying-in-North-Macedonia-and-Serbia.pdf>

¹¹¹ KRIVIČNI ZAKONIK REPUBLIKE SRBIJE, <https://www.paragraf.rs/propisi/krivicni-zakonik-2019.html>

KAPITULLI IV

CYBER-BULLYING NË RMV

4.1. Vështrime të përgjithshme rreth Cyber-bullying në RMV

Në RMV çështja e cyber-bullying ka qenë thajse e panjohur për qytetarët, ata kanë pësuar pa e ditur që kjo përbën shkelje dhe mund konsiderohet si vepër kundërligjore. Mirëpo, rritja e vëmendjes dhe ndërgjegjësimit filloi pas paraqitjes së rastit “Dhoma publike”, që konsiderohet edhe rasti i parë në RMV që bëri bujë të madhe dhe u morën veprime ligjore për dënimin e kryerësve.

Në rrjetin e komunikimit “Telegram”, u formua grupi “Dhoma publike”, në të cilin ka pas 7,400 anëtarë burra të rritur dhe të rinj, ku janë publikuar rreth 800 foto dhe video pornografike dhe erotike të vajzave, përfshirë vajza të mitura, poashtu edhe gra të cilat janë fytyra publike, të cilat pra janë përndjekur, shantazhuar dhe u janë publikuar të dhëna personale dhe fotografi intime. 7,400 njerëz jo vetëm që kanë ndarë, jo vetëm që kanë kërkuar foto dhe informacione të vajzave dhe grave (me emër dhe mbiemrin dhe vendndodhjen, si listë dëshirash) por edhe kur e kanë parë atë që po ndodhë nuk e kanë paralajmëruar askënd dhe nuk e kanë raportuar fare grupin, i cili ndër tjerash është parajsë për pedofilët.

Faji padyshim qëndron te abuzuesit, gjegjësisht te ata 7,400 njerëz që me vetëdije i kanë abuzuar dhe dëmtuar vajzat dhe iu kanë shkaktuar trauma për tërë jetën, poashtu faji qëndron edhe në sistemin që nuk mbron viktimat e këtij lloji të dhunës.

“Dhoma Publike” është një koleksion i grabitqarëve seksualë që trupat e femrave i shikojnë si objekte pa të drejtë të privatësisë, si gjësende që janë në dispozicion, të cilët nuk kanë kurrfarë fuqie, autoritet, të drejtë të privatësisë as për seksualitetin e tyre.¹¹²

Muaj të tërë pas bërjes publike të shqetësimit të parë mbi rastin “Dhoma Publike” autoritetet besonin se nuk kanë bazë për të gjykuar personat që shkëmbejnë këto materiale në grup. Kjo edhe për shkak se “Telegram” kishte refuzuar të bashkëpunojë me autoritetet

¹¹² Portalb.mk, “Dhoma Publike” është një koleksion i grabitqarëve seksualë që trupat femra i shikojnë si objekte pa të drejtë të privatësisë, 2020, <https://portalb.mk/662843-dhoma-publike-eshte-nje-koleksion-i-grabitqareve-seksuale-ge-trupat-femra-i-shikojne-si-objekte-pa-te-drejte-te-privatesise/>

vendase për identitetin e personave që ishin pjesë e grupit dhe që kishin shpërndarë përmbajtjet e këtilla.¹¹³

Në këtë drejtim, Ministria e Drejtësisë ka bërë propozim të bëhen ndryshime në Kodin Penal të RMV-së. Në propozim ndryshimet, ka përfshirë veprën e re penale “**Përndjekje**”, e cila synon të rregullojë me ligj sanksionet për personat të cilët rrezikojnë sigurinë dhe privatësinë e tjetrit, fizikisht ose në internet. Dënimet për këtë veprë, parashikohet të jenë deri në 5 vite burg. Këtu përfshihen ndjekja, shqetësimi, frikësimi, abuzimi psikik i personit tjetër, përfshirë këtu edhe hapësirën virtuale, gjëra të cilat deri tani nuk kanë paraqitur veprë penale.

Ministria e Drejtësisë: *“Në nenin 144-a të Kodit Penal thuhet se “Ai që me këmbëngulje, pa autorizim të ndjekë, përndjekë apo në ndonjë mënyrë tjetër ndërhyt në jetën personale të një tjetri, vendos apo këmbëngul të vendosë kontakt të padëshiruar me lëvizje në hapësirën ku ndodhet ai person, me keqpërdorim të shfrytëzimit të të dhënave personale, me përdorim të mjeteve për informim publik apo mjeteve të tjera të komunikimit, apo në mënyrë tjetër abuzon psikikisht, shqetëson apo frikëson dhe me atë do të shkaktojë ndjenjë të pasigurisë, shqetësimit apo frikësim për sigurinë e tij apo sigurinë e ndonjë personi të afërt të tij, do të dënohet me dënim me të holla, apo me burg deri në tre vite”*

Për shkak që u vërtetua se pjesa më e madhe e këtyre fotografive dhe të dhënave të viktimave në “Dhomën publike” shpërndaheshin nga persona me të cilët më herët viktimat kishin pasur lidhje intime, nga Ministria e Drejtësisë u shtua edhe propozim ndryshimi: *“Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet kundër një personi me të cilin kryesi është ose ishte në një marrëdhënie intime ose ndaj një fëmije, do të dënohet me burg prej gjashtë muaj deri në pesë vjet”.*

Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave ka propozim konkret, për të definuar “ngacmimin seksual” me ligj. “Propozojmë që definimi i ngacmimit seksual të jetë siç është në Konventën e Stambollit edhe atë: **“Ngacmimi seksual – çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale apo fizike mbi baza seksuale, me qëllim apo pasojë lëndim i dinjitetit të personit, posaçërisht kur krijon ambient frikësimi, të pakëndshëm, degradues, përçmues apo**

¹¹³ BEHADINI, Rita, Shpërndarje e pornografisë së fëmijëve: Dy krijuesit e "Dhomës Publike" u dënuan me nga katër vite burg, 2022, <https://www.mollekuqja.mk/posts/shperndarje-e-pornografise-se-femijeve-dy-krijuesit-e-dhomes-publike-u-denuan-me-nga-kater-vite-burg>

lënduese, është lëndë për sanksion penal”, tha Elena Dimushevksa.¹¹⁴

Kuvendi nuk ka miratuar ende propozim/ndryshimet ligjore në Kodin penal të cilat do të kontribuonin për rritjen e sigurisë së grave dhe vajzave, edhe pse të njëjtat janë dorëzuar që nga muaji shtator i vitit të kaluar.

Pas paraqitjes së rastit “Dhoma publike” deri te MPB-ja u paraqitën 20 kallëzime penale.

Prokuroria Themelore Publike nisi hetim për rastin në fjalë. Ndaj dy krijuesve të grupit të moshës 32 dhe 21 vjeç u ngrit aktakuzë. Ata ngarkohen me akuzën për prodhim dhe shpërndarje të pornografisë për fëmijë, pasi gjatë hetimeve paraprake u siguruan prova materiale që tregojnë për këtë kualifikim ligjor.

Në aktakuzë thuhej se në periudhën nga 19 dhjetori i vitit 2019 deri më 28 janar të vitit 2020, krijuesit e grupit kanë qenë të obliguar të kujdesen për përmbajtjen e tekstit dhe përmbajtjet audio - vizuale që shpërndahen nga anëtarët e grupit. Të dy të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë. Sipas gjykatës, ata me paramendim kanë lejuar që në grup të viheshin në dispozicion përmbajtje ku tregohen akte seksuale me fëmijë.¹¹⁵ Hetimet e Prokurorisë Themelore Publike kanë zgjatur fiks një vit.¹¹⁶

Gjykata penale në Shkup dënoi nga katër vite burg krijuesin e grupit Darko Kostovski dhe administratorin Mihail Panelvski, për veprën penale prodhim dhe distribuim i pornografisë fëmijërore, sipas Kodit Penal të RMV-së, e cila veprë dënohet me nenin 193-a:

“(1) Ai i cili prodhon pornografi fëmijërore me qëllim të distribuimit të saj, apo e mbartë, apo e ofron apo në mënyrë tjetër e bën të arritshme pornografinë fëmijërore, do të dënohet më së paku pesë vjet burgim.

(2) Ai i cili furnizon pornografi fëmijërore për vete apo për tjetër kë, apo posedon pornografi fëmijërore, do të dënohet me dënim me burgim prej pesë deri në tetë vjet.

(3) Nëse vepra nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni është kryer përmes sistemit kompjuterik apo ndonjë mjeti tjetër për komunikim masiv, kryerësi do të dënohet me së paku tetë vjet

¹¹⁴ BUÇI, Teuta, "Përndjekja" si vepër penale, ngacmimet ndaj vajzave duhet të presin disponimin politik për t'u sanksionuar, 2021, <https://www.mollekuqja.mk/posts/perndjekja-si-veper-penale-ne-pritje-te-vullnetit-politik>

¹¹⁵ BUÇI, Teuta, "Përndjekja", aktorëve politik nuk u “ngutet” të miratojnë propozim-ndryshimet në Kodin Penal, 2022, <https://www.mollekuqja.mk/posts/perndjekja-aktoreve-politik-nuk-u-ngutet-te-miratojne-propozim-ndryshimet-ne-kodin-penal>

¹¹⁶ Telma TV, Javna soba, 2021, https://www.youtube.com/watch?v=mjzye_ney-M

*burgim.”.*¹¹⁷

Në qoftë se Kuvendi do të kishte miratuar më herët propozim ndryshimet e Kodit Penal, do të mund të kishte ndikim që të akuzuarit të merrnin dënime më të ashpra.

Pasi grupi i parë në rrjetin Telegram u mbyll, u formua një grup tjetër me të njëjtin emër, në të cilin shpërndareshin përsëri të dhëna personale të vajzave me emër mbiemër, fotografitë e tyre eksplicite, adresa si dhe numri i telefonit. Grupi për një ditë ka mbledhur 219 anëtarë, dhe deri më tani janë shpërndarë 61 foto dhe 14 video.¹¹⁸

Ministria e Punëve të Brendshme u ka bërë thirrje viktimave që të denoncojnë rastin.

Qeveria e RMV-së ka thënë se nëse aplikacioni “Telegram” nuk e mbyll grupin “Dhoma Publike”, ne do të shqyrtojmë mundësinë e bllokimit ose kufizimit të përdorimit të këtij aplikacioni në Maqedoninë e Veriut, derisa ata të fillojnë të bashkëpunojnë me ne”.¹¹⁹

Procedura hetimore për “Dhoma publike 2” është ende duke vazhduar, ku Prokuroria Themelore në Shkup, Prilep, Kavadar, Manastir, Veles, kanë ndërmarrë veprime hetimore kundër disa personave për të cilët ka dyshim të bazuar, të cilëve u është marrë telefoni celular, CD, për t’u mbledhur prova të mjaftueshme materiale dhe për të vërtetuar faktet, ku pas arritjes së raportit të ekspertizës do të vendoset për vazhdimin e rrjedhës së procedurës.¹²⁰

E drejta e privatësisë është e garantuar me aktin më të lartë juridik Kushtetutën e RMV-së, andaj ky rast duhet të hetohet siç duhet nga institucionet kompetente dhe shkelësit e veprave penale të ndiqen dhe të ndëshkohen në përputhje me ligjin. Sepse nëse nuk mbahet përgjegjësi, cyber-bullying vetëm se do të vazhdojë të përhapet dhe të kryhen edhe vepra tjera penale.

Në Shkup, u zhvillua edhe protestë, të cilën e organizoi Platforma për Barazi Gjinore, ku qindra protestues i dolën në mbështetje viktimave të grupit “Dhoma Publike”. Marshi protestues filloi para Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe përfundoi para objektit të

¹¹⁷ Kodi Penal i RMV-së, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

¹¹⁸ SKANDAL/“Dhoma publike” aktivizohet sërish, hapet për herë të tretë grupi në Telegram, 2021, <https://alportal24.com/skandal-dhoma-publike-aktivizohet-serish-hapet-per-here-te-trete-grupi-ne-telegram/>

¹¹⁹ Dhoma publike, nëse telegram nuk fshin grupin do të kufizohet aplikacioni, 2021, <https://www.youtube.com/watch?v=4NP5RulI78I>

¹²⁰ Portalb.mk, Prokuroria Publike: Hetimi për “Dhoma publike 2” është në fazën përfundimtare, po zhvillohen procedura hetimore në disa prokurori, 2021, <https://portalb.mk/733860-prokuroria-publike-hetimi-per-dhoma-publike-2-eshte-ne-fazen-perfundimtare-po-zhvillohen-procedura-hetimore-ne-disa-prokurori/>

Prokurorisë Themelore Publike. Gjatë gjithë ecjes aktivistët dhe protestuesit jepnin mesazhe për rëndësinë e zbardhjes së këtij rasti deri në fund. “Ti nuk je fajtores”, “Ti je viktimë”, “Nuk është faji yt”, ishin vetëm disa nga parullat të cilat u dëgjuan në marshin protestues. Protestuesve me fjalim ju drejtua avokatja Marta Gusar, e cila për herë të parë pranoi se ka qenë një ndër viktimat e grupit kriminal “Dhoma Publike” ajo theksoi se menjëherë ka denoncuar rastin në institucionet kompetente dhe këtë ua sugjeroi të gjitha viktimave tjera të mundshme. “Numri im ishte shpërndarë për “takime diskrete”, ashtu më shkruanin, për “takime”. Nga kur ishte shpërndarë numri im në atë grup, normalisht, dy orët e para nuk munda të marr veten dhe të besoj që kjo mua më ndodh, ndërsa mund të i ndodhë secilit. Denoncova menjëherë, bëra screenshot numrave që më telefonuan, duke marrë parasysht se më shkruanin në aplikacionin viber, ndërsa te numrat që kishin fotografi të personave i denoncova për ngacmim seksual” tha Gusar.¹²¹

Në RMV është duke funksionuar një organizatë joqeveritare e quajtur Qendra për Mundësi të Barabarta “Mollëkuqja” e themeluar nga aktivistë të të drejtave të grave, qëllimi i të cilës është mbështetja dhe edukimi për barazinë gjinore dhe eliminimi i stereotipeve negative që e shoqërojnë fjalën feminizëm. Platforma mollëkuqja.mk synon të krijojë një hapësirë të sigurtë për gratë dhe burrat, ku të njëjtët jo vetëm mund të informohen për problemet aktuale që kanë të bëjnë me diskriminimin gjinor, por edhe të mund të ndajnë mendimet dhe eksperiencat e tyre.

Duke pasur parasysht nevojën për ngritje të vetëdijes për ngacmimet në rrjete sociale “Mollëkuqja” po realizon fushatën “SEEN”. Kjo fushatë ka për qëllim fuqizimin e grave dhe vajzave për të raportuar ngacmimet në rrjete sociale: mesazhet që përmbajnë ngacmim, gjuhë të urrejtjes, kërcënime apo ofendime.

Kjo organizatë joqeveritare ka realizuar dy ekspozita në qendër, një në Tetovë dhe një në Gostivarë, që quhet ekspozita “Prej n’inbox, n’shesh” e cila ka për qëllim të nxjerr në pah, të gjithë t’i shohin mesazhet të cilat vajzat i marrin vazhdimisht në rrjetet sociale. Mesazhet që përmbajnë ngacmime, ofendime, gjuhë të urrejtjes dhe kërcënime të ndryshme. Qëllimi i kësaj

¹²¹ RAMADANI, Ardit, Shkup, “Ti nuk je fajtores”: Qindra protestues i dolën në mbrojtje viktimave të grupit “Dhoma Publike”, 2021, <https://portalb.mk/728101-shkup-ti-nuk-je-fajtores-qindra-protestues-i-dolen-ne-mbrojtje-viktimave-te-grupit-dhoma-publike-video-foto/>

ekspozite ishte që qytetarët të njoftohen më afër me këtë fenomen, të ngritet vetëdija e tyre dhe këto raste mos të kalojnë në heshtje por të raportohen.¹²²

Një ndër veprimet për parandalimin e këtij fenomeni është raportimi i këtyre mesazheve, andaj nga Mollëkuqja bëjnë thirrje që të njëjtat mos të injorohen. RAPORTO, MOS INJORO! <https://www.mollekuqja.mk/>

“Mollëkuqja” realizoi një hulumtim me 208 vajza nga Tetova dhe Gostivari, ku si rezultat 65.8% e vajzave të anketuara thanë se kanë marrë mesazhe nga djem ose burra që përmbajnë forma të ndryshme të ngacmimit seksual, gjuhë të urrejtjes, kërcënime dhe ofendime. 32.2% e tyre pranojnë se nuk kanë marrë përmbajtje të tilla në rrjetet sociale. 1.9% preferuan mos ta thonë.¹²³

Maqedonia e nënshkroi **Konventën e Stambollit** më 8 korrik 2011 dhe në dhjetor të vitit 2017 Kuvendi miratoi **Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje** i cili ligj përfshin veprën Ngacmimi seksual përmes internetit, e që trajtohet si *“Çdo veprim verbal, joverbal ose çdo veprim tjetër i natyrës seksuale, që ka për qëllim cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, ose qasje kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese të komunikimit”*.¹²⁴

Në RMV ekzistojnë institucione kompetente shtetërore që merren në mënyrë indirekte me luftimin e ngacmimit kibernetik. Disa nga këto institucione janë:

- Ministria e punëve të brendshme;
- Departamenti për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale
- Ministria e Drejtësisë (me gjykatat dhe prokuroritë publike);
- Biroja për siguri publike në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria për Shoqëri Informatike;

¹²² XHELILI, Fisnik, Mollëkuqja i ekspozoi “në shesh” mesazhet ngacmuese që vajzat pranojnë në internet, 2021, <https://www.mollekuqja.mk/posts/mollekuqja-i-ekspozoi-ne-shesh-mesazhet-ngacmuese-qe-vajzat-pranojne-ne-internet>

¹²³ DERVISHI, Fatlume, Shumë vajza në Gostivar dhe Tetovë, pre e ngacmimeve seksuale në rrjetet sociale, 2021, <https://www.mollekuqja.mk/posts/shume-vajza-ne-gostivar-dhe-tetove-pre-e-ngacmimeve-seksuale-ne-rrjetet-sociale>

¹²⁴ DORACAK mbi Konventën e Stambollit dhe Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2022/04/priracnik-za-istanbulska-konvencija-alb.pdf>

- Qendra për menaxhimin e krizave;
- Agjencioni për komunikime elektronike.

4.2. Kodi penal dhe legjislacioni në përgjithësi në RMV

Kodi penal i RMV-së nuk e njeh ngacmimin kibernetik si vepër specifike penale. Por, ngacmimi kibernetik mund të dënohet sipas disa veprave të parashikuara në Kodin Penal të RMV-së si:

Neni 149, **Keqpërdorimi i të dhënave personale** – (1) Ai i cili përkundër kushteve të përcaktuara me ligj pa pëlqimin e qytetarit grumbullon, përpunon ose shfrytëzon të dhënat e tij personale, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet. (2) Me dënimin nga paragrafi (1) dënohet ai i cili do të hyjë në sistemin informatik kompjuterik të të dhënave personale me qëllim që duke i shfrytëzuar ato për vete apo për tjetër që të realizojë ndonjë dobi apo tjetër kujt t'i shkaktojë ndonjë dëm. (3) Nëse veprën nga paragrafët (1) dhe (2) e kryen personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet. (4) Tentativa është e ndëshkueshme. (5) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë.¹²⁵

Neni 151, **Përgjimi dhe incizimi tonik i paautorizuar** – (1) Ai i cili me përdorimin e instalimeve të veçanta në mënyrë të paautorizuar përgjon apo bën incizimin tonik të bisedës apo deklaratës që nuk i është kushtuar atij, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet. (2) Me dënimin nga paragrafi (1) do të dënohet ai i cili do t'i mundësojë personit të paftuar të njoftohet me bisedën apo me deklaratën që është përgjuar apo incizuar me zë. (3) Me dënimin nga paragrafi (1) do të dënohet ai i cili do të incizojë zërin e deklaratës që i është kushtuar atij, pa dijeninë e atij që e ka dhënë, me qëllim që ta keqpërdorë apo t'ua bartë personave të tretë ose ai i cili deklaratën e tillë drejtpërdrejt ua bart personave të tretë. (4) Nëse veprën nga paragrafët (1), (2) dhe (3) e kryen personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet. (5) Personi zyrtar nga paragrafi (4) i cili veprën e ka kryer me urdhër të eprorit dhe e ka paraqitur para se të dijë se kundër tij është ngritur procedurë penale, do të lirohet nga dënimi. (6) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik,

¹²⁵ STEVANOVIC Ana, RISTESKI Oliver, WEASA, Cyber bullying, stalking, online harassment in North Macedonia and Serbia, 2022, <https://www.weasa.org/wp-content/uploads/2022/02/Research-on-Cyberbullying-in-North-Macedonia-and-Serbia.pdf>

do të dënohet me denim me gjobë. (7) Ndjekja për këtë vepër ndërmerret me padi private.

*Neni 152, **Incizimi i paautorizuar** – (1) Ai i cili në mënyrë të paautorizuar do të bëjë incizime fotografike, filmike ose të videos të personit tjetër apo të lokaleve të tij personale pa pëlqimin e tij, duke e shkelur privatësinë e tij ose ai i cili incizimet e tilla drejtpërdrejt ia bart personit të tretë ose ia tregon apo në mënyrë tjetër i mundëson të njoftohet me to, do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet. (2) Nëse veprën nga paragrafi (1) në mënyrë të paligjshme e kryen personi zyrtar gjatë kryerjes së detyrës, do të dënohet me burgim prej tre muaj deri në tre vjet. (3) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me dënim me gjobë.*

*Neni 157-c, **Pirateria e fonogramit** – (1) Ai i cili në mënyrë të paautorizuar të prodhuesit të fonogramit apo shoqatës për realizim kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramëve prodhon, riprodhon, distribuon, përshtat, jep me qira, lëshon në qarkullim, apo në mënyrë tjetër vë në disponim të publikut, apo ndërmerr veprime tjera për të distribuar, dhënë me qira, lëshuar në qarkullim, për të vënë në disponim publikut, apo në mënyrë tjetër të kundërligjshme e shfrytëzon fonogramin apo ekzemplarët e shumuar në mënyrë të paautorizuar të tij, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet. (2) Nëse me veprën nga paragrafi (1) është fituar dobi e konsiderueshme e pasurisë apo është shkaktuar dëm i konsiderueshëm i pasurisë, do të dënohet prej një deri në pesë vjet. (3) Nëse veprën nga ky nen e kryen personi juridik, do të dënohet me gjobë. (4) Sendet që kanë qenë të destinuara apo shfrytëzuara për kryerjen e veprës apo që janë paraqitur me kryerjen e veprës, merren.*

*Aktualisht në Kodin penal janë parashikuar edhe dy dispozitat ligjore për ngacmimet seksuale “online”, neni 394-ç, **Përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes sistemit kompjuterik** - “Ai i cili përmes sistemit kompjuterik në publik përhapë material të shkruar racist dhe ksenofobik, fotografi apo reprezentim tjetër të idesë apo teorisë e cila ndihmon, promovon apo nxit urrejtje, diskriminim apo dhunë, kundër kujtëdo qoftë personi ose grupi, në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, fisit, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit apo bindjes fetare, formave tjera të bindjes, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal apo shoqëror, pengesës mentale apo trupore, moshës, statusit familjar apo martesor, statusit pasuror, gjendjes shëndetësore, apo në cilëndo*

qoftë bazë tjetër e paraparë me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, do të dënohet me burgim nga 1 deri në 5 vjet.”

Viktimat e ngacmimeve online gjithashtu mund të thirren edhe në veprën penale **Rrezikimi i sigurisë** neni 144 *“Ai i cili përmes sistemit informatik do të kanoset se do të kryej veprë penale për të cilën është paraprë dënim me burgim prej 5 vjet ose dënim më i rëndë kundër ndonjë personi për shkak të përkatësisë së tyre gjinore, racës, ngjyrës së lëkurës, familjes, përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes sociale, religjionit ose bindjes fetare, formave tjera të bindjes, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal apo shoqëror, pengimit mental apo trupor, moshës, gjendjes familjare apo martesore, statusit pasuror, gjendjes shëndetësore, apo në çfarëdo qoftë baze tjetër e paraparë me ligj apo marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, do të dënohet me dënim me burgim prej 1 deri në 5 vjet.”*¹²⁶

RMV ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën e Budapestit për krimin kibernetik të Këshillit të Evropës. Konventa u nënshkrua nga vendi ynë më 23.11.2001, u ratifikua më 15.09.2004, dhe e njejta hyri në fuqi më 01.01.2005. RMV gjithashtu ka ratifikuar Protokollin shtesë të Konventës së krimit kibernetik.

Korniza juridike e vendit që e rregullon fushën e krimit kompjuterik e përfshin:

- Kodin Penal (KP)
- Ligjin për procedurë penale (LPP)
- Ligjin për komunikime elektronike
- Ligjin për ndjekje të komunikimeve
- Ligjin për tregtinë elektronike
- Ligjin për udhëheqjen elektronike
- Ligjin për shërbimin gjyqësor
- Ligjin për të dhënat në formë elektronike dhe nënshkrimin elektronik
- Deklaratën për internet më të sigurt.¹²⁷

¹²⁶ Kodi Penal i RMV-së, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf>

¹²⁷ Doracak për krimin kompjuterik, RMV, 2014, <https://www.osce.org/files/f/documents/a/a/121225.pdf>

4.3. Departamenti për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale në RMV

Në shkurt të vitit 2005, me formimin e njësisë për krim kompjuterik dhe falsifikime, për herë të parë i hasim fillimet për themelimin e një departamenti për krim kompjuterik dhe forenzikë dixhitale. Tre vite më vonë u formua njësia e veçantë për luftimin e krimit kompjuterik, kurse në vitin 2014 kjo njësi u nda nga departamenti për krim të organizuar duke u shëndruar në departament për krim kompjuterik dhe forenzikë dixhitale në kuadër të shërbimit qendror të policisë.

Rastet e ngacmimit dhe rastet tjera të ngjashme që kanë elemente të veprave penale të lartpërmendura mund të raportohen tek Departamenti për Krime Kompjuterike dhe Forenzikë Digjitale pranë MPB.

Kjo njësi merret me vepra penale që kanë të bëjnë me krimin kompjuterik, e të cilat janë të parapara në kodin penal të RMV-së. Këtu bëjnë pjesë: neni 251- dëmtimi dhe hyrja e paautorizuar në sistemin kompjuterik, neni 251-a – bërja (programimi) dhe futja e viruseve kompjuterike, neni 193- ekspozimi i materialit pornografik fëmijës, neni 193-a- prodhimi dhe distribuimi i pornografisë fëmijërore, neni 251-b - mashtrimi (kompjuterik), neni 149- keqpërdorimi i të dhënave personale.


Njësia për hetimin e krimit kompjuterik bashkëpunon edhe me njësi të tjera organizative në kuadër të Ministrisë së punëve të brendshme. Departamenti për krim kompjuterik dhe forenzikë dixhitale ka bashkëpunim të ngushtë me dy organizatat ndërkombëtare, EUROPOL dhe INTERPOL.¹²⁸

4.4. Të dhëna empirike nga anketa e realizuar online rreth cyber-bullying në RMV


Anketa është realizuar me qëllim të përcaktimit të gjendjes së ngacmimit kibernetik në RMV, të cilës i janë përgjigjur 300 persona. Përmban gjithsej 20 pyetje, të realizuara në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze, me të cilën janë anketuar persona të ndryshëm, të cilët dallojnë për nga mosha, gjinia, nacionaliteti, niveli i arsimit etj.

- Në pesë pyetjet e para të anketës, që kanë të bëjnë me gjininë, moshën, përkatësin etnike, nivelin arsimor dhe statusin e punësimit, të anketuarit janë deklaruar kështu:


¹²⁸ DARDHISHTA, Kaltrina, Krimi kibernetik në RMV – aspekte krahasimore me vendet e UE-së, Tetovë, 2020, fq. 26, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35,. https://repository.seeu.edu.mk/sites/thesis/ThesisSharedDocs/MA_124635.pdf




- Femërore / Женско / Female
- Mashkullore / Машко / Male




- 13-17
- 18-24
- 25-34
- 35-44
- 45-54
- 55-64
- 65+



- Shqiptare / Албанец/ка / Albanian
- Maqedonase / Македонец/ка / Macedonian
- Tjetër / Друго / Other




- Arsimi fillor / Основно образование / Primary education
- Arsimi i mesëm / Средно образование / High school education
- Arsimi i lartë / Високо образование / Higher education
- Tjetër / Друго / Other



- I/e punësuar / Вработен/а / Employed
- I/e papunësuar / Невработен/а / Unemployed
- Student / Студент / Student
- Tjetër / Друго / Other


Nga të gjithë të anketuarit, gjinisë femërore i përkasin (82.7%), ndërsa gjinisë mashkullore (17.3%). Sa i përket grupmoshave të ndryshme, dominuese është mosha prej 18 – 24 vjeç (me 61%) dhe ajo 25 – 34 vjeç (me 21.7%), pastaj është mosha prej 13 – 17 vjeç (me 10.7%), kurse grupmoshat më pak të përfshira në anketë janë mosha 35 – 44 vjeç (me 5%), mosha 45 – 54 vjeç (me 1.3%) dhe mosha 55 – 64 vjeç (me 0.3%). Përkatësia etnike e të anketuarve dominon ajo shqiptare (me 91.7%), ajo maqedonase (me 6.3%), ndërsa (me 2%) janë përgjigjur tjetër. Lidhur me nivelin arsimor të personave që janë përgjigjur, përqindjen më të lartë (68.3%) e zënë ata që kanë mbaruar arsimin e lartë, (23%) janë me arsim të mesëm, përderisa përqindjen më të ulët (2.3%) e zënë ata me arsim fillor. Lidhur me statusin e punësimit, (37.7%) janë përgjigjur se janë të punësuar, (19.3%) janë të papunësuar dhe (40.3%) janë student.

- Lidhur me pyetjen se “A i shfrytëzoni rrjetet sociale?”, të anketuarit janë përgjigjur:




(98.7%) me përgjigjen Po, ndërsa (1.3%) me përgjigjen Jo. Kjo tregon qartë se rrjetet sociale tani shfrytëzohen nga të gjithë njerëzit pa dallim dhe janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë.

- Në pyetjen se ç'farë mendojnë të anketuarit se është cyber-bullying “Ngacmimi kibernetik është... Ju lutemi zgjidhni të gjitha opsionet që janë relevante për ju”: (61 persona ose 20.3%) janë përgjigjur me nuk e di, ku vërehet se ende është një përqindje e madhe e njerëzve që nuk kanë njohuri rreth cyber-bullying, (149 persona ose 49.7%) janë përgjigjur ngacmimi një personi tjetër në internet, (71 persona ose 23.7%) përhapja e thashethemeve për dikë në rrjete sociale, (112 persona ose 37.3%) dërgimi i emaileve ose mesazheve me tekst kërcënues, provokues ose dashakeqë dikujt, (101 persona ose 33.7%) postimi i komenteve, fotove ose videove të pakëndshme për dikë në rrjetet sociale, (135 persona ose 45%) ngacmimi ose tallja e vazhdueshme me dikë në internet, (58 persona ose 19.3%) thirrja e vazhdueshme në celularin e dikujt ose dërgimi i përmbajtjeve të padëshiruara në emailat e tyre, (13 persona ose 4.3%) diçka tjetër. Duke u bazuar në këto përgjigje mund të vërejmë se ç'farë mendojnë njerëzit se është cyber-bullying.




- Në pyetjen se “A jeni ngacmuar ndonjëherë në internet?”: (42.3% ose 127 persona) janë përgjigjur me Po, përqindje që tregon se ka një numër të konsiderueshëm të personave që kanë përjetuar cyber-bullying gjatë jetës së tyre, (45.3% ose 136 persona) janë përgjigjur me Jo dhe (12.3% ose 37 persona) janë përgjigjur që nuk janë të sigurtë, kjo përqindje e kësaj përgjigjeje na len të kuptojmë se ndoshta shumica e njerëzve që kanë pësuar, nuk e dine që janë viktimizuar, sepse nuk kanë njohuri se ç’farë është cyber-bullying.




- Në pyetjen “Nëse jeni ngacmuar në internet, ku ka ndodhur:”, nga të dhënat e anketës shihet qartë se rrjeti social që dominon, ku njerëzit janë viktimizuar më shumë është Instagram (me 40.3% ose 121 persona), i dyti rradhitet Facebook (me 29.3% ose 88 persona), i treti është Snapchat (me 12.7% ose 38 persona), pastaj vijnë Whatsapp dhe

Viber (me 9.7% ose 29 persona), dhe tjerat rrjete sociale si Youtube, Twitter, TikTok etj., kanë përqindje më të ulët të njerëzve që janë viktimizuar.




- Sa i përket pyetjes “Sa kohë jeni ngacmuar në internet?” të anketuarit janë përgjigjur: një herë (20.3%), disa herë (25.3%), në një mënyrë të përsëritur gjatë një periudhe kohore (5.3%), në mënyrë të përsëritur gjatë një viti (0.3%), dhe se nuk kanë qenë subjekt (viktimë) e ngacmimit kibernetik (48.7%).




- Në pyetjen “Në qoftë se keni qenë subjekt (viktimë) i ngacmimit kibernetik, në çfarë mënyre/mënyrash është manifestuar ai?” të anketuarit janë përgjigjur: (30.7% ose 92 persona) me dërgimin e SMS mesazheve shqetësuese, (14% ose 42 persona) me dërgimin e mesazheve shetësuese, lënduese, dashakeqe në rrjete sociale, (5.7% ose 17 persona) me dërgimin e kërcënimeve për të lënduar, (5% ose 15 persona) me

postimin e komenteve fyese në rrjetet sociale, (8% ose 24 persona) me postimin e fotografive dhe videove fyese në rrjetet sociale, (12% ose 36 persona) përhapja e thashethemeve për mua, (14.7% ose 44 persona) duke hakuar në llogarinë time dhe duke pretenduar se jam unë dhe (46.3% ose 139 persona) janë përgjigjur ‘tjetër’ dhe mendoj se kjo përqindje e kësaj përgjigjeje tregon se nuk kanë qenë viktimë të cyber-bullying ose nuk kanë dashur të përgjigjen në pyetjen.




- Lidhur me pyetjen “Nga kush jeni ngacmuar në internet?”, përgjigjet e të anketuarve qëndrojnë: (46.3%) nuk dua të përgjigjem, (13%) dikush që e njoh, (34.7%) dikush që nuk e njoh, (2.3%) një ish partner/re, (3.7%) dikush që mendoja se ishte miku im.




- Lidhur me pyetjen se “Çfarë keni bërë kur keni zbuluar se jeni subjekt (viktimë) i ngacmimit kibernetik?” të anketuarit janë përgjigjur: (39.7% ose 119 persona) asgjë e

injorova, dhe kjo përgjigje na le të kuptojmë se mosndërmarrja e asnjë veprimi mund të jetë për arsye të ndryshme si p.sh. viktima është frikësuar, nuk ka ditur si të veprojë, nuk ka ditur ku të drejtohet, nuk ka pasur besim tek askush që do t'i ofrojë ndihmë etj., pastaj (5.3% ose 16 persona) i tregova prindit/prindërve/kujdestarëve, (10.7% ose 32 persona) u tregova miqve/shokëve, kjo përgjigje tregon se ndoshta njerëzit ndihen më rehat duke u treguar shokëve/shoqeve dhe mendojnë se gjejnë më shumë ndihmë nga ana e tyre, (25.7% ose 77 persona) kam marrë masa sigurie (p.sh. i kam bllokuar numrin/profilin, e kam fshirë nga rrjetet sociale, kam ndryshuar fjalëkalimin etj.), (13.3% ose 40 persona) i ruajta provat në rast se situata përkeqësohej dhe më duhej ta raportoja, (1.7% ose 5 persona) u hakmorra duke i dërguar një mesazh fyes dhe shqetësues ngacmuesit, (5.7% ose 17 persona) i dërgova një mesazh ngacmuesit që të ndërpriste me sjelljen e tillë ndaj meje, (2.7% ose 8 persona) denoncova ne polici, përgjigje e cila tregon edhe mosbesimin ndaj organeve shtetërore, në këtë rast policisë, por nuk mund të merret edhe si arsye e vetme, sepse mos denoncimi bëhet edhe për arsye tjera.




- Lidhur me pyetjen “Nëse do të kishit qenë viktimë e ngacmimit kibernetik, kë do ta kontaktonit për ndihmë? Ju lutemi zgjidhni të gjithë personat të cilët do t'i kishit kontaktuar.” përgjigja nga të anketuarit e cila dominon është: Prindin/prindërit/Kujdestarët (48.3% ose 145 persona), pastaj dominon përgjigja se do ta kishin kontaktuar policinë (41.3% ose 124 persona), e rradhës është për


shokun/shoqen tuaj më të mirë (25.3% ose 76 persona), organizatën joqeveritare të vendit tim që merret me ngacmimin kibernetik (15% ose 45 persona), arsimtarin/en/profesorin/ren (3.7% ose 11 persona), shërbimin profesional të shkollës (psikologun/psikologen, pedagogun/pedagogen) (4% ose 12 persona), psikoterapistin/psikoterapisten (3% ose 9 persona) dhe (13.3% ose 40 persona) janë përgjigjur që nuk do ta kontaktonin askënd për ndihmë.




- Për sa i përket pyetjes “Nëse asnjëherë nuk keni treguar se keni qenë subjekt i ngacmimit kibernetik, cilat kanë qenë arsyet që nuk keni treguar?” të anketuarit janë përgjigjur: (12% ose 36 persona) nuk dija kujt t'i kërkoja ndihmë, (7.3% ose 22 persona) mendoja se po t'i tregojaj dikujt, nuk do të më ndihmonte, (11.7% ose 35 persona) nuk doja që askush ta dinte se jam viktimë e ngacmimit kibernetik, (2% ose 6 persona) askush nuk do të më besonte, (7.3% ose 22 persona) mbase nga frika se do t'u tregonin njerëzve të tjerë se jam viktimë e ngacmimit kibernetik, (2.3% ose 7 persona) nëse prindërit/kujdestarët e mi do ta merrnin vesh, nuk do të më lejonin të përdorja telefonin ose internetin, (6.3% ose 19 persona) më vinte turp të flisja për një problem të tillë, (34.3% ose 103 persona) e trajtova vetë problemin dhe (42.3% ose 127 persona) janë përgjigjur tjetër.




- Lidhur me pyetjen “Në qoftë se keni qenë viktimë e ngacmimit kibernetik, si ju bëri të ndiheni?” të anketuarit janë përgjigjur: (19.7% ose 59 persona) u ndjeva i/e irrituar, (20.7% ose 62 persona) u ndjeva i/e mërzitur (pikëlluar), (9.7% ose 29 persona) më shkaktoi depresion, (19.3% ose 58 persona) u ndjeva i/e zemëruar, (8% ose 24 persona) u ndjeva i/e turpëruar, (6.7% ose 20 persona) doja të hakmerresha, (3.7% ose 11 persona) nuk doja të shkoja në shkollë apo të dilja jashtë, ndërsa vetëm (7.3% ose 22 persona) janë përgjigjur se nuk isha i/e shqetësuar dhe nuk jam ndjerë i/e prekur, (22% ose 66 persona) tjetër dhe (25.3% ose 76 persona) janë përgjigjur se nuk kanë qenë viktimë e ngacmimit kibernetik.



- Në pyetjen “A keni ngacmuar ndonjëherë dikë në internet?” nga përgjigjet e të anketuarve dominon përgjigja Jo (me 90% ose 270 persona), (6% ose 18 persona) janë përgjigjur Po, ndërsa (4% ose 12 persona) janë përgjigjur se nuk janë të sigurtë.




- Në pyetjen “A keni qenë dëshmitarë kur dikush ka përjetuar ngacmim kibernetik?": (61.3% ose 184 persona) janë përgjigjur Po, ndërsa (38.7% ose 116 persona) janë përgjigjur Jo.




- Lidhur me pyetjen se “Cila mendoni se është mënyra më e mirë për të ndaluar ngacmimin në internet?” të anketuarit janë përgjigjur: (25% ose 75 persona) unë nuk mendoj se ju mund ta ndaloni atë, (36.3% ose 109 persona) duke e bërë ngacmimin kibernetik të paligjshëm dhe duke e inkriminuar si vepër penale me ligj, (38% ose 114 persona) edukoni prindërit më shumë rreth ngacmimit në internet dhe si t'i ndihmojnë fëmijët e tyre të jenë të sigurt, (35.7% ose 107 persona) bëjini shkollat të kenë programe dhe të zbatojnë politika për ngacmimin kibernetik, (34% ose 102 persona) të krijohen organizata publike joqeveritare për të raportuar rastet e ngacmimit kibernetik dhe të cilat rrisin vetëdijësimin për ngacmimin kibernetik, të cilat duhet të përkrahen nga organet shtetërore, (24.3% ose 73 persona) jepni më shumë informacion se si

ngacmimi kibernetik ndikon te njerëzit, (19.3% ose 58 persona) të mbahen tubime, mbledhje për të folur rreth ngacmimit kibernetik dhe ndikimet e tij dhe si ta kontrollojmë atë, (21.3% ose 64 persona) të publikohen dhe shpërndahen doracak, gazeta, materiale tjera nëpër rrjete sociale, poashtu edhe në vende publike me të cilat informohen dhe edukohen qytetarët rreth ngacmimit kibernetik dhe (11% ose 33 persona) janë përgjigjur se duhet të ndërmerren mënyra tjera.



- Dhe në pyetjen “Ju lutemi zgjidhni të gjitha përgjigjet që vlejné për ju”, ku kërkohet mendimi i të anketuarve dhe përgjigjet që vlejné për ta, ata janë përgjigjur: (3% ose 9 persona) se ngacmimi kibernetik nuk i bën keq askujt, (me 42.3% ose 127 persona) dominon përgjigja se ngacmimi kibernetik është më i keq se ngacmimi fizik, (10% ose 30 persona) mendojnë se ngacmimi kibernetik nuk është aq i keq sa ngacmimi fizik, pastaj (40.7% ose 122 persona) janë përgjigjur se miqtë e tyre janë ngacmuar në internet, (30.7% ose 92 persona) janë përgjigjur se ngacmimi kibernetik ka ndodhur në shkollën e tyre, (2% ose 6 persona) u përgjigjën se unë kam ngacmuar ose thënë gjëra të këqija në internet, por kjo nuk është ngacmim kibernetik, (5% ose 15 persona) u përgjigjën se janë ngacmuar në internet nga një mik i ngushtë, (15.3% ose 46 persona) u përgjigjën se ju ka ndodhur që dikush të ua ketë vjedhur fjalëkalimin/telefonin celular dhe kanë pretenduar se janë ata, (1% ose 3 persona) u përgjigjën se kanë postuar foto qesharake ose të vrazhda të njerëzve që njohin në internet pa lejen e tyre, por vetëm për të qeshur, (2.7% ose 8 persona) u përgjigjën se kanë ngacmuar dikë në internet me miqtë e tyre, por nuk kanë dashur të lëndojnë dikë, (2% ose 6 persona) u përgjigjën që kanë ngacmuar dikë

online me profil të rrejshëm, (12% ose 36 persona) u përgjigën se kanë mbrojtur dikë që u ngacmua në internet dhe më pas u bënë vetë viktimat.



KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Sipas të gjitha kërkimeve që u bënë për tu realizuar ky punim, vërejmë se në paraqitjen e ngacmimit kibernetik në masë të madhe ka ndikuar paraqitja e pandemisë Covid-19, ku pas përhapjes së virusit me shpejtësi të madhe shumë shtete u detyruan që të marrin masa për karantinim dhe kjo bëri që të gjitha punët të zhvillohen dhe të kryhen online, duke përfshirë edhe shkollat. Kështu, të gjithë njerëzit u detyruan që të punonin dhe ti kryenin obligimet e tyre prej shtëpisë, edhe studentët të mbanin mësimin online, dhe për shkak të këtij bllokimi thuajse të gjithë njerëzit pjesën më të madhe të kohës së tyre e kalonin në internet, në mediat sociale, gjë që para pandemisë nuk ishte kështu. Kjo gjendje bëri që të pësojnë të gjithë, sidomos moshat e reja, dhe ngriti vëmendje më të madhe për ndërgjegjësim në këtë drejtim, duke filluar nga prindërit të cilët janë shumë të shqetësuar për fëmijët e tyre të cilët po kalojnë shumë kohë në ditë në internet.

Në RMV, por edhe në vendet tjera në botë, për rastet e ngacmimit kibernetik sado të mblidhen të dhëna, gjithmonë do të jenë larg realitetit. Për këtë vepër penale, numri i errët do të jetë shumë i lartë për arsye të ndryshme që viktimat nuk i paraqesin rastet dhe nuk evidentohen.

Padyshim që mungesa e dispozitave ligjore e rrit numrin e rasteve të pazbuluara dhe e vështirëson zbulimin e tyre. Prandaj ne si shtet, duhet të marrim masa duke marrë shembull nga vendet tjera në botë të cilët janë më të përparuar se ne në këtë drejtim. Dhe pasi që edhe vendi ynë ka pësuar rëndë nga kjo vepër penale, organet kompetente shtetërore duhet të marrin masa që cyber-bullying të inkriminohet si vepër e veçantë penale në KPRMV, poashtu edhe propozimi për futjen e “përndjekjes – stalking” si vepër penale në KPRMV të zbatohet sa më shpejtë që për kryerësit të ketë bazë ligjore për ndëshkimin e tyre.

Në RMV do të ishte edhe më mirë që të ketë ligj të veçantë, përpilimi i të cilit duhet të bazohet në rregullat ndërkombëtare, me të cilin rregullohen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me cyber-bullying dhe veprat e tjera që kryhen përmes internetit. Përpilimi dhe sjellja e një ligji të veçantë padyshim që do të kishte ndikim pozitiv në parandalimin e kësaj vepre penale, kryerësit do të mbanin përgjegjësi për veprimet e tyre dhe viktimave do t’u garantoheshin të drejtat e tyre dhe do t’u jepej ndihma dhe mbrojtja e nevojshme, viktimat do të kishin siguri më

të madhe dhe me mbështetjen që ligji do t'u kishte garantuar do të inkurajoheshin që t'i paraqitnin më shumë rastet e viktimizimit në organet kompetente.

Mungesa e edukimit të përgjithshëm rreth Cyber-bullying, veçanërisht te të rinjët, është faktor që ndikon në rritjen gjithnjë e më të madhe të këtyre rasteve. Duhet të zhvillohen fushata kundër ngacimit kibernetik nëpërmjet edukimit nëpër shkolla dhe nëpër rrjete sociale. Duhet që qytetarët të informohen për ngacimin kibernetik dhe për pasojat që shkaktohen te viktimat, veçanërisht te ato të moshave të reja që janë shumë të rënda dhe afatgjate. Edukimi i prindërve, vetëdijësimi i tyre rreth ngacimit kibernetik është shumë i rëndësishëm, që ata të dinë se si të sillen dhe çfarë masash të marrin për mbrojtjen e fëmijëve të tyre në qoftëse ata pësojnë ndonjëherë në jetën e tyre.

Prindërit duhet t'i edukojnë fëmijët e tyre rreth këtij problemi duke filluar sa më herët të jetë e mundur, duke patur një bisedë të vazhdueshme me fëmijët për jetën e tyre mediatike dhe dixhitale, në të që njëjtën mënyrë që prindërit flasin me fëmijët si p.sh. duke i pyetur se çfarë ka ndodhur sot në shkollë.. Prindërit shpenzojnë kohën duke i mësuar fëmijët e tyre për gjëra të ndryshme, si p.sh. si të kalojnë rrugën të sigurtë në komunikacion, të jenë të vetëdijshëm ndaj të huajve, por nuk e kalojnë kohën duke biseduar me fëmijët e tyre se si të jenë të sigurt në internet, si ta mbrojnë vetën e tyre online etj. D.m.th. është e nevojshme që fëmija prej kohës kur fillon të shkojë në kopsht për fëmijë, prindërit përveç që duhet të fokusohen për ngritjen dhe aftësimin akademik të fëmijës së tyre, gjithashtu duhet të fokusohen për aftësimin social, zhvillimin e aftësive emocionale dhe zgjidhjen e konflikteve. Fëmijët nuk do të mësojnë kurrë se si të jenë social dhe si të jenë të sjellshëm me njëri-tjetrin nëse të rriturit nuk janë model apo shembull për ta, sepse fëmijët duke parë të rriturit mësojnë, kështu prindërit duhet të arrinë t'u ofrojnë mundësinë për të mësuar se si të respektojnë njëri-tjetrin, si të jenë të sjellshëm etj.

Gjithashtu, si hap tjetër që duhet të merret dhe i cili mund të ketë efekt pozitiv është që, nëpër shkolla të implementohet një lëndë mbi edukimin mediatik, e cila ka të bëjë me menaxhimin e medias në tërësi, e cila do t'i ndihmojë fëmijët dhe të rinjët se si të përdorin internetin dhe si të jenë më të sigurtë gjatë përdorimit, të njihen me pasojat negative të tij dhe të dinë se si të mbrohen në qoftë se bëhen viktimat. Pra është shumë e rëndësishme rritja e

ndërgjegjësimin për sigurinë në internet dhe dhunën në internet nga moshë më e hershme, në shkollat fillore.

Rritja e efikasitetit të organeve shtetërore duke filluar nga Policia, Qeveria, Ministrinë, Sektorët e specializuar, Prokuroritë, kompanitë e specializuara në sigurinë kibernetike, organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare etj., të edukohen dhe të trajtohen në punën e tyre rreth ngacimit kibernetik dhe sigurinë kibernetike, të specializohen në mënyrë që të dinë se si të veprojnë në raste të tilla.

Për edukimin e të rinjëve, kinematografia ka bërë filma dhe dokumentare që shpjegojnë dukurinë e cyber-bullying, si dhe format e manifestimit të tij, deri në çfarë pike mund të arrijnë pasojat nga cyber-bullying, si e përjeton viktimën, të cilat mund të çojnë edhe në vetvrasje. Këto filma përshkruajnë edhe anën e bullizuesit, cilët persona paraqiten më shumë si bullizues, cilët moshë viktimizohen më shumë, e përshkruajnë ndërhyrjen e prindërve në këtë drejtim për mbrojtjen e fëmijëve të tyre, ndërhyrjen e shkollës, ndërhyrjen e autoriteteve etj. Disa nga këto filma/dokumentare që do t'i rekomandoja janë: *A girl like her* – film që përshkruan se çfarë po ndodh në shkollat amerikane, *Cyber bully*, *Disconnect*, *Odd girl out*, *The cyberbully*, *Trust*, *Tindler Swindler*, *13 reasons why*, *The perils of cyberbullying – Victim must not suffer in silence*, *Dark cloud: The high cost of cyberbullying*. Qëllimi është për të rritur më shumë ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin anë e mbanë botës rreth cyber-bullying, andaj mendoj se kinematografia duhet edhe më shumë të punojë dhe të bëjë filma që të ketë ndikim më shumë tek të gjitha moshat, sepse filmat ngritin vëmendjen më shumë, përhapen më shpejtë, dhe ndikimi mund të jetë pozitiv si për viktimën ashtu edhe për bullizuesin që të kuptojë veprimet e tij çfarë mund të shkaktojnë.

BIBLIOGRAFIA

Libra dhe artikuj shkencorë:

DONEGAN, Richard, Bullying and Cyberbullying: History, Statistics, Law, Prevention and Analysis, <https://www.elon.edu/u/academics/communications/journal/wp-content/uploads/sites/153/2017/06/04DoneganEJSpring12.pdf> ;

AUNE, Nicole M., Cyberbullying, The Graduate School University of Wisconsin-Stout December, 2009, <https://www2.uwstout.edu/content/lib/thesis/2009/2009aunen.pdf> ;

ALITI, Gëzim, Burimet e hetimit të krimit kompjuterik dhe parandalimi i tij në faza të hershme, Tetovë, 2019, https://repository.seeu.edu.mk/sites/thesis/ThesisSharedDocs/MA_118542.pdf ;

TOKUNAGA, Robert S. "A critical review and synthesis of research on cyberbullying victimization." -Computers in human behavior- 2010, <https://eclass.uoa.gr/modules/document/file.php/PPP357/Following%20you%20home%20from%20school%20A%20critical%20review%20and%20synthesis%20of%20research.pdf> ;

DARDHISHTA, Kaltrina, Krimi kibernetik në RMV – aspekte krahasimore me vendet e UE-së, Tetovë, 2020, fq.21,22. https://repository.seeu.edu.mk/sites/thesis/ThesisSharedDocs/MA_124635.pdf ;

Ligje, Konventa dhe dokumente të tjera:

Kodi Penal i RMV-së, <https://www.pravdiko.mk/wp-content/uploads/2013/11/Krivichen-zakonik-integralen-prechisten-tekst.pdf> ;

Legal Highlight: The Civil Rights Act of 1964 <https://www.dol.gov/agencies/oasam/civil-rights-center/statutes/civil-rights-act-of-1964#:~:text=The%20Civil%20Rights%20Act%20of%201964%20prohibits%20discrimination%20on%20the,hiring%2C%20promoting%2C%20and%20firing.> ;

Individuals with Disabilities Education Act (IDEA) <https://sites.ed.gov/idea/about-idea/> ;

Title IX of the Education Amendments of 1972 <https://www.justice.gov/crt/title-ix-education-amendments-1972> ;

State bullying laws across the U.S., https://cyberbullying.org/pdfs/2021_Bullying-and-Cyberbullying-Laws.pdf ;

A Guide to Worldwide Bullying Laws, <https://www.hcalawyers.com.au/blog/bullying-laws-around-the-world/> ;

German Criminal Code (Strafgesetzbuch – StGB), https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_stgb/englisch_stgb.html# ;

The Law on Cyberbullying, <https://www.localsolicitors.com/criminal-guides/the-law-on-cyberbullying> ;

DORACAK mbi Konventën e Stambollit dhe Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje, <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2022/04/priracnik-za-istanbulska-konvencija-alb.pdf> ;

KRIVIČNI ZAKONIK REPUBLIKE SRBIJE, <https://www.paragraf.rs/propisi/krivicni-zakonik-2019.html> ;

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 2 / 14 Janar 2019, Prishtinë, https://www.kosovopolic.com/wp-content/uploads/2020/07/KODI_NR.06_L-074_KODI_PENAL_I_REPUBLIKE%CC%88S_SE%CC%88_KOSOVE%CC%88S.pdf ;

LIGJ PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT KIBERNETIKË, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: viti V / nr. 74 / 20 Korrik 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2682> ;

PROJEKTLIGJI PËR SIGURINË KIBERNETIKE, https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/09-07-34-21072020/Projektligji-per-Sigurine-Kibernetike_tre-gjuhet.doc ;

Koncept dokument për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik, 2017, <https://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/11-49-51-22122017/1.%20Draft-Koncept%20dokument%20p%C3%ABr%20parandalimin%20dhe%20luftimin%20e%20krimit%20kibernetik....doc> ;

Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Ligj nr. 8888, datë 25.4.2002 për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, https://www.pp.gov.al/rc/doc/konventa_per_krimin_ne_fushen_e_kibernetikes_786.pdf ;

Legjislacioni për krimin kibernetik, pjesë nga Kodi Penal, Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/LEGJISLACIONIMBIKRIMINKIBERNETIK.pdf> ;

Kodi penal i Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995, https://www.dreitesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf ;

Doracak për krimin kompjuterik, RMV, 2014, <https://www.osce.org/files/f/documents/a/a/121225.pdf> ;

Burime nga interneti:

Stopbullying, Cyberbullying, 2021, <https://www.stopbullying.gov/cyberbullying/what-is-it> ;

JOSEPH, Elena Pearl Ben, Cyberbullying, 2018, <https://kidshealth.org/en/teens/cyberbullying.html> ;

DOVI, Allison T., Cyberbullying, 2020, <https://kidshealth.org/en/parents/cyberbullying.html> ;

Ngacmimi kibenetik, 2018, <https://busulla.com/articles/88> ;

Pacer's National bullying prevention center, Cyberbullying definition, <https://www.pacer.org/bullying/info/cyberbullying/> ;

<http://www.kenrigby.net/02a-Defining-bullying-a-new-look> ;

GURI, Besmir, Portali shkollor, 2020 <https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/cdo-lloj-dhune-nuk-eshte-bullizem-por-cdo-lloj-bullizmi-eshte-dhune> ;

Bullizmi si pjesë e shoqërisë, pasojat dhe lufta kundër tij, 2022, <https://pikepamja.net/bullizmi-si-pjese%CC%88-e-shoqe%CC%88rise%CC%88-pasojat-dhe-lufta-kunde%CC%88r-tij/> ;

Studentët.mk, Kibernetika dhe teoria e shenjave, 2017, <https://www.studentet.mk/kibernetika-dhe-teoria-e-shenjave/> ;

Fjalor i gjuhës shqipe, <https://fjalorthi.com/kibernetik%C3%AB> ;

Kuptimi i Cyber, 2022, <https://sq.nsp-ie.org/ciber-3904> ;

Cyber definitions, What does cyber mean, https://www.cyberdefinitions.com/definition_of_cyber.html ;

The Bark team, The history of Cyberbullying, 2017 <https://www.bark.us/blog/the-history-of-cyberbullying/> ;

The truth behind 6 disturbing cyberbullying cases that turned into suicide stories, <https://www.wtps.org/cms/lib8/NJ01912980/Centricity/Domain/745/The%20truth%20behind%206%20disturbing%20cyberbullying%20cases%20that%20turned%20into%20suicide.pdf> ;

Amanda Todd Legacy Society, <https://www.amandatoddlegacy.org/> ;

The Origin of Cyberbullying + 5 Ways to Identify and Prevent It, <https://dataoverhauleders.com/origin-of-cyberbullying/> ;

Kaspersky, Cyber-bullying Facts – Top 10 Forms of Cyber Bullying, 2016, <https://www.youtube.com/watch?v=0Xo8N9qIJtk> ;

10 Forms of Cyberbullying, <https://kids.kaspersky.com/10-forms-of-cyberbullying/> ;

The 10 Types of Cyberbullying, 2018, <https://blog.securly.com/2018/10/04/the-10-types-of-cyberbullying/> ;

Delete cyberbullying, Why do people cyberbully, <https://www.endcyberbullying.net/why-do-people-cyberbully> ;

CUNCIC, Arlin, The psychology of cyberbullying, 2022, <https://www.verywellmind.com/the-psychology-of-cyberbullying-5086615> ;

GORDON, Sherri, 8 motives behind why kids cyberbully, 2020, <https://www.verywellfamily.com/reasons-why-kids-cyberbully-others-460553> ;

11 facts about cyberbullying, <https://www.dosomething.org/us/facts/11-facts-about-cyber-bullying> ;

Cyberbullying warning signs, <https://www.adl.org/resources/tools-and-strategies/cyberbullying-warning-signs> ;

HARTUNG, Emily, The 10 warning signs of cyberbullying, 2018, <https://www.netnanny.com/blog/the-10-warning-signs-of-cyberbullying/> ;

UNICEF, Cyberbullying: What is it and how to stop it, 2022, <https://www.unicef.org/end-violence/how-to-stop-cyberbullying> ;

KidsofKosova, Ngacmimi kibernetik, kambanat e alarmit që prindërit e mësuesit nuk duhet të neglizhojnë, 2021, <https://kidsofkosova.net/ngacmimi-kibernetik-kambanat-e-alarmit-qe-prinderit-e-mesuesit-nuk-duhet-te-neglizhojne/> ;

Toppr, Cyber Bullying Essay for Students and Children, <https://www.toppr.com/guides/essays/cyber-bullying-essay/> ;

Bullying në internet: analizimi i karakteristikave të ngacmimit virtual, <https://sq.warbletoncouncil.org/ciberbullying-acoso-virtual-3828> ;

Ngacmimi në internet: çfarë është dhe si ta ndaloni atë, <https://madreshoy.com/sq/ciberacoso-que-es-y-como-detenerlo/> ;

Tecno analista, Ngacmimi kibernetik, <https://eltecnoanalista.com/sq/acoso-cibernetico/> ;

TODOROV, Georgi, Crucial cyberbullying statistics, trends, and facts 2022, [https://thrivemyway.com/cyberbullying-stats/#:~:text=Girls%20are%20more%20likely%20than,the%20average%20rate%20of%2020%25.](https://thrivemyway.com/cyberbullying-stats/#:~:text=Girls%20are%20more%20likely%20than,the%20average%20rate%20of%2020%25.;) ;

Cyberbullying, Male and female differences, <https://thecyberbullyexplained.weebly.com/male-and-female-differences.html> ;

HINDUJA, Sameer, PATCHIN, Justin W., Cyberbullying: Identification, Prevention, and Response, 2021, <https://cyberbullying.org/Cyberbullying-Identification-Prevention-Response-2021.pdf> ;

eSafetyCommissioner, How to collect evidence, <https://www.esafety.gov.au/report/how-to-collect-evidence> ;

LENCH, Brooke De, 10 Tips for Teens to Prevent Cyberbullying, <https://www.momsteam.com/health-safety/10-tips-teens-prevent-cyberbullying> ;

How to Prevent and Stop Cyberbullying in Schools: 6 Effective Ways, <https://www.positiveaction.net/cyberbullying-prevention> ;

ASO Staff Writers, Cyberbullying in School: Prevention and Support, 2021, <https://www.accreditedschoolsonline.org/resources/cyberbullying-prevention-and-support/> ;

Mediat Sociale dhe Fëmijët, <https://www.isigurt.al/fakte-dhe-te-dhena/mediat-sociale-dhe-femijet> ;

Instagram lançon mjete për parandalimin e ngacimit në platform, 2021, <https://pcworld.al/instagram-lancon-mjete-per-parandalimin-e-ngacimit-ne-platforme/> ;

MUÇA, Megi Asllani, Për shkak të pandemisë, bullizmi kibernetik është i zhvilluar tek fëmijët, 2021, <https://civilalb.info/2021/04/26/per-shkak-te-pandemise-bullizmi-kibernetik-eshte-i-zhvilluar-tek-femijet/> ;

Instagram help center, <https://help.instagram.com/700284123459336> ;

Andrew M.I. Lee, JD, What is the Individuals with Disabilities Education Act (IDEA)? <https://www.understood.org/en/articles/individuals-with-disabilities-education-act-idea-what-you-need-to-know> ;

Federal Laws, <https://www.stopbullying.gov/resources/laws/federal> ;

Woda Steven, Cyberbullying Laws Around the Globe: Where is Legislation Strongest?, 2014, <https://resources.uknowkids.com/blog/cyberbullying-laws-around-the-globe-where-is-legislation-strongest> ;

DJURASKOVIC Ogi, Cyberbullying Statistics, Facts, and Trends (2022) with Charts, 2022, <https://firstsiteguide.com/cyberbullying-stats/> ;

Members of European Parliament Research Service, 2018, <https://epthinktank.eu/2018/10/28/victims-of-cyberbullying-what-europe-does-for-you/> ;

Better Internet for Kids, <https://www.betterinternetforkids.eu/policy/insafe-inhope> ;

A sampling of cyberbullying laws around the world, <https://socialna-akademija.si/joiningforces/4-4-1-a-sampling-of-cyber-bullying-laws-around-the-world/> ;

Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, Cyberbullying among young people, 2016, [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU\(2016\)571367_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2016/571367/IPOL_STU(2016)571367_EN.pdf) ;

The cybersmile foundation, Italian Parliament Passes New Law To Protect Minors From Cyberbullying, <https://www.cybersmile.org/news/italian-parliament-passes-new-law-to-protect-minors-from-cyberbullying> ;

VOJINOVIC, Ivana, Heart-breaking Cyberbullying statistics for 2022, <https://dataprot.net/statistics/cyberbullying-statistics/> ;

47 statistika alarmuese nga bullzimi kibernetik te vitit 2020, <https://familjajone.com/47-statistika-alarmuese-nga-bullzimi-kibernetik-te-vitit-2020/> ;

The cybersmile foundation, Legal perspective, <https://www.cybersmile.org/advice-help/category/cyberbullying-and-the-law> ;

Fighting cybercrime in the Netherlands, <https://www.government.nl/topics/cybercrime/fighting-cybercrime-in-the-netherlands> ;

60% of children and youth in Albania are victims of online bullying, <https://www.crca.al/en/news/60-children-and-youth-albania-are-victims-online-bullying> ;

The phenomenon of cyber bullying in Albanian context: An explorative study of students' perceptions, 2014, <http://www.epess.net/tr/download/article-file/333025> ;

Platforma Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet, <https://www.isigurt.al/rreth-nesh/historiku> ;

A Study on Child Online Safety in Albania, <https://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf> ;

PALUSHI, Arbrie, Ngacmimet kibernetike. Ndikimi i tyre te fëmijët dhe adoleshentët 2018, <https://telegrafi.com/ngacmimet-kibernetike-ndikimi-tyre-tek-femijet-dhe-adoleshentet/>;

KRASNIQI, Meritë, I paraportuar dhe i injoruar, bullizmi përndjek nxënësit e Kosovës, 2019, <https://kosovotwopointzero.com/i-paraportuar-dhe-i-injoruar-bullizmi-perndjek-nxenesit-e-kosoves/>;

ZYMERI, Teuta, MUSMURATI, Besianë, Siguria e fëmijëve në internet, Udhëzues për fëmijë, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/11/siguria-e-femijeve-ne-internet.pdf> ;

Portalb.mk, “Dhoma Publike” është një koleksion i grabitqarëve seksualë që trupat femra i shikojnë si objekte pa të drejtë të privatësisë, 2020, <https://portalb.mk/662843-dhoma-publike-eshte-nje-koleksion-i-grabitqareve-seksuale-qe-trupat-femra-i-shikojne-si-objekte-pa-te-drejte-te-privatesise/> ;

BUÇI, Teuta, "Përndjekja" si vepër penale, ngacmimet ndaj vajzave duhet të presin disponimin politik për t'u sanksionuar, 2021, <https://www.mollekuqja.mk/posts/perndjekja-si-veper-penale-ne-pritje-te-vullnetit-politik> ;

BEHADINI, Rita, Shpërndarje e pornografisë së fëmijëve: Dy krijuesit e "Dhomës Publike" u dënuan me nga katër vite burg, 2022, <https://www.mollekuqja.mk/posts/shperndarje-e-pornografise-se-femijeve-dy-krijuesit-e-dhomes-publike-u-denuan-me-nga-kater-vite-burg> ;

BUÇI, Teuta, "Përndjekja", aktorëve politik nuk u “ngutet” të miratojnë propozim-ndryshimet në Kodin Penal, 2022, <https://www.mollekuqja.mk/posts/perndjekja-aktoreve-politik-nuk-u-ngutet-te-miratojne-propozim-ndryshimet-ne-kodin-penal> ;

SKANDAL/“Dhoma publike” aktivizohet sërish, hapet për herë të tretë grupi në Telegram, 2021, <https://alportal24.com/skandal-dhoma-publike-aktivizohet-serish-hapet-per-herë-te-trete-grupi-ne-telegram/> ;

Portalb.mk, Prokuroria Publike: Hetimi për “Dhoma publike 2” është në fazën përfundimtare, po zhvillohen procedura hetimore në disa prokurori, 2021, <https://portalb.mk/733860-prokuroria-publike-hetimi-per-dhoma-publike-2-eshte-ne-fazen-perfundimtare-po-zhvillohen-procedura-hetimore-ne-disa-prokurori/> ;

Dhoma publike, nëse telegram nuk fshin grupin do të kufizohet aplikacioni, 2021, <https://www.youtube.com/watch?v=4NP5Rull78I> ;

RAMADANI, Ardit, Shkup, “Ti nuk je fajtorë”: Qindra protestues i dolën në mbrojtje viktimave të grupit “Dhoma Publike”, 2021, <https://portalb.mk/728101-shkup-ti-nuk-je-fajtorë-qindra-protestues-i-dolen-ne-mbrojtje-viktimave-te-grupit-dhoma-publike-video-foto/> ;

DERVISHI, Fatlume, Shumë vajza në Gostivar dhe Tetovë, pre e ngacmimeve seksuale në rrjetet sociale, 2021, <https://www.mollekuqja.mk/posts/shume-vajza-ne-gostivar-dhe-tetove-pre-e-ngacmimeve-seksuale-ne-rrjetet-sociale> ;

XHELILI, Fisnik, Mollëkuqja i ekspozoi “në shesh” mesazhet ngacmuese që vajzat pranojnë në internet, 2021, <https://www.mollekuqja.mk/posts/mollekuqja-i-ekspozoi-ne-shesh-mesazhet-ngacmuese-qe-vajzat-pranojne-ne-internet> ;

Telma TV, Javna soba, 2021, https://www.youtube.com/watch?v=mjzve_ney-M ;

EULEX, Forenzika përmes teknologjisë informative – Zbulimi i krimeve në autostradën digjitale të shekullit XXI, 2017, <https://eulex-kosovo.eu/?page=1,26,670> ;

DAMCESKA Marina, Telegram "Balkan Room" Revealed - Over 36.000 men from the region share explicit photos of women, <https://www.slobodenpecat.mk/en/otkriena-balkanska-soba-na-telegram-nad-36-000-mazhi-od-regionot-spodeluvale-eksplicitni-fotografii-od-zheni/#:~:text=While%20the%20Public%20Prosecutor's%20Office,36.000%20men%20from%20the%20Balkans> ;

DONEV Mihailo, Telegram "Balkan Room" administrator found, threatened with 8 years in prison, <https://www.slobodenpecat.mk/en/pronajden-administratorot-na-balkanska-soba-na-telegram-mu-se-zakanuvaat-8-godini-zatvor/> ;

MILETIĆ Miljana, The scroll, Telegram revenge porn scandal: police investigate as more than 50 000 men share explicit content of women and underaged girls, 2021, <https://the-scroll.co.uk/2021/03/17/telegram-revenge-porn-scandal-police-investigate-as-more-than-50-000-men-share-explicit-content-of-women-and-underaged-girls/> ;

Government censorship of Telegram Messenger, https://en.wikipedia.org/wiki/Government_censorship_of_Telegram_Messenger ;

STEVANOVIC Ana, RISTESKI Oliver, WEASA, Cyber bullying, stalking, online harassment in North Macedonia and Serbia, 2022, <https://www.weasa.org/wp-content/uploads/2022/02/Research-on-Cyberbullying-in-North-Macedonia-and-Serbia.pdf> ;

Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit 2016 – 2019, dhjetor 2015, https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_Shteterore_per_Sigurine_Kibernetike_dhe_Plani_i_Veprimit_2016-2019_per_publicim_1202.pdf ;

Vlerësimi i kërcënimit nga krimet e rënda dhe krimi i organizuar – socta, 2014-2015, Prishtinë, 2016, fq. 49,50, https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2019/10/VLER%C3%8BSIMI_I_K%C3%8BRC%C3%8BNIMIT_NGA_KRIMET_E_R

[%C3%8BNDA DHE KRIMI I ORGANIZUAR %E2%80%93 SOCTA 2014-2015.pdf](#) ;

Epoka e re, Gashi: Ligji për siguri kibernetike do të parandalojë krimin kibernetik,
<https://www.epokaere.com/gashi-ligji-per-siguri-kibernetike-do-te-parandaloje-krimin-kibernetik/> ;

SHKËMBI Aldo, Krimi Kibernetik Harmonizimi i Legjislacionit shqiptar me atë europian, Tiranë, 2015, https://uet.edu.al/wp-content/uploads/2021/11/Aldo_Shkemb.pdf ;

IGF, UN, The charter of human rights and principles for the internet,
<https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Issues/Opinion/Communications/InternetPrinciplesAndRightsCoalition.pdf> ;

TechTarget Contributor, Digital rights, 2017,
<https://www.techtarget.com/whatis/definition/digital-rights> ;

Stop Cyberbullying Day, <https://stopcyberbullyingday.org/> ;